

Të drejtat e njeriut, liria e shprehjes, të drejtat e pakicave dhe roli i medimeve në kushtet e konfliktit dhe tensionit

Doracak për punën e mediave lokale

Përmirësimi i raportimit medial
mbi çështjet e komuniteteve
etnike dhe të pakicave në jugun
e Serbisë përmes trajnimit për
redaktor dhe grupe civile

NIŠ • VRANJE • PREŠEVO • BUJANOVAC • MEDVEĐA

Dr Dejan Millenković

**Të drejtat e njeriut, liria e shprehjes, të drejtat e
pakicave dhe roli i medimeve në kushtet e
konfliktit dhe tensionit**

Doracak për punën e mediave lokale

NISH, 2010

Përmbajta

FJALA HYRËSE

PJESA E PARË TË DREJTAT E NJERIUT DHE TË PAKICAVE

1. ZHVILLIMI HISTORIK DHE KONCEPTI I TË DREJTAVE TË NJERIUT

- 1.1. Zhvillimi historik i të drejtave të njeriut
- 1.2. Koncepti i „shtetit të së drejtës“ në periudhën në mes dy luftërave
- 1.3. Kritika e konceptit të „shtetit të së drejtës“ në periudhën në mes të dy luftërave
- 1.4. Koncepti „shtetit social“ dhe rëndësia e organizatave ndërkombëtare në zhvillimin e të drejtave të njeriut pas Luftës së Dytë botërore

2. „KLASIFIKIMI“ I TË DREJTAVE TË NJERIUT

- 2.1. Një vështrim i përgjithshëm ndaj të drejtave qytetare dhe politike si të drejta të gjeneratës së parë
- 2.2. Vështrim i përgjithshëm në të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore si të drejta të gjeneratës së dytë dhe të drejtat e gjeneratës së tretë

3. TË DREJTAT E „PAKICAVE“

- 3.1. Zhvillimi historik i të drejtave të pakicave
- 3.2. Koncepti i „të drejtave të pakicave“ në Kombet e Bashkuara dhe në këshillin e Evropës
- 3.3. problemi me caktimin e nocionit „pakicat“

4. NDALIMI I DISKRIMINIMIT NË DOKUMENTET MË TË RËNDËSISHMENDËRKOMBËTARE DHE NË KUSHTETUTËN E REPUBLIKËS SË SERBISË

- 4.1. Ndalimi i diskriminimit në dokumentet e caktuara ndërkombëtare
- 4.2. Ndalimi i diskriminimit në Kushtetutën e Republikës së Serbisë

5. MEKANIZMAT E MBROJTJES SË TË DREJTAVE TË NJERIUT PARA GJYKATAVE NDËRKOMBËTARE DHE NË TRUPAT E TJERË

- 5.1. Vështrim i përgjithshëm
- 5.2. Pakti mbi të drejtat qytetare dhe politike dhe Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të drejtat e njeriut
- 5.3. Konventa Europiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore dhe Gjykata europiane për të drejtat e njeriut

6. TË DREJTAT E PAKICAVE NACIONALE NË KUSHTETUTËN E SERBISË DHE NË LEGJISLATURËN SERBE

- 6.1. Kushtetuta e republikës së Serbisë dhe të drejtat e pakicave nacionale
- 6.2. Ligje të caktuara të cilat përkojnë me pakicat nacionale në Serbi.

7. PROCEDURAT PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË NJERIUT DHE TË PAKICAVE NË REPUBLIKËN E SERBISË

- 7.1. Vështrim i përgjithshëm
- 7.2. Procedura sipas ankesës kushtetuese para Gjykatës kushtetutës
- 7.3. procedura para Mbrojtësit të qytetarëve
- 7.4. Procedura para të ngarkuarit për mbrojtjen e barazisë

PJESA E DYTË LIRIA E TË SHPREHURIT DHE RËNDËSIA E MEDIAVE NË MJEDISET MULTIETNIKE

1. LIRIA E TË SHPREHURIT DHE TË DREJTAT E MEDIAVE

- 1.1. Liria e të shprehurit në dokumentet ndërkombëtare
- 1.2. Praktika e Gjykatës europiane për të drejtat e njeriut që ka të bëjë me lirinë e shprehjes
- 1.3. Vështrim i përgjithshëm në dokumentet e Këshillit të Europës që përkojnë me lirinë e shprehjes

2. RREGULLIMI KUSHTETUES DHE LIGJOR I LIRISË SË SHPREHJES DHE TË PUNËS SË MEDIAVE NË SERBI

- 2.1. Vështrim i përgjithshëm në rregullimin kushtetues dhe ligjor të lirisë së shprehjes dhe të punës së mediave në Serbi
- 2.2. Kushtetuta e Republikës së Serbisë
- 2.3. Ligjet për mediat dhe ligjet e tjera në Serbi
- 2.4. Ligji mbi informimin publik
- 2.5. Ligji mbi radiodifuzionin dhe ligjet e tjera

3. RAPORTI I TË DREJTAVE TË MEDIAVE DHE I STANDARDEVE ETIKE TË PROFESIONIT TË GAZETARISË

- 3.1. Vetërregullimi i mediave
- 3.2. Deklarata mbi parimet e procedimit të gazetarëve para federatës ndërkombëtare të gazetarëve

4. PARIMI I VËRTETËSISË DHE I FUSHATËS MEDIALE

- 4.1. Parimi i vërtetësisë
- 4.2. Fyerja dhe shpifja në Serbi
 - 4.2.1. Vështrim i përgjithshëm ndaj fyerjes dhe shpifjes
 - 4.2.2. Përgjegjësia penale dhe sanksionimi penal për fyerje dhe shpifje (uvreda i kleveta si vepër penale)
 - 4.2.3. Përgjegjësia qytetare dhe kompensimi i dëmit për cënimin e nderit dhe të reputacionit (fyerja dhe shpifja „qytetare“)
- 4.3. Parimi i vërtetësisë si parim etik i fushatës mediale në kontekst të rolit të mediave në situatat e konfliktuoze dhe tensionuese

5. MBROJTJA E BURIMIT ANONIM DHE PËRCJELLJA E INFORMACIONIT TË CILAT VIJNË NGA BURIMET ANONIME

- 5.1. Vështrim i përgjithshëm
- 5.2. Standardi juridik i mbrojtjes së burimit anonim në dokumentet ndërkombëtare dhe në Serbi
- 5.3. Përcjellja e informacionit nga burimi anonim si parim etik
- 5.4. Përcjellja e informacionit nga burimi anonim si parim etik në kontekstin e rolit të mediave në situata konflikti dhe tensionesh

6. NDALIMI I FJALORIT TË URREJTJES SI STANDARD ETIK DHE JURIDIK

6.1. Nocioni i „fjalorit të urrejtjes“

6.2. Fjalori i urrejtjes dhe qëndrimi ideologjik, politik dhe kritik

6.3. Proceset dhe dokumentet të Këshillit të Europës që përkojnë me fjalorin e urrejtjes dhe mediat dhe kulturës së tolerancës

6.3.1. Proceset në Këshillin e Europës

6.3.2. Rekomandimi R (97) 20 mbi fjalorin e urrejtjes i Komitetit të ministrave të të këshillit të Europës

6.3.3. Rekomandimi R (97) 21 mbi mediat dhe promovimin e kulturës së tolerancës së Komitetit të ministrave të Këshillit të Europës

6.3.4. Rekomandimet dhe orientimet e Komisionit europian kundër racizmit dhe jotolerancës (ECRI)

6.4. Aktgjykimet e institucioneve gjyqësore ndërkombëtare dhe i institucioneve të tjera që përkojnë në ndalimin e diskriminimit dhe të fjalorit të urrejtjes

6.4.1. Aktgjykimet e Gjykatës penale ndërkombëtare për ish Jugosllavinë dhe Ruandën – Tribunali i Hagës

6.4.2. Aktgjykimet e Gjykatës europiane për të drejtat e njeriut në kontekstin e ndalimit të fjalorit të urrejtjes

6.4.3. Konstatimet e Komitetit për të drejtat e njeriut në kontesktin e fjalorit të urrejtjes

6.5. Legjislatura krahasimtare dhe praktika gjyqësore në disa vende europiane

6.5.1. Legjislatura në disa vende europiane

6.5.2. Praktika gjyqësore në disa vende europiane

6.6. Ndalimi i fjalorit të urrejtjes në legjislaturën e Serbisë

6.6.1. Ligji mbi ndalimin e diskriminimit

6.6.2. Ligji mbi informimin publik

6.6.3. Ligji mbi radiodifuzionin

6.6.4. Ligji mbi publikimin

6.6.5. Kodi penal

6.7. Parimi i ndalimit të fjalorit të urrejtjes së burimit të informacionit si parim etik në kontekstin e rolit të mediave në situatat e konfliktit dhe të tensioneve

FJALA HYRËSE

Ky doracak është hartuar në kuadër të projektit “**Përmirësimi i raportimit medial mbi çështjet e komuniteteve etnike dhe të pakicave në jugun e Serbisë perms trajnimit për redactor dhe grupe civile**”, të cilin e ka realizuar Qendra mediale dhe reformuese Nish në periudhën nga 14. dhjetori 2009. deri më 14. dhjetor 2010.

Qëllimi i këtij Doracaku është që t’i njoftojë gazetarët dhe redaktorët e mediave lokale por edhe qytetarët me rolin e mediave në parandalimin e konflikteve dhe të përgjegjësisë së tyre me rastin e raportimit në kushtet e tensioneve dhe në mjediset multietnike. Promovimi i kulturës së tolerancës është “çelësi”i rolit pozitiv të mediave dhe gazetarëve në shoqërinë demokratike.

Mjerishtë, vitet e luftës në dhjetëvjeçarin e fundit të shekullit 20, treguan në masë të madhe edhe anën „negative“ të gazetarisë dhe të mediave në Serbi. Edhe pas gati se rreth pesëmbëdhjetë vitesh të kaluara ende rreth këtij problemi zhvillohen diskutime të rëndësishme në qarqet gazetareske dhe profesionale. Gazetarët dhe mediat si promotorë të luftërave dhe politikës luftënxitëse që si pasojë e përhapjes së gjuhës së urrejtjes përmes mediave në vitet e luftës (mjerishtë në disa raste edhe sot) solli deri te format e rënda të „kriminalit nga urrjetja“, përkatësishtë vrasjeve, dhunës, diskriminimit dhe jotolerancës, janë alarm për të gjithë, e para së gjithash për gazetarët dhe mediat që kurr mos të harrojnë se liria e shprehjes, si e dretjë fundamentale e njeriut nuk është e drejtë „apsolute“, meqë edhe ajo i nënshtrohet kushteve, formaliteteve, kufizimeve dhe ndëshkimeve të përcaktuara me ligj, si të domosdoshme në shoqërinë demokratike.

Në pajtim me kërkesat e projektit, pjesa e parë e Doracakut – *Të drejtat e njeriut dhe të pakicave*, ka për qëllim t’i njohë gazetarët dhe redaktorët e mediave lokale mirëpo edhe qytetarët, mbi rëndësinë e të drejtave të njeriut dhe të pakicave në shtetin bashkëkohor demokratik.

Në këtë pjesë është përfshirë zhvillimi historik dhe koncepti i të drejtave të njeriut, klasifikimi i të drejtave të njeriut, veçmas është përpunuar nocioni dhe rëndësia e “të drejtave të pakicave” përmes dokumenteve të organizatave ndërkombëtare, si dhe rëndësia e ndalimit të diskriminimit në shoqërinë bashkëkohore. Gjithashtu, në këtë pjesë janë përfshirë edhe procedurat para gjykatave ndërkombëtare dhe trupave të tjerë para të cilave është e mundur “mbrojtja” e suksesshme e të drejtave të njeriut si dhe procedurat gjegjëse të cilat e mundësojnë një gjë të tillë në sistemin juridik të Republikës së Serbisë

Pjesa e dytë e Doracakut – *Liria e shprehjes dhe rëndësia e mediave në mjediset multietnike*, përkon me standardet juridike të lirisë së shprehjes të cilat dalin nga dokumentet e organizatave ndërkombëtare, të praktikës së gjykatave ndërkombëtare dhe të trupave të tjerë si dhe të dispozitave relevante kushtetuese dhe të ligjeve në Serbi me të cilat është rregulluar sfera e mediave ose se ato përkojnë tërthorazi ndaj tyre, e që janë me rëndësi për punën e gazetarëve, redaktorëve dhe mediave. Ajo që vërehet në shoqërinë bashkëkohore demokratike, është e a.q. vetërregullimi i mediave, gjegjësisht procesi në të cilin krahas normave juridike, për lirinë e të shprehurit rëndësi gjithnjë e më të madhe kanë edhe normat etike, të cilat i mbrojnë dhe i kultivojnë vetë përfaqësuesit e mediave. Në kontekst të rolit të mediave dhe gazetarëve në promovimin e tolerancës dhe të jodhunës në mjediset multietnike, mirëpo edhe të njohjes me „pasojat“ e mundshme të shkeljes së të drejtave të caktuara dhe të standardeve etike, në kuadër të kësaj pjese të Doracakut veçmas janë përpunuar standardet e vërtetësisë, të mbrojtjes dhe publikimit të informatës nga burimet anonime dhe të ndalimit të gjuhës së urrejtjes.

Doc. dr Dejan Milenković

Fakulteti i shkencave politike,

PARAFJALA

Raporti në mes të sektorit civil (organizatave joqeveritare) dhe mediave shpesh ngjanë në raportin mes të dashuruarëve që duhen shumë, që kanë qëllime të njëjta, mirëpo vazhdimishtë fjalosen dhe shpesh nuk e kuptojnë njëri tjetrin.

Organizatave joqeveritare, mu sikur mediat, punojnë në interesin publik, në interesin e komunitetit të tyre. Dallimi i vetëm në atë se mediat e kanë për detyrë që atë komunitet ta informojnë, ndërsa organizatat joqeveritare që ta përmirësojnë, t'i përmirësojnë kushtet në të cilat ato funksionojnë. Mirëpo organizatat joqeveritare shpesh nuk janë të kënaqura me mënyrën në të cilën mediat raportojnë rreth punës së tyre, nuk e kanë të qartë se cila është arsyeja që gazetarët nuk i përcjellin aktivitetet e tyre dhe përse ato janë aq pak të pranishme në media. Nga ana tjetër, në media nganjëherë nuk ka interes të mjaftueshëm për atë me të cilën merren organizatat joqeveritare, ato nuk i kuptojnë disa aktivitete të sektorit civil, ndërsa disa të tjera thjeshtë iu duken të mërzitshme (ose thënë ndryshe si jointeressante për raportim).

Në mjedisin tonë si organizatat joqeveritare ashtu edhe dhe mediat nganjëherë e kanë mbivlerësuar rolin e tyre, duke akuzuar njëra tjetrën për keqpërdorime të llojllojshme. Gjatë viteve të nëntëdhjeta, mediat proqeveritare i emërtonin organizatat joqeveritare si shoqata „tradhtare“ ose „mercenare“ të cilat mbijetojnë falë „parave amerikane“. Nga ana tjetër, pas ndryshimeve politike të vitit 2000, shumë organizata joqeveritare filluan me kritika shumë agresive ndaj mediave të caktuara si media të „shitura“, të cilat nuk raportojnë ashtu si duhet, të cilat punojnë në interes të njërit apo grupacionit tjetër. Si në situatën e parë po ashtu edhe në tjetrën, akterët e drejtëpërdrejtë kanë treguar

mosnjohje elementare të rolit të mediave, gjegjësisht të rolit të sektorit civil: në të dyja rastet, fjala ishte mbi „temën e huqur“. As që mediat mund ta shenjojnë këdo qoftë si „tradhëtarë“, e as sektori civil nuk është kompetent për politikën redaktuese të cilit do medium (përjashtimisht atyre që eventualisht vetë i themelojnë). Megjithatë mediat mund të tërheqin vëmendjen ndaj parregullësive në afarizmin e sektorit civil, pikërisht ashtu sikur që sektori civil mund të raportoj ndaj mosrrespektimit të kodeksit etik ose të ligjit mbi mediat në këtë apo në atë medium.

Sot ka gjithnjë e më pak mospajtimesh të tilla dhe gjithnjë e më pak kritika nesuvlisih. Për këtë pjesërisht ka kontribuar fakti se shumica prej tyre, ndaj edhe organizatat joqeveritare, janë „shpërngulur“ në hapësirën virtuale të internetit, në të cilin përmes bllogjeve dhe faqeve e njoftojnë opinionin publik për gjithçka për të cilën dëshirojnë ta informojnë. Mirëpo, meqë mediat tradicionale edhe më tej janë makineria mediale më e fuqishme, ende ekziston një moskuptim konstant mbi sasinë e hapësirës mediale i cili do t'i ofrohet organizatave joqeveritare si dhe mbi mënyrën se si kjo do të bëhet. Me qëllim të zgjidhjes së këtyre mosmarrëveshjeve, është e domosdoshme që si njëra po ashtu edhe pala tjetër të bëjnë lëshime të caktuara. Mediat do të duhej që më hollësisht t'i përcjellin aktivitetet e sektorit joqeveritar dhe që mes tyre edhe vet të gjejnë përmbajtje që do t'iu interesonte, që do të mund ta zgjeronin me përmbajtjet shtesë e që do të ishte atraktiv për publikun e gjerë. Nga ana tjetër sektori civil do të jetë më mirë i njoftuar me të drejtën dhe rolin e mediave mirëpo edhe të ketë parasyshë se shfaqjet në media kërkojnë përshtatje dhe taktikë të caktuar (ndonjëherë marketingu).

Ky doracak, i destinuar për organizatat joqeveritare dhe për përmirësimin e raportimit medial mbi komunitetet etnike, është vetëm se një hap i vogël në këtë drejtim. Jemi fokusuar para së gjithash në këshillat dhe udhëzimet praktike, duke tentuar që t'i demistifikojmë mediat dhe kështu t'ia afrojmë të gjithëve që kanë interes të paraqiten në media.

**PJESA E PARË
TË DREJTAT E NJERIUT DHE TË
PAKICAVE**

1. ZHVILLIMI HISTORIK DHE KONCEPTI I TË DREJTAVE TË NJERIUT

1.1. Zhvillimi historik i të drejtave të njeriut deri te lindja e konceptit të shtetit të së drejtës

Zhvillimi i shoqërisë njerëzore, e para së gjithash të shtetit dhe të së drejtës është i lidhur ngushtë me idenë e të drejtave dhe lirive të njeriut. Edhe pse mendimi politik në antikë nuk ishte “prijëtar” i idesë mbi të drejtat e njeriut, e ajo as ka mundur të ishte në kushtet e robërisë antike, qysh Stoikët tërhoqën vëmendjen ndaj idesë mbi barazinë e njerëzve, ndërsa Sofistët mbi ekzistimin e një të drejte “mbinatyrore” e cila gjendet mbi të drejtën “pozitive” në fuqi të cilën ajo dihet edhe ta synojë. Pra idetë pararendëse mbi të drejtat e njeriut i gjejmë qysh në shekullin e vjetër, mirëpo idea mbi të drejtat e njeriut vie në shprehje vetëm se në mesjetë në kushtet e monarkisë absolute. Kështu një sundimtar anglez – Jovani pa tokë qysh në fillim të shekullit të 13-të ishte i detyruar ta kufizojë pushtetin e vet të pakufishëm dhe të “ndajë” korpusin e parë të të drejtave të njeriut “të gjithë njerëzve të lirë edhe atë përgjithmonë”. Gjatë shekujve 17-të dhe 18-të, gjithashtu ishte aktualizuar çështja e disa komuniteteve fetare.

Kështu që shtetet gjatë kontratave bilaterale kanë marrë mbi vete dhe obligimin e mbrojtjes së të drejtave të komuniteteve fetare. Revolucionet e mëdha ka fundi i shekullit 18-të siç ishte revolucioni qytetar në Francë, të cilat në thelbin e tyre kishin synimin për liritë dhe barazinë e qytetarëve, sollën deri te “depërtimi” i rëndësishëm i të drejtave të njeriut. Gjithashtu Kushtetuta amerikane nga viti 1791 u plotësua me 10 amandamentet e para të cilat u emërtuan Billi mbi të drejtat dhe me ato u garantua gjenerata e parë e të drejtave themelore të njeriut, gjegjësisht të drejtat *qytetare dhe politike*.

Kushtetuta e ShBA-ve nga viti 1787 *e cila është në fuqi edhe sot*, përmbanë katër karakteristika themelore: *federalizmin, demokracinë, ndarjen e pushtetit dhe formën republikane të*

qeverisjes. Qysh në vitin 1791, janë ratifikuar edhe dhjetë amendamentet me të cilat ishin proklamuar **të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe qytetarit** (*Bill of Rights*), të cilat edhe sot e janë pjesë përbërëse të vetë Kushtetutës së vitit 1787. Në atë mënyrë, kjo Kushtetutë fiton edhe karakteristikën e *pestë*, thelbësore – **korpusin e gjeneruar të të drejtave themelore të njeriut të gjeneratës së parë – të drejtat qytetare dhe politike** (të drejtat e besimit, liria e të shprehurit, liria e tubimit, e drejta e privatësisë, e drejta në pasuri, e drejta në gjykim të drejtë e tj...) ¹

Në të njëjtën kohë, nga ana tjetër e oqeanit, nën ndikimin e revolucionit qytetar nga viti 1789, në Francë në shtator të vitit 1791 u miratua Kushtetuta e parë e Francës. Aprovimit të kësaj Kushtetute i kishte parapri miratimi i **Deklaratës mbi të drejtat dhe liritë e njeriut dhe qytetarit të vitit 1789** dhe se kjo, me aprovimin e Kushtetutës, u gjetë si Preambulë e saj. Deklarata mbi të drejtat dhe liritë e njeriut dhe qytetarit, gjithashtu sikur edhe 10 amandamentet e para në Kushtetutën e ShBA-ve, gjeneron *korpusin e të drejtave themelore të njeriut të gjeneratës së parë*, para së gjithash *të drejtat themelore natyrore të njeriut – lirinë, pronësinë, sigurinë dhe rezistencën kundër përndjekjes* mirëpo edhe *lirinë e besimit, të mendimit dhe të shprehurit, të drejtën në gjykim të drejtë* e tj. ² Vet deklarata, shprehimishtë na bënë të ditur lidhjen thelbësore të lirisë (të drejtës), **ndarjes së pushtetit dhe kushtetutës:**

“Shoqëria në të cilën *garantimi i të drejtave* nuk është e siguruar, ku *nuk është caktuar as ndarja e pushtetit*, nuk ka Kushtetutë.” ³

¹ Krahaso: Ljubica Kandić, *Odabrani izvori iz opšte istorije države i prava* (botim i shtatë), *Ustav Sjedinjenih Američkih država iz 1787. sa amandmanima*, Savremena administracija, Beograd, 1992, fq. 241-242.

² Krahaso: Ljubica Kandić, *Odabrani izvori iz opšte istorije države i prava* (sedmo izdanje), *Deklaracija o pravima čoveka i građanina* (26. gusht 1789.), Savremena administracija, Beograd, 1992, fq. 248-250.

³ Krahaso: Ljubica Kandić, *Odabrani izvori iz opšte istorije države i prava* (botim i shtatë), *Deklaracija o pravima čoveka i građanina* (26. gusht 1789.), Savremena administracija, Beograd, 1992, fq. 248-250.

Zhvillimi i kushtetutshmërisë në fillim të shekullit 19. solli edhe deri te lindja e të a.q. “koncepti primar (prvobitne) i shtetit të së drejtës”, në të cilën shteti kundorhej si “monopol i forcës fizike në shoqëri”, e që më tutje, “lidhte” veprimet e pushtetit, para së gjithash të ekzekutivit dhe administrimit për kushtetutën dhe ligjin. Kjo nënkuptonte dhe garancitë e shteteve nacionale të atëhershme se do të mbrojnë dhe garantojnë të drejtat e garantuara të gjeneratës së parë (qytetare dhe politike) me kushtetutë. Mirëpo, nga vetë shteti edhe varej se në ç’masë ato edhe do të jenë të respektuar, meqenëse të drejtat e njeriut nuk kanë patur dimension universal, ndërsa në rast të shkeljes së tyre nuk kanë ekzistuar mekanizmat mbrojtës mbinacional. Mirëpo edhe në këtë periudhë në disa raste, kishte ardhur deri te “internacionalizimi” i të drejtave të njeriut dhe deri te idea se të drejtat e njeriut nuk janë “të lidhura” ekskluzivishtë për sovranitetin shtetëror, në disa (edhe pse shumë të rralla) prej dokumenteve ndërkombëtare. Zhvillimi i të drejtës së të drejtave ndërkombëtare të njeriut lidhet me nënshkrimin e kontratave mbi ndalimin e tregëtisë me robër dhe me marrëveshjet ndërkombëtare mbi mbrojtjen e pakicave të krishtera në perandorinë Osmane (Turke), përkatësishtë me *Kontratën e Parisit* nga viti 1865 dhe me *Kontratën e Berlinit* nga viti 1878. në bazë të këtyre kontratave shtetet të cilat mbronin konceptin evropian, ndërmejtësuan me diplomaci e nganjëherë madje edhe duke intervenuar ushtarakishtë në dobi të popullatës së krishter në perandorinë osmane. *Kontrata e Berlinit nga viti 1878* veçanërishtë është interesant sepse disa bashkësive fetare iu njihte status të veçantë. Edhe pse pas Kontratës së Berlinit koncepti i internacionalizimit të (të gjeneratës së parë)të drejtave të njeriut ishte harruar për një kohë të gjatë madje edhe ishte hequr dorë prej tij, ai më vonë, pas Luftës së Dytë botërore, fiton afrimin e tij të plotë.

Mirëpo kjo nuk kishte ndodhur në periudhën në mes të dy luftërave botërore. *Pakti i Lidhjes së kombeve*, kontratë me të cilën në vitin 1920 u themelua Lidhja, *nuk kishte kurrfar dispozitash të përgjithshme mbi të drejtat e njeriut*. Mendimi se të drejtat e njeriut të gjeneratës së parë

– ato qytetare dhe politike, do të duhej të mbroheshin ndërkombtarishtë, nuk ishte pranuar ende nga ana e Komunitetit të atëhershëm të kombeve, e as që seriozishtë ishin shqyrtuar nga ana e atyre që e kishin përpiluar kontratën. Mirëpo, duhet theksuar se disa të drejta të pjesëtarëve të pakicave etnike, fetare dhe gjuhësore ishin të garantuara nga ana e Lidhjes së Popujve në mes të dy luftërave. Mirëpo të drejtat e njeriut, të gjeneratës së parë, qytetare dhe politike, u përcaktuan me kushtetutat e shteteve sovrane, që në atë kohë edhe më tej njiheshin vetëm se në *kufijtë e sovranitetit nacional*.

Me rastin e paraqitjes dhe të ndikimit të qasjeve të “reja” teorike nga njëra anë, mirëpo edhe pozitës gjithnjë e më të rëndë dhe të pabarazisë së punëtorëve në anën tjetër, në periudhën në mes të dy luftërave botërore, vie deri te lindja e shfaqja e idesë mbi nevojën e konstituimit të së a.q. *“gjeneratës së dytë të të drejtave të njeriut” – atyre ekonomike, sociale dhe kulturore*. Me propozim të komisionit të veçantë të konferencës së paqes në Paris, qysh në vitin 1919, u krijua njëra prej organizatave më të vjetra ndërkombëtare – *Organizata ndërkombëtare e punës (ONP)*, me qëllim që në gjithë botën t’i kontribuohet dhe të sigurohen kushte të volitshme për punë dhe të *sigurohet drejtësia sociale*. Edhe pse në kohën e krijimit të ONP, shprehja të drejtat e njeriut, nuk ishte e njohur në terminologjinë ndërkombëtare, kjo organizatë qysh nga filltet e para të saj iu ishte përkushtuar të drejtave të njeriut edhe atë në domenin që përkon me ekzistencën e njerëzve – *punën*.⁴ Të drejtat e gjeneratës së dytë, kanë karakter *programor, gradualishtë të realizueshme dhe nënkuptojnë shpenzime për shtetin*. Që ky qëllim edhe të realizohej, me rëndësi të madhe është roli i vetë shtetit, dhe se ky rol i shtetit vie në shprehje gjithnjë e më shumë pas Luftës së Dytë botërore.⁵

⁴ Krahajo: Vesna Petrović, *Međunarodni postupci za zaštitu ljudskih prava*, Beogradski centar za ljudska prava, Beograd, 2001, fq. 143-145.

⁵ Krahajo: Ivana Simonović-Hiber, Branislav Milinković, *Kulturna prava* Zborinik *Kulturna prava* Beogradski centar za ljudska prava, Beograd, 1999, fq. 105-108.

1.2. kritika e konceptit „të shtetit të së drejtës“ në periudhën mes dy luftërave

Natyrishtë edhe për fillimin e procesit të „internacionalizimit“ të të drejtave të njeriut të gjeneratës së parë, kishte qenë e nevojshme një „klimë“ e caktuar shoqërore. Ashtu menjëherë pas Luftës së parë botërore u fillua me kritikën e argumentuar të modelit primar të „shtetit të së drejtës“ nga shekulli 19. ky koncept nënkuptonte se çdo veprim i pushtetit ndaj qytetarëve është „legjitim“ nëse është „legal“. Pra veprimi i pushtetit është „i lejuar“ nëse është në pajtim me ligjin. Mirëpo, ekzistimi i *shtetit të së drejtës* më nuk ishte i vetëmjaftueshëm për sigurimin e *demokracisë dhe zhvillimit shoqëror*, meqenëse në pajtim me këtë interpretim, mund të biheshin ligjet mbi robërinë (skllavërinë) ose të formave të tjera të diskriminimit në mënyrë krejtësishtë „legale“, në procedurën e ligjshme parlamentare, gjë që rrezikonte dhe konceptin e gjeneratës së parë të të drejtave të njeriut – *qytetare dhe politike*, gjegjësishtë të a.q. „*konceptin e lirisë*“ (*liberte*). Për këtë me të drejtë ishte shtruar çështja mbi nevojën e përparimit të konceptit primar të shtetit të së drejtës (shtetit juridik). Ai *duhej patjetër të plotësohej* edhe me lelementet e tjera të rolit të shtetit me të cilat realizohen qëllimet sociale dhe të cilat, përveç aplikimit të së drejtës, do të sigurojë edhe *drejtësinë* dhe *drejtësinë sociale*.⁶

Gjermania fashiste ishte pikërishtë shembulli për mungesë imanente të konceptit parësor të shtetit të së drejtës, që më vonë solli deri te pasojat më të tmerrshme para dhe gjatë Luftës së Dytë botërore (vrasjeve, deportimit të hebrenjëve, krijimin e kampeve të përqëndrimit e tj.). Nacional-socialistët në krye me Hitlerin në mënyrë krejtësishtë *legale*, përmes shumicës parlamentare në Rajsstag (Kuvend) binin ligje, të cilat për nga natyra e tyre ishin të arritura antiqytetëruese, edhe pse i kënaqnin nevojat „populiste“ të shoqërisë së atëhershme gjermane. Disa

⁶ Krahaso: S. Lilić, P. Kunić, P. Dimitrijević, M. Marković, *Upravno pravo*, Savremena administracija, Beograd, 2000, fq. 30.

prej ligjeve për shembull, në rrënjën e tyre kishin idenë mbi lartësueshmërinë racore dhe të dimitit të racës Ariane. Kjo para së gjithash përkonte me të a.q. Ligjet e Nyrbergut, më saktë të **Ligjit mbi mbrojtjen e gjakut dhe të nderit gjerman** dhe **Ligji mbi shtetësinë e Rajhut** nga viti 1935. i pari ndalonte lidhjet martesore dhe ato jashtëmartesore në mes të „hebrenjëve“ (i cili më vonë edhe zyrtarishtë u përdor në vend të termit „jo Arianët“) dhe gjermanëve. I dyti i kishte hequr hebrenjëve të drejtën në shtetësinë gjermane dhe futi dallimin në mes të „qytetarëve të Rajhut“ dhe të qytetarëve të tjerë. Me këto ligje u formalizuan deri atëherë masat e veçanta të paformalizuara dhe jo të zyrtarizuara të cilat ishin ndërmarrë ndaj hebrenjëve. Liderët e nacionalsocialistëve, veçonin rëndësinë e konzistencës së legjislativit me programin e partisë së tyre, që kërkonte që hebrenjëve t’i merren të drejtat që kanë pasur qytetarët. Me këto ligje në mënyrë krejtësishtë „legale“ **kishin vepruar organet gjermane të shtetit**, meqenëse vetë ligji përkatësishtë norma juridike ishte bazë dhe arsyetim për veprimin e tyre.

Për këtë arsye pas Luftës së dytë botërore u fillua me hulumtimin e përparimit të konceptit parësor të shtetit të së drejtës, ndërsa të drejtat e njeriut pushuan së qeni shprehje e “sovrانيتit” të shtetit të së drejtës, duke fituar **karakter universal**. Edhe te koncepti parësor i shtetit të së drejtës u desht patjetër të përparohet, meqenëse nuk ishte e mjaftueshme që veprimet e pushtetit të jenë legale përkatësishtë në pajtim me ligjin por edhe legjitim nga pikëpamja e arsyeshmërisë shoqërore. Standardi i shoqërisë demokratike për këtë nënkuptonte para së gjithash rrespektimin e të drejtave të njeriut, ndërsa me krijimin e organizatës së Kombeve të bashkuara, të drejtat qytetare dhe politike marrin një karakter universal, e mandej edhe mekanizma mbinacional të mbrojtjes së tyre. Rol të rëndësishëm në këtë proces ka pasur Këshilli i Europës si organizatë e parë paneuropiane regjionale e cila u krijua pas Luftës së dytë botërore në vitin 1949.

Kryesishtë, e gjithë kjo kontriboi riafrimit të ri të **teorisë natyrorejuridike**, e cila qysh nga kohërat më të moçme nënkuptonte

ekzistimin e një të drejte pozitive, që shprehë përvojën dhe të drejtës tjetër, të lartësuar në mënyrë klerarkike, të ***drejtës natyrore***, i cili në përmbajtjen e vet është e drejtë, ndërsa për nga vlefshmëria është objektive.⁷ Drejtimet themelore të shollës së të drejtës natyrore, krahas dallueshmërisë në interpretimin filozofik, duke filluar prej botëkuptimeve ***teologjike-rationale dhe biologjike-rationale e deri te botëkuptimet e sotme bashkëkohore***, mund të përmbliidhen në konstatimin: ***se krahas të drejtës pozitive ekziston edhe një e drejtë e drejtësisë së lartësuar e cila do të duhej të ishte shmebull për të drejtën pozitive***. Kjo është e drejta natyrore.⁸ Ajo në shprehjen e saj normative ka përjetuar një ngritje të fuqishme, ose më saktë, ajo përjetoi renesansën e saj menjëherë pas përfundimit të Luftës së Dytë botërore – me themelimin e Organizatës së Kombeve të bashkuara e cila qysh në dokumentet e saja të para “kurorëzoi” të drejtat e njeriut dhe mbrojtjen e tyre. Vetë shprehja “***e drejta natyrore***” u ndryshua me shprehjen “***të drejtat e njeriut***”.⁹ Të drejtat e njeriut bëhen ...”***ato të drejta subjektive të cilat qenia njerëzore i ka pa marrë parasyshë nga vullneti i shtetit dhe ligjëdhënësit, pa diskriminim dhe pa marrë parasyshë në meritat eventuale, me vetë faktin që është qenie njerëzore***”.¹⁰

1.3. Koncepti i „shtetit social“ dhe rëndësia e organizatave ndërkombëtare në zhvillimin e të drejtave të njeriut pas Luftës së Dytë botërore

Para dhe mbi të gjitha dokumentet e Kombeve të bashkuara, dokumenti me të cilin të drejtat e njeriut përfundimishtë fituan karakter ndërkombëtar e internacional ishte ***Deklarata universale mbi të drejtat***

⁷ Krahaso: Radmila Vasić, Kosta Čavoški, *Uvod u pravo*, "Draganić", Beograd, 1996, fq.14.

⁸ Krahaso: Slobodan Perović *Prirodno pravo i sud*, Pravni fakultet Univerziteta u Beogradu, Udruženje pravnika Srbije, Beograd, 1996, fq. 93.

⁹ Krahaso: Slobodan Perović, *Prolegomena sudijske nezavisnosti*, Udruženje pravnika Srbije, Institut za uporedno pravo u Beogradu, Beograd, 1998, fq. 51.

¹⁰ V. Dimitrijević, M. Paunović, V. Đerić, *Ljudska prava – udžbenik*, Beogradski centar za ljudska prava, Beograd, 1997, fq. 26.

e njeriut (1948).¹¹ Ky paraqet deri më tani kodifikimin më të plotë të së drejtës natyrore që është bërë në historinë e së drejtës. Për nga numri dhe përmbajtja e të drejtave të njeriut, Deklarata universale paraqet grupimin e të gjitha të drejtave të cilat në të kaluarën janë shënuar qoftë në dokumente ligjore dhe deklarata të popujve të ndryshëm në kohë të ndryshme, qoftë në opuset mendore të filozofëve të rëndësishëm dhe të juristëve të këtij apo atij shekulli. Për më tepër, meqenëse kjo Deklaratë e zgjeroi institucionin e të drejtave të njeriut, duke ia shtuar të drejtave klasike “të drejtave politike dhe qytetare” të gjeneratës së parë dhe gjeneratën e dytë të të drejtave të njeriut ato “ekonomike, sociale dhe kulturore”, gjë e cila për herë të parë u konstituan në këtë Deklaratë kur bëhet fjalë për regjistrimin e të drejtave të njeriut, nëse e kemi parasyshë retrospektivën e kësaj çështjeje.¹² Kjo mandej në vitin 1966, solli deri te lindja e **Paktit të Kombeve të bashkuara mbi të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore**. Me Protokolin opcionues krahas Paktit mbi të drejtat qytetare dhe politike u konstitua edhe kompetenca e Komitetit të KB për të drejtat e njeriut, si mekanizëm mbinacional „të mbrojtjes“ të të drejtave të përcaktuara në Pakt. Nga ana tjetër, në Europë, Këshilli i Europës qysh në vitin 1950 miratoi **Konventën europiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore** (në të cilën ishin përfshirë të drejtat qytetare dhe politike). Të drejtat e përfshira në Konventë mbroheshin përmes mekanizmave mbinacional të mbrojtjes të formësuar në Gjykatën europiane mbi të drejtat e njeriut. Kështu karahas mbrojtjes kushtetuese në sistemet juridike nacionale, të drejtat e njeriut fitojnë edhe formë të zgjeruar të mbrojtjes, të cilat i tejkalojnë konceptin e „sovrانيتit nacioanl“.

Mirëpo edhe ky koncept u mundësua të jetësohet vetëm pas përparimit të konceptit parësor të shtetit të së drejtës, më saktë, me

¹¹ *Universal Declaration of Human Rights*, është aprovuar dhe proklamuar me *Rezolutën 217A (III)* të Kuvendit të përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara të mbajtur më 10.12.1948..

¹² Krahaso: Slobodan Perović, *Prolegomena sudijske nezavisnosti*, Udruženje pravnika Srbije, Institut za uporedno pravo u Beogradu, Beograd, 1998, fq. 52-55.

mënjanimin e „defektit“ të tij të përmendur më parë. Kështu lind nocioni i *shtetit social (Welfare state)* i cili *definohet jo si instrument i pushtetit* por si *shtet që kujdeset mbi mirëqenien e qytetarëve të vet, të përparimit të përgjithsëm shoqëror dhe kulturor, të zhvillimit të prodhimit dhe shërbimeve si dhe përgjithësishtë mirëqenien sociale*.¹³ Nocioni i shtetit të së drejtës kështu merr një *dimension të ri*, meqë përparon modelin formal, normativistik të drejtësisë dhe *vërtetësisë* në thelbin e të cilës janë të drejtat natyrore. Në këtë koncept të përparuar, *veprimi i pushtetit jo vetëm se që duhet patjetër të jetë legal* (në pajtim me ligjin) *por edhe legjitim nga pikëpamja e arsyeshmërisë shoqërore*. Andaj, procedura të caktuara (p.sh. sjellja e ligjeve, dekreteve ose të akteve individuale ose ushtrimi i ndonjë veprimi) nuk bëhet legjitim me atë se e ka zbatuar shteti ose ndonjë organ i tij në pajtim me ligjin, porse arsyeshmëria e secilit veprim konkret ose akti duhet patjetër të vlerësohet edhe në bazë të arsyeshmërisë së përmbajtjes së tij.¹⁴

Në vendet e zhvilluara demokratike të perëndimit, koncepti parësor “formalo – normativistik” i shtetit të së drejtës për këtë është tejkalar qysh moti. *Njohja e idesë mbi të drejtën natyrore dhe të drejtat ndërkombëtare të njeriut si ideal të shoqërisë moderne*, i dha një nxitje shtesë ndryshimit dhe të përparimit të konceptit parësorë të shtetit të së drejtës. Edhe pse as kjo nuk ishte gjithkund njësoj. Në konceptin parësor të shtetit të së drejtës kanë mbetur regjimet jodemokratike para së gjithash ato komuniste në të cilat shteti dhe pushteti, gjithnjë deri te rënia e këtij sistemi në vitet e '90-ta të shekullit 20-të edhe më tej e përjetonin si monopol të forcës fizike dhe të detyrimit në shoqëri. Koncepti i përparuar teorik i shtetit të së drejtës, përkatësishtë koncepti i *shteti social* thuhet se është nocion identik i *sudimit të së drejtës (Rule of Law)*. Ky nocion është pasojë e praktikës në sistemin e të drejtës anglosanksonë dhe për nga natyra e tij ka qenë

¹³ Krahaso i: Stevan Lilić, *Upravno pravo*, "Savremena administracija", Beograd, 1998. fq. 28.

¹⁴ Krahaso: Džon Rols, *Teorija pravde*, Beograd-Podgorica, 1998.

më i zgjeruar nga nocioni parësor i shtetit të së drejtës “formalo-normativiste”. Nocioni *sundimi i së drejtës* ka dalur nga botëkuptimi se nuk është e mjaftueshme që pushteti shtetëror të jetë i kufizuar me të drejtën, por është qenësore edhe ajo që *e drejta të jetë me përmbajtje të duhur* gjë e cila na sjell te *lidhja e të drejtës me drejtësinë, ligjet morale dhe doket e tjera të lashta*. Përbërës i rëndësishëm i këtij sistemi është edhe pozita e pavarur dhe e mëvetësishme e gjyqësorit dhe gjykatësve, në autoritetin e të cilëve, të ndërtuar në bazë të rrespektimit të natyrshëm, spontan dhe ndër shekuj të formësuar, ekziston sistemi anglosankson i të **drejtës tradicionale (Common Law-a)**.¹⁵

¹⁵ Krahaso: Radmila Vasić, *Princip vladavine prava*, Zbornik: *Ustavnost i vladavina prava*, CUPS, Beograd, 2000. fq. 16-17.

2. KLASIFIKIMI I TË DREJTAVE TË NJERIUT

2.1. Vështrim i përgjithshëm në të drejtat qytetare dhe politike si të drejta të gjeneratës së parë

Me zhvillimin e të drejtave të njeriut, me kalimin e kohës lindi nevoja edhe për klasifikimin e tyre. Sot më së shpeshti flitet për tri gjenerata të të drejtave të njeriut. Në gjeneratën e parë të drejtave të njeriut hyjnë *të drejtat qytetare dhe politike*, në të dytën të drejtat *ekonomike, sociale dhe kulturore*, ndërsa në të tretën *të drejtat e solidarësisë*. Mirëpo me rastin e „klasifikimit“ të të drejtave të njeriut, disa teoricienë janë nisur edhe prej kriterëve të ndryshme siç janë: koha e lindjes dhe e garantimit të të drejtave, bërjen e dallimit në mes të të drejtave themelore dhe të nxjerrura –; natyra e aktiviteteve të cilat i ndërmerr shteti me qëllim të realizimit të grupit të caktuar të të drejtave të njeriut ose dallimi i subjektit të të drejtave, gjë që nënkupton ndarjen e tyre në të drejta individuale dhe ato kolektive.¹⁶ Duke ia lënë këto dilema teoricientëve, në këtë vend do të flasim vetëm se në ndarjen në të drejtat e gjeneratës së parë, të dytë dhe të tretë.

Të drejtat e gjeneratës së parë para së gjithash kuptohen në kuptimin negativ, si „e drejta që“ ... ose „e drejta nga...“. ato shprehin konceptin e lirisë (liberte). Këto janë të drejtat klasike *qytetare dhe politike*, të cilat realizohen përmes idesë së lirisë të kuptuar si mburojë që ruan individin ose grupin nga keqpërdorimi i politikës. Të drejtat më të rëndësishme nga ky grup janë përmbajtur në nenet prej 2 -21 të *Deklaratës universale mbi të drejtat e njeriut* (ndalimi i robërisë dhe torturës dhe të sjelljeve të tjera vrazhdëta dhe nënçmuese, e drejta e mendimit dhe e shprehjes së besimit, e drejta e të shprehurit, liria e tubimit paqësor dhe e bashkimit), si dhe në *Paktin ndërkombëtar mbi të drejtat qytetare dhe politike (1966)* dhe *Konventën europiane për*

¹⁶ Krahaso: V. Dimitrijević, A. Kartag-Odri, B. Milinković, J-L Serfonten, I. Simović-Hiber, B. Stojković, *Kulturna prava*, Beogradski centar za ljudska prava, Beograd, 1999. fq. 105.

mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore (krahas të përmendurave edhe e drejta në jetë, e drejta në liri dhe siguri, e drejta për gjykim të drejtë, e drejta e privatësisë e tj.) për të drejtat e gjeneratës së parë shpesh thuhet se ato janë *apsolute*, menjëherë të realizueshme dhe nuk paraqesin kosto për shtetin, meqenëse aksioni i saj kryesishtë përmbledhet në përmbajtjen e shtetit, mirëpo nuk është kështu edhe për gjeneratën e dytë të të drejtave të njeriut.¹⁷

2.2. Vështrim i përgjithshëm në të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore si të drejta të gjeneratës së dytë dhe të tretë

Të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore si të drejta të gjeneratës së dytë **shprehin konceptin e barazisë (egalite)**. Mirëpo për dallim nga të drejtat e gjeneratës së parë, të drejtat e gjeneratës së dytë (e drejta në punë, e drejta në zgjedhjen e lirë të profesionit dhe punësimit, e drejta në standardin jetësor që i përgjigjet dinjiteti njerëzor, e drejta në mbrojtjen e shëndetit, e drejta në sigurinë sociale, e drejta e nënës dhe fëmijëve në mbrojtjen e veçantë dhe të tjera) kanë karakter të të drejtave programore, gradualishtë të realizueshme dhe nënkuptojnë shpenzime të konsiderueshme për shtetin. Shpesh për to thuhet se ato kanë karakter të *idealit*, përkatësishtë të *të drejtave objektive*, të drejta të cilat vetëm pas rregullimit juridik objektiv duhet të shëndërrohen në të drejta subjektive të njeriut. Për realizimin e këtij qëllimi, është me rëndësi të madhe roli vetë shtetit. Sipas disa botëkuptimeve, të drejtat e gjeneratës së parë qëndrojnë – në konceptin individualistik, ndërsa të drejtat e gjeneratës së dytë paraqesin edhe të drejta kolektive, në kuptimin se nuk i takojnë ekskluzivishtë individit por edhe ndaj kolektiviteteve të ngushta apo të zgjeruara të formuar sipas kriterëve të

¹⁷ Krahaso: V. Dimitrijević, A. Kartag-Odri, B. Milinković, J-L Serfonten, I. Simović-Hiber, B. Stojković, *Kulturna prava*, Beogradski centar za ljudska prava, Beograd, 1999. fq. 105.

ndryshme. Në të vërtetë, të drejtat e gjenratës së dytë, janë një farë lloji „mesogjeneratë“ e të drejtave të njeriut meqenëse subjekt i tyre janë individët dhe kolektivitetet. Rëndësia e shtetit në realizimin e të drejtave sociale, ekonomike dhe kulturore e përcakton edhe **Pakti ndërkombëtar mbi të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore**, i cili në nenin 2. i obligon shtetet nënshkruese që të ndërmarrin hapat ..., **deri në maksimumin e mjeteve në dispozicion**“,... me qëllim të realizimit të të drejtave të përcaktuara me këtë Pakt. Kësaj gjenerate të të drejtave të njeriut i takojnë të a.q. të drejtat kulturore. Nëse i vështrojmë vetëm se të drejtat kulturore, disa prej tyre janë më të afërta me të drejtat qytetare dhe politike, e disa të tjera me ato ekonomike dhe sociale. Nëse të drejtat e „pakicave“ i vështrojmë edhe përmes prizmit të të drejtave kulturore, mundë të vërejmë se disa nga ato si p.sh. e drejta në ruajtjen e identitetit kulturor të një grupi pakicë, është shumë e vjetër. Qysh në mesjetë kështu është vërejtur **rëndësia e mbrojtjes së pakicave fetare**. Një cilësi e rëndësishme e të drejtave kulturore është në atë se ato mund të kuptohen edhe si të drejta individuale dhe grupore. Subjekt i tyre mund të jetë secila qenie njerëzore, por edhe një kolektivitet i caktuar.

Për shkak të rëndësisë së kulturës autonome për zhvillim dhe ekzistencë si grup shoqëror, më së shumti vëmendje tërheqin grupet nacionale dhe etnike si subjekt i të drejtave kulturore. Të drejtat kulturore shpesh janë shumë të „afërta“ dhe ndërthurren me dia nga të drejtat politike. Për shembull, meqenëse përkatësia fetare mund të jetë një karakteristikë e rëndësishme e identitetit kulturor të dikujt, lidhja e të drejtave kulturore dhe fetare imponohet vetvetiu. Ngjajshëm është edhe me të drejtën e lirisë së bashkimit e cila është e mundur të kuptohet edhe si instrument i domosdoshëm që në mënyrë gjegjëse të mundë të realizohen qëllimet e identitetit kulturor të pakicës ose grupit. Nëse nuk ka garancione të forta të lirisë së bashkimit (tubimit, shoqërimit) që do të siguronte që identiteti kulturor të fitonte kornizën e tij organizuese dhe formën shfaqëse, ajo atëherë as që do të ekzistonte. Kështu e drejta e tubimit dhe të drejtat kulturore gjenden në raportin e ndërsjellë për

nga forma dhe përmbajtje.¹⁸

Gjeneratën e tretë të të drejtave të njeriut e përbëjnë të a.q. të drejtat e solidarësisë (fraternite). Ky është një grup jo aq i sistemuar dhe i të drejtave të reja e jo të afërta mes veti në masë të mjaftueshme, siç është e drejta në mjedis të shëndoshë jetësor, e drejta në paqe, e drejta në vetëvendosje dhe e drejta në zhvillim. Subjekt i të drejtave të njeriut të gjeneratës së tretë janë gjithmonë grupe të caktuara, gjegjësisht kolektivitetet.¹⁹

¹⁸ Krahaso: V. Dimitrijević, A. Kartag-Odri, B. Milinković, J-L Serfonten, I. Simović-Hiber, B. Stojković, *Kulturna prava*, Beogradski centar za ljudska prava, Beograd, 1999. fq. 106-107; 112-118.

¹⁹ Krahaso: V. Dimitrijević, A. Kartag-Odri, B. Milinković, J-L Serfonten, I. Simović-Hiber, B. Stojković, *Kulturna prava*, Beogradski centar za ljudska prava, Beograd, 1999. fq. 106.

3. „TË DREJTAT E „PAKICAVE“

3.1. Zhvillimi historik i të drejtave të pakicave

Në Europë, veçmas në periudhën pas reformacionit protestan, fati i pakicave fetare u bë një çështje shumë serioze, e cila tani më nuk ishte gjë vetëm e shteteve të përfshira në këtë problem, porse depërtoi thellë në mardhëniet ndërkombëtare. Në atë kohë, dëshira e theksuar për mbrojtjen e pakicave fetare shërbente si arsytim për shumë intervenime të vendeve të huaja, si për Shqipëri, e Anglisë në dobi të Valdezhanasve në Francë në vitin 1655, të internevimeve të shumta të Holandës në dobi të kalvinistëve francezë si dhe të Suedisë dhe Prusisë në vitin 1707 në dobi të protestantëve në Poloni. Kjo i shtyri shumë vende europiane që në mardhëniet e ndërsjellta të kontraktoshin obligimin që pakicave fetare t'i lejojnë që lirishtë ta shprehin besimin e vet pa frikë nga përndjekja. Kështu në një numër të kontratave bilaterale gjatë shekujve 17 dhe 18, ishin paraparë edhe dispozita lidhur me pakicat fetare si për shembull në marrëveshjen e Vestfalisë në mes të Francës dhe Mbretërisë së shenjtë romake nga viti 1648, i cili lejonte liritë fetare për protestantët në Gjermani nën kushtet e njëjta të cilat i gëzonin romanokatolikët. e tillë ishte p.sh. Marrëveshja e Nixhmegenit, e lidhur më 1678 në mes të Francës dhe Holandës dhe i disa marrëveshjeve të tjera.²⁰

Duke filluar nga shekulli 19. paraqitet ndryshimi në qasjen e shtetit ndaj ndërmarrjeve ndërkombëtare lidhur me raportet ndaj pakicave. Fillojnë të paraqiten dispozitat mbi mbrojtjen e pakicave në instrumentet multilaterale, për dallim nga periudha e mëparshme, kur ato paraqiteshin vetëm se në kuadër të marrëveshjeve bilaterale. Marrëveshja e Parisit nga viti 1856 e lidhur në mes të Austrisë, Francës,

²⁰ Krahaso: Françesko Kapotorti (Raportuesi special i Nënkomisionit për parandalimin e diskriminimit dhe mbrojtjes së pakicave), *Prava pripadnika etničkih, verskih i jezičkih manjina*, në përkthim të Komitetit të juristëve për të drejtat e njeriut., Beograd, 2001, fq. 25-27.

Britanisë së Madhe, Prusisë, Sardenjës dhe Turqisë, në nenin 9. kishte të bënte paraqitjen e sulltanit turk palëve të tjera kontraktuese, me rastin e legjislaturës të cilën e kishte futur me qëllim të njohjes, kryesisht në dobi të banorëve të krishterë të perandorisë së tij – barazinë në raportet ndaj tyre, pa dallime fetare ose racore. Nga ana tjetër, palët kontraktuese kishin faleminderuar rëndësinë e një komunikimi të tillë. Dispozita të llojit të ngjajshëm, gjendeshin mandej edhe në marrëveshjen e Berlinit të vitit 1878, i cili hoqi të gjitha dallimet në raportet në përputhje me bazat fetare në shtetet e posakrijuara të Ballkanit.²¹

Në Konferencën paqësore të vitit 1919 në Paris, me rastin e përgatitjes së **projektit të Paktit të Shoqërisë së popujve**, mjaft u diskutua mbi përfshirjen e obligimit të shteteve që të inkuadrojnë raport të barabartë dhe mbrojtje të pakicave racore dhe nacionale në dispozitat e Paktit. Mirëpo kjo nuk ndodhi. Megjithatë, menjëherë pas kësaj (1919-1920) u miratuan pesë marrëveshje mbi pakicat, mandej edhe katër marrëveshje të veçanta dhe pesë deklarata të njëanshme, të cilat i nënshkruan shtete të ndryshme në periudhën e viteve 1921-1932, kështu që u krijua një regjim specifik i mbrojtjes së pakicave i cili në vete përmbante dy lloje të dispozitave: të parat, të cilat do të duhej të siguronin trajtim të njëjtë ndaj pjesëtarëve të grupacioneve pakicë dhe e dyta që përmbanin masa të veçanta të mbrojtjes së atyre grupacioneve.²²

²¹ Krahaso: Françesko Kapotorti (Raportuesi special i Nënkomisionit për parandalimin e diskriminimit dhe mbrojtjes së pakicave), *Prava pripadnika etničkih, verskih i jezičkih manjina*, në përkthim të Komitetit të juristëve për të drejtat e njeriut., Beograd, 2001, fq. 25-27.

²² Krahaso: Françesko Kapotorti (Specijalni izvestilac Potkomisije za sprečavanje diskriminacije i zaštite manjina), *Prava pripadnika etničkih, verskih i jezičkih manjina*, në përkthim të Komitetit të juristëve për të drejtat e njeriut., Beograd, 2001, fq. 25-27.

3.2. Koncepti i të drejtave të pakicave në Kombet e bashkuara dhe në Këshillin e Europës

Deklarata universale mbi të drejtat e njeriut, e aprovuar në vitin 1948., nga ana e kuvendit të përgjithshëm të Kombeve të bashkuara, **nuk përmbante dispozita të veçanta mbi të drejtat e pakicave**, para së gjithash, për të drejtat e veçanta të pjesëtarëve të pakicave etnike, fetare dhe gjuhësore.

Mirëpo një qëndrim i tillë, u tregua i gabueshëm, meqenëse mungesa e mbrojtjes së veçantë e grupeve pakicë të përmendura dhe garancionet e veçanta të të drejtave të tyre, shpesh ishte shkak i mosdurimit nacional, fetar dhe etnik që kishte sjellur edhe deri te konfliktet etnike, fetare dhe nacionale, të kryengritjeve të armatosura dhe konflikteve në gjithë botën. Për këtë qysh në disa prej dispozitave të ***Konventës mbi parandalimin dhe ndëshkimin e krimit të gjenocidit (1948)*** si dhe me ***Konventën nr. 107*** të Organizatës ndërkombëtare të punës që kishte të bënte me popullatën vendëse dhe fisnore (1957), janë futur nocionet dhe termet siç është rasti me termin grupacionet *nacionale, etnike ose fetare*, gjë që kishte një rëndësi të madhe për vazhdimin e mëtejshëm të përpjekjeve të Kombeve të bashkuara në zgjidhjen e këtij problemi.

Pakti mbi të drejtat qytetare dhe politike të cilin Kuvendi i përgjithshëm i Kombeve të bashkuara e ka aprovuar ka fundi i vitit 1966 përmbanë formulimin e qartë, që sot paraqet kornizën e përgjithshme të mbrojtjes dhe të përparimit të të drejtave të pjesëtarëve të pakicave etnike, fetare dhe gjuhësore. Përndryshe, me nenin 27. të Paktit është përcaktuar:

„Në shtetet ku ka pakica etnike, fetare ose gjuhësore, personat që i përkasin këtyre pakicave nuk mund të jenë të privuar nga e drejta që në bashkësi me anëtarët e tjerë të grupit të tyre të kenë jetën e tyre të pavarur kulturore, që ta shprehin besimin e vet dhe që t'i ushtrojnë obligimet fetare, ose ta përdorin gjuhën e tyre“.

Domosdoshmëria e implementimit urgjentë të nenit 27 të paktit mbi të drejtat qytetare dhe politike në legjislativat nacionale, kushtëzoi edhe nevojën për aprovimin dhe aplikimin e dokumenteve dhe të instrumenteve të reja në kuadër të Kombeve të bashkuara. Kështu Nënkomisionet për parandalimin e diskriminimit dhe të mbrojtjes së pakicave të Këshillit ekonomik dhe social qysh në vitin 1967 aprovoi rezolutën nr. 9. (XX) me të cilën ishte paraparë që sa më parë të jetë e mundur të fillohet me një *studim gjithëpërfshirës* mbi implementimin e parimeve të përmbajtura në nenin 27. të Paktit mbi të drejtat qytetare dhe politike. Në rekomandimin e **Komisionit të Kombeve të bashkuara për të drejtat e njeriut të, Këshillit ekonomik dhe social** me rezolutën 1418 (XLVI) ga viti 1969 kishte autorizuar **Nënkomisionin për parandalimin e diskriminimit dhe për mbrojtjen e pakicave** të caktojë **Raportuesin special** i cili do të merrej ekskluzivishtë me këtë problem dhe të hartoj studimin mbi implementimin e parimeve gjë e cila edhe u bë në vitin 1971.

Njëra nga detyrat themelore të Raportuesit special, *ishte që* të përgatisë një raport gjithëpërfshirës, përkatësishtë të hartoj studimin mbi implementimin e parimeve të përmbajtura në nenin 27 Paktit mbi të drejtat qytetare dhe politike si dhe për mundësitë e përpunimit të mëtejshëm të tyre. Studimi **Të drejtat e pjesëtarëve të pakicave etnike, fetare dhe gjuhësore pikërishtë edhe ishte raporti përfundimtar**, të cilin **Raportuesi special Francesco Capotorti** në vitin 1977 ia kishte paraqitur **Komisionit për të drejtat e njeriut dhe Këshillit ekonomik dhe social**. Për shkak të rëndësisë shumë të madhe të këtij raporti, trupat në fjalë të Kombeve të bashkuara në vitin 1978, kërkuan nga Sekretari i përgjithshëm të KB që raporti të jetë i publikuar në të gjitha gjuhët zyrtare të Kombeve të bashkuara dhe t'i dërgohet vendeve anëtare. Ky ishte **Projekt Deklarata mbi të drejtat e personave të cilët i përkasin pakicave etnike, fetare dhe gjuhësore.**²³

²³ Krahaso: (UN doc. E/CN4./1.1367/ REV. 1,2 March 1978).

Komisioni për të drejtat e njeriut pas një pune shumëvjeçare në projektin e propozuar, përfundimishtë, përmes rezolutës 1992/16 të datës 21. shkurt 1992, aprovoi *Projekt Deklaratën mbi të drejtat e pjesëtarëve të pakicave nacionale ose etnike, fetare dhe gjuhësore*. Pas aprovimit të Projektit nga ana e komisionit për të drejtat e njeriut mandej edhe nga ana e këshillit ekonomik dhe social, Projekt Deklaratën në tekstin e propozuar e aprovoi edhe Kuvendi i përgjithshëm i Kombeve të bashkuara më 18. dhjetor 1992.

Menjëherë pas kësaj, në vitin 1993, në *Konferencën botërore mbi të drejtat e njeriut* të mbajtur në Vjenë u aprovua *Deklarata e Vjenës dhe programi i veprimit*. Ajo një pjesë të saj (në nenet 25-27), përkon edhe ndaj personave – pjesëtarë të pakicave nacionale, etnike, fetare ose gjuhësore dhe në to, mes tjerash theksohet:

„Konferenca botërore mbi të drejtat e njeriut i nxitë shtetet dhe bashkësinë ndërkombëtare që promovojnë dhe mbrojnë të drejtat e personave pjesëtarë të pakicave nacionale ose etnike, fetare ose gjuhësore në pajtim me Deklaratën mbi të drejtat e pjesëtarëve të pakicave nacionale, etnike, fetare ose gjuhësore. Masat që do të ndërmerren, atje ku kjo është e nevojshme, do të duhej të lehtësonin ndërveprimin e tyre të plotë në të gjitha aspektet e jetës politike, ekonomike, sociale, fetare dhe kulturore të shoqërisë si dhe në përparimin ekonomik dhe të zhvillimit të vendeve të tyre“.

Sa i përket Këshillit të Europës, gjithësesi se dokumenti më i rëndësishëm i cili ka të bëjë ndaj të drejtave të pakicave është miratuar në vitin 1994. fjala është mbi *Konventën kornizë për mbrojtjen e pakicave nacionale*, të cilën e ka aprovuar Komitetit i ministrave të Këshillit të Europës në nëntor të vitit 1994.²⁴

²⁴ Konventa kornizë për mbrojtjen e pakicave nacionale, Komiteti i ministrave të Këshillit të Europës, nëntor 1994. ish-Jugosllavi e kishte ratifikuar këtë Konventë me Ligjin mbi vërtetimin e Konventës kornizë për mbrojtjen e pakicave nacionale 1998, „Fl. Zyrtare e RFJ“ 6/98.

Konventa parashehë se mbrojtja e pakicave nacionale dhe të drejtat dhe liritë e pjesëtarëve të pakicave janë pjesë përbërëse e mbrojtjes të të drejtave njerëzore. Të drejtat e përcaktuara në Konventë janë caktuar si të drejta „individuale“ po ashtu edhe „kolektive“, më saktë, në vetë fillimin e Konventës thuhet se të drejtat e përcaktuara me Konventë pjesëtarët e pakicave nacionale mund t'i ...“gëzojnë individualisht ose në bashkësi me të tjerët“. Ashtu siç do të shihet në vazhdim, nuk bëhet fjalë për të drejta të „reja“, por me të drejtat të cilat do të duhet të mundësojnë njëjtësinë dhe barazinë e pakicave nacionale në realizimin e të drejtave themelore të njeriut, para së gjithash atyre qytetare dhe politike, por edhe të të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore.

Palët nënshkruese obligohen që pjesëtarëve të pakicave nacionale t'i garantojnë barazinë para ligjit dhe mbrojtje të njëjtë ligjore. Në këtë kuptim është e ndaluar çfardo diskriminimi në bazë të përkatësisë së pakicës nacionale. Parimi i barazisë dhe ndalimi i diskriminimit për këtë janë parimi themelor që përkon ndaj mbrojtjes së pakicave nacionale (mbi këto më gjerësisht do të bëhet fjalë pak më vonë). Konventa kornizë imponon edhe obligimin e palëve kontraktuese të ndërmarrin të a.q. masat e „aksionit pozitiv“, më saktë masa gjegjëse ashtu që në të gjitha sferat e jetës ekonomike, shoqërore, politike dhe kulturore të sigurohet barazia e plotë dhe vërtetë e pjesëtarëve të pakicave nacionale dhe i pjesëtarëve shumicë. Masat e tilla nuk do të konsiderohen akte diskriminuese. Gjithashtu, palët kontraktuese obligohen që të krijojnë kushtet e nevojshme ashtu që pjesëtarët e pakicave nacionale të ruajnë dhe zhvillojnë kulturën e tyre dhe të ruajnë elementet e domosdoshme të identitetit të tyre, si religjionin, gjuhën, traditën dhe trashëgiminë kulturore dhe do të përmbahen nga politika ose praktika që kanë për qëllim asimilimin e pjesëtarëve të pakicave nacionale kundër vullnetit të tyre dhe do t'i mbroj këta persona prej çfardo aksioni të orientuar në drejtim të këtij asimilimi. Ato do të ndërmarrin masat përkatëse me qëllim të mbrojtjes së personave që mund t'i ekspozohen kërcënimeve ose diskriminimit ose dhunës për

shkak të identitetit të tyre etnik, kulturor, gjuhësor dhe fetar. Palët kontraktuese do të sigurojnë rrespektimin e drejtave të secilit pjesëtar të pakicës nacionale në lirinë e tubimit paqësor, lirinë e bashkimit, lirinë e shprehjes dhe lirinë e mendimit, bindjeve dhe fesë dhe obligohen që të pranojnë se secili pjesëtar i pakicës nacionale ka të drejtë ta shprehë religjionin ose fenë e tij dhe të konstitujë institucionet, organizatat dhe shoqatat fetare.²⁵

Kur është fjala për lirinë e të shprehurit, **Konventa kornizë** në mënyrë shumë të detajuar i përcakton të drejtat e pjesëtarëve të pakicave në realizimin kësaj lirie. Në të vërtetë, palët kontraktuese obligohen se do ta njohin se e drejta në lirinë e shprehjes e secilit pjesëtar të pakicës nacionale përfshinë lirinë e të menduarit dhe pranimit dhe të përcjelljes së informatave dhe ideve në gjuhën e pakicës pa përzierjen e organeve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Palët kontraktuese në kuadër sisteme ve të tyre juridike do të sigurojnë që pjesëtarët e pakicave nacionale të mos jenë të diskriminuar në qasjen e tyre në mjetet e informimit publik. Palët kontraktuese nuk do të pengojnë krijimin dhe shfrytëzimin e mjeteve të shtypura të informimit nga ana e pjesëtarëve të pakicës nacionale. Në kornizat ligjore për radio dhe televizion, do të sigurohen sa të jetë e mundur, që pjesëtarët e pakicave nacionale të fitojnë mundësinë e krijimit dhe të shfrytëzimit të mjeteve të veta të informimit. Palët kontraktuese në kuadër të sistemeve të tyre juridike do të aprovojnë masa përkatëse ashtu që pjesëtarëve të pakicave nacionale t'ia lehtësojnë qasjen në media, me qëllim të rritjes së tolerancës dhe të mundësimit të pluralizmit kulturor.²⁶

Palët kontraktuese obligohen ta pranojnë se secili pjesëtar i pakicës nacionale ka të drejtë që lirishtë dhe pa qenë i penguar ta shfrytëzoj gjuhën e vet amëtare, në jetën private dhe publike, gojarishtë

²⁵ *Zakon o potvrđivanju Okvirne konvecije za zaštitu nacionalnih manjina* „Službeni list SRJ – međunarodni ugovori“ 6/98, čl. 4-8.

²⁶ *Krahaso: Zakon o potvrđivanju Okvirne konvecije za zaštitu nacionalnih manjina* „Službeni list SRJ – međunarodni ugovori“ 6/98, čl. 9.

(të folurit) ose me shkrim. Mandej në trevat tradicvionalishtë apo dukshëm të banueshme nga pjesëtarët e pakicave nacionale, t'iu sigurojnë në masën që kjo është e mundur, përdorimin e gjuhës së pakicës në raportet në mes të pjesëtarëve të pakicave nacionale dhe organeve administrative, mandej, që në gjuhën e pakicës të jetë i informuar mbi arsyet e burgosjes dhe të shkakut të akuzës kundër tij, që t'i vendosin emërtimet tradicionale lokale, emërtimet e rrugëve dhe të shenjave të tjera topografike të dedikuara opinionit edhe në gjuhën e pakicës, të ndërmarrin masa në sferën e arsimit dhe hulumtimit me qëllim të kultivimit të kulturës, gjuhës dhe besimit të pakicave nacionale, mandej mundësitë e njëjta në qasjen ndaj arsimit, ta pranojnë se secili pjesëtar i pakicës nacionale ka të drejtë ta mësojë gjuhën e vet amëtare, të mos e pengojnë të drejtën e pjesëtarit të pakicës nacionale që të themelojnë dhe të mbajnë kontakte paqësore dhe përtejkuftare me personat të cilët qëndrojnë ligjshëm në shtetet e tjera, në veçanti me ata me të cilët kanë identitet të përbashkët etnik, kulturor, gjuhësor dhe fetar ose trashëgimi të përbashkët kulturore e tj.²⁷

3.3. Problemi i caktimit të nocionit „pakicat“

Edhe pse një mori dokumentesh ndërkombëtare, konventash, rezolutash të organizatave ndërkombëtare madje edhe marrëveshje bilaterale shpesh thirren në „pakicat“, megjithatë nuk ekziston një definim përgjithësishtë i pranueshëm i këtij nocioni. Krijimi i definicionit, që do të mund të ishte përgjithësishtë i pranueshëm, është një problem shumë i ndërlikuar. Arsyeja për këtë është se me rastin e caktimit të këtij nocioni duhet të merren parasyshë patjetër rrethna të ndryshme. A është fjala për raport numerik të një grupi „pakicë“ ndaj popullatës së përgjithshme, ose aspekti kuantitativ është i shkallës së dytë e që nuk ka kurrfarë rëndësi? A mos me rastin e caktimit të këtij nocioni, duhet nisur nga elementet subjektive, si për shembull ndonjë

²⁷ Krahaso: *Zakon o potvrđivanju Okvirne konvencije za zaštitu nacionalnih manjina* „Službeni list SRJ – međunarodni ugovori“ 6/98, čl. 10-19.

cilësi personale e individit? A mos prejardhja e „pakicave“ është qenësore për definimin tyre? A mos nocioni „pakicat“ për shembull i nënkupton personat të cilët kanë orientime të ndryshme seksuale e të ngjajshme. Procesi i definimit dhe asaj që “përfshinë nocioni pakicë” para OKB-ës ka zgjatur rreth 50 vjet. Në një Memorandum të Sekretarit të përgjithshëm të Kombeve të bashkuara nga viti 1950, u konstatua se termi “pakicë” nuk mundë të definohej me interpretim të zbrazët të kuptimit të fjalëpërfjalshëm të kësaj fjale. Nëse do të veprohej kështu, nën nocionin pakicë do të mund të përfshiheshin thuaja se të gjitha komunitetet të cilat ekzistojnë në një shtet, përfshirë këtu edhe familjet, klasat shoqërore, grupet kulturore, folësit e dialekteve të caktuara e tj. Dhe se kishte konstatuar se definimi i tillë do të ishte i padobishëm.²⁸

Në kuadër të Këshillit të Europës, gjatë viteve nëntëdhjeta të shekullit 20.-të ka ekzistuar idea e mbrojtjes së pjesëtarëve të pakicave nacionale, përmes futjes së Protokolit shtesë krahas Konventës europiane, që është dashur të përkonte me personat që i përkasin pakicave nacionale, me synimin që të mundësohet që të drejtat e pakicave të mbrohen para Gjykatës europiane për të drejtat e njeriut. Ky propozim megjithatë nuk u aprovua, mirëpo teksti i tij iu shtua Rekomandimit 1201 të Kuvendit parlamentar të Këshillit të Europës, që përkon me mbrojtjen e pakicave nacionale nga viti 1993, dhe ishte kusht i rëndësishëm m rastin e pranimit të mëvonshëm të anëtarëve të ri në Këshillin e Europës. Menjëherë pas kësaj, në vitin 1994 Këshilli i Europës aprovoi i Konventës kornizë për mbrojtjen e pakicave nacionale.²⁹

²⁸ Krahaso: Françesko Kapotorti (Raportuesi special i Nënkomisionit për parandalimin e diskriminimit dhe mbrojtjes së pakicave), *Prava pripadnika etničkih, verskih i jezičkih manjina*, në përkthim të Komitetit të juristëve për të drejtat e njeriut., Beograd, 2001, str. 35-73.

²⁹ Krahaso: Françesko Kapotorti (Raportuesi special i Nënkomisionit për parandalimin e diskriminimit dhe mbrojtjes së pakicave), *Prava pripadnika etničkih, verskih i jezičkih manjina*, në përkthim të Komitetit të juristëve për të drejtat e njeriut., Beograd, 2001, str. 50.

Në kuadër të Këshillit të Europës, gjatë viteve nëntëdhjeta të shekullit 20.-të ka ekzistuar idea e mbrojtjes së pjesëtarëve të pakicave nacionale, përmes futjes së Protokolit shtesë krahas Konventës europiane, që është dashur të përkonte me personat që i përkasin pakicave nacionale, me synimin që të mundësohet që të drejtat e pakicave të mbrohen para Gjykatës europiane për të drejtat e njeriut. Ky propozim megjithatë nuk u aprovua, mirëpo teksti i tij iu shtua Rekomandimit 1201 të Kuvendit parlamentar të Këshillit të Europës, që përkon me mbrojtjen e pakicave nacionale nga viti 1993, dhe ishte kusht i rëndësishëm m rastin e pranimit të mëvonshëm të anëtarëve të ri në Këshillin e Europës.³⁰ Menjëherë pas kësaj, në vitin 1994 Këshilli i Europës aprovoi i Konventës kornizë për mbrojtjen e pakicave nacionale.

Në nenin 14. të Konventës europiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore që kanë të bëjnë me ndalimin e diskriminimit dhe të Protokolit të Romës nr. 12. nga viti 2000 krahas Konventës (me të cilën u përcaktua ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit), si dhe në Konventën kornizë, përdoret shprehja „pakica nacionale“. Për këtë edhe shtrohet pyetja se a mos këto dy terme, njëri që përdoret në Kombet e Bashkuara dhe tjetri në Këshillin e Europës, e „mbulon“ të njëjtën përmbajtje. Shqyrtimi i bazës së mundshme për definimin e pakicave nacionale, që do të mundësohet që të nxjerret nga krahasimi i neneve të përmendura të dokumenteve ndërkombëtare të përmendura të dy organizatave ndërkombëtare nuk ka dhënë përgjigje të qartë, mirëpo menjëherë u shtrua edhe pyetja tjetër: a ekzistojnë fare pakicat nacionale, fetare dhe gjuhësore të cilat nuk janë pakica nacionale? Në shumicën e rasteve një „pakicë nacionale“ në të njëjtën kohë paraqet edhe pakicën etnike, gjuhësore ose fetare. Mirëpo, nga ana tjetër, ekzistojnë edhe dëshmi të qarta mbi ekzistimin e pakicave të

³⁰ Krahaso: V. Dimitrijević, A. Kartag-Odri, B. Milinković, J-L Serfonten, I. Simović-Hiber, B. Stojković, *Kulturna prava*, Beogradski centar za ljudska prava, Beograd, 1999. str. 108.

caktuara etnike, gjuhësore ose fetare, të cilat nuk janë edhe „pakica nacionale“, andaj ekziston edhe problemi me definimin e definicionit përgjithësishtë të pranuar të nocionit „pakica nacionale“.³¹

Mirëpo mbetet e „hapur“ një çështje tjetër. Meqenëse nocioni pakica nacionale e përfshirë përmes „ndalimit të diskriminimit“ ndërsa ndalimi i diskriminimit gjithashtu është i lidhur me vetitë personale të individit, a mos veti të caktuara personale të cilat i posedon një grup i personave (prejaardhja sociale, gjendja ekonomike e t.j.), gjithashtu mund të jenë bazë për caktimin e nocionit „pakicë“ mirëpo në një kontekst më të gjerë? Duke mos hapur dilema shtesë ose shqyrtime teorike, ky Doracak, ka të bëjë kryesishtë me të drejtat e pjesëtarëve të „pakicave nacionale“, në kontekst të pakicës etnike, fetare dhe gjuhësore.

³¹ Krahaso: Françesko Kapotorti (Raportuesi special i Nënkomisionit për parandalimin e diskriminimit dhe mbrojtjes së pakicave), *Prava pripadnika etničkih, verskih i jezičkih manjina*, në përkthim të Komitetit të juristëve për të drejtat e njeriut., Beograd1, str. 50.

4. NDALIMI I DISKRIMINIMIT NË DOKUMENTET MË TË RËNDËSISHME NDËRKOMBËTARE DHE NË KUSHTETUTËN E REPUBLIKËS SË SERBISË

4.1. Ndalimi i diskriminimit në disa dokumente ndërkombëtare

Çështja e të drejtave të pakicave etnike, fetare dhe gjuhësore, ose të „pakicave nacionale“, është ngushtë e lidhur me *ndalimin e diskriminimit* për të cilën kemi folur në pjesën e mëparshme.

Në Povelja të Kombeve të bashkuara, të miratuar në vitin 1945, në pikën (c) të nenit 55. i obligon të gjithë anëtarët në „rrespektimin e të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore për të gjithë, pa dallim race, gjinie, gjuhe dhe feje“.

Deklarata universale e KB mbi të drejtat e njeriut në nenet 1. dhe 2. të gjithë njerëzve iu garanton lirinë dhe barazinë në dinjitet dhe të drejta, pa marrë parasysh në „çfardo dallimi siç është raca, ngjyra e lëkurës, gjinia, gjuha, feja, orientimi politik apo tjetër, prejardhja nacionale ose shoqërore, pronësia, lindja ose ndonjë status tjetër“.

Pakti mbi të drejtat qytetare dhe politike. Shtetet sot kanë obligim ligjor që të sanksionojnë fjalorin e urrejtjes që del nga standardet ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut, para së gjithash të nenit 20. alinea 2. të *Paktit mbi të drejtat qytetare dhe politike (1966)* me të cilin është përcaktuar: „me ligj do të ndalohet çfardo propagandimi i urrejtjes nacionale, racore ose fetare që nxitë diskrimin, armiqësi ose dhunë“.

Në komentin e përgjithshëm nr. 11. që ka të bëjë me nenin 20. të *Paktit* jipet një sqarim shtesë se “neni 20. mund të hyjë plotësishtë në fuqi vetëm nëse ekziston ligji (nacional) nga i cili është e qartë se janë përshkruar propaganda dhe avokimi në kundërshtim me politikën publike, edhe pse ekzistojnë masa të përshtatshme të sanksionimit në rast të shkeljes së atij ligji” (*CCPR General comment 11. 29/07/83.*).

Konventa ndërkombëtare mbi heqjen e të gjitha formave të diskriminimit racor Dokumenti kryesor i KB në luftën kundër racizmit dhe diskriminimit është ***Konventa ndërkombëtare mbi heqjen e të gjitha formave të diskriminimit racor*** (1965) me të cilën mes tjerash është përcaktuar: „***Shtetet anëtare gjykojnë çfardo propagande dhe të gjitha organizatat të cilat udhëhiqen me idetë ose teoritë që bazohen në superioritetin e ndonjë race ose grupi të personave të një ngjyre të caktuar ose të një origjine të caktuar etike*** ose që dëshirojnë ta arsyetojnë ose përkrahin çfardo forme të urrejtjes racore dhe diskriminimit.

Ato obligohen që pa shtyerje t’i aprovojnë masat pozitive të cilat kanë për qëllim të heqin çfardo nxitje në diskriminim të tillë, ose në çfardo vepre të diskriminimit në veçati obligohen: **1) t’i përcaktojnë si vepra penale çfardo përhapje të ideve të bazuara në superioritetin ose urrejtjes racore**, çfardo nxitje në diskriminim racor, si edhe të gjitha veprat e dhunës, ose të shkakutimit të dhunës së tillë, të orientuar kundër të gjitha racave ose të ndihmës ndaj aktiviteteve raciste, duke nënkuptuar me këtë rast edhe financimin e tyre; **2) që të deklarojnë se janë të paligjshme dhe t’i ndalojnë organizatat dhe aktivitetet e propagandës së organizuar dhe të gjitha llojet e tjera të aktiviteteve propaganduese të cilat nxisin në diskriminim racor** dhe të cilët ndihmojnë, si dhe që të deklarojnë se pjesëmarrja në këto organizata ose në aktivitetet e tyre është vepër e ndëshkueshme; **3) që mos ta lejojnë pushtetin publik e as enteve publike nacionale ose lokale që të nxisin diskriminimin racorose ta ndihmojnë atë.** Në kuadër të masave pozitive antidiskriminuese, shtetet anëtare duhet patjetër përmes gjykatës dhe institucioneve të tjera shtetërore të sigurojnë zhdëmtimin e personave të dëmtuar përmes diskriminimit racor (neni 6.), ***ndërsa institucionet arsimore, informative dhe kulturore duhet të ndër marrin masa për luftë kundër paragjytimeve dhe të promovimi të mirëkuptimit, tolerancës dhe miqësisë në mes popujve dhe grupeve racore dhe etnike*** (neni 7.). Këto masa janë detajizuar në ***Deklaratën e UNESCO-s mbi racën dhe paragjykimet racore*** nga viti 1978.

Përpos me këto dokumente, të cilët kanë fuqi obligative juridike për shtetet të cilat i kanë ratifikuar, si edhe për Serbinë, ekzistojnë edhe dokumentet e tjera të KB të fuqisë së ndryshme juridike e që i përkasin parandalimit të diskriminimit, si për shembull *Konventa mbi heqjen e të gjitha formave të diskriminimit të grave, Deklarata mbi të drejtat e personave të cilët i takojnë pakicave nacionale ose etnike, fetare dhe gjuhësore, Deklarata mbi heqjen e të gjitha formave të jotolerancës dhe diskriminimit në themel të religjionit ose fesë, Parimet e KB mbi personat e moshuar, Deklarata mbi të drejtat e personave me të meta mentale, Deklarata mbi të drejtat e invalidëve, Konventa mbi statusin e refugjatëve dhe të tjera.*

Konventa europiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore u aprovua në Romë në vitin 1950, është dokument themelor i Këshillit të Europës me të cilin ndalohet diskriminimi. Konkretisht, *neni 14.* i Konventës europiane parasheh që ...“*gëzimi i të drejtave dhe i lirive të parapara në këtë Konventë siguron pa diskriminim sipas çdo baze, siç janë gjinia, raca, ngjyra e lëkurës, gjuha, besimi, mendimi politik dhe tjetër, prejardhja nacionale dhe sociale, lidhja me ndonjë pakicë nacionale, gjendja ekonomike (pasurisë) ose statusit tjetër. Me Protokolën 12. të konventës europiane të miratuara në vitin 2.000, vendet anëtare bënë vërtetime shtesë për nevojën e „ndalimit gjithëpërfshirës të diskriminimit“, e në veçanti nga ana e organeve të pushtetit publik. Serbia në vitin 2004 ka ratifikuar Konventën europiane dhe protokolën dhe ato u bënë tani pjesë përbërëse *rendit të brendshëm të Republikës së Serbisë.**

Mbi rëndësinë e dokumenteve të tjera të Këshillit të Europës që përkrijnë me ndalimin e diskriminimit dhe të disa aspekteve të ndalimit të diskriminimit, në veçanti të atyre që përkrijnë me fjalorin e urrejtjes si dhe të praktiës gjyqësore të gjykatës europiane për të drejtat e njeriut mirëpo edhe të Komitetit të KB për të drejtat e njeriut lidhur me diskriminimin dhe fjalorin e urrejtjes, do të flasim në pjesën e dytë të

këtij Doracaku.

Parimi i jodiskriminimit, ndaj, është me rëndësi qenësore për kuptimin e të drejtave të „pakicave“ të kuptuara si të drejta të pjesëtarëve të pakicave etnike, fetare dhe gjuhësore. Këto të drejta i takojnë „pakicave nacionale“ sikur **grup**, dhe si **individë të pjesëtarëve të grupit të caktuar**. Qëllimi i „të drejtave të pakicave“ është që të „barazohet“ pozita e „pakicave“ përkatësishtë të personave të grupeve pakicë në mundësinë e sigurimit dhe të realizimit të të drejtave të tjera të njeriut, para së gjithash, atyre qytetare dhe politike, mirëpo edhe i të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore. Në këtë kontekst, të drejta të caktuara të pakicave sipas „përmbajtjes“ së tyre shpesh ndërthurren me të drejtat e tjera, mirëpo qëllimi themelor i tyre është sigurimi i barazisë së pakicave me popullin „ shumicë“ që jeton në territorin e një shteti. Për këtë, ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit ka një rëndësi shumë të madhe për pjesëtarët e pakicave etnike, fetare dhe gjuhësore.

Në të gjitha dokumentet ndërkombëtare të cilat flasin mbi të drejtat dhe liritë e njeriut, e me vetë këtë edhe mbi nevojën e luftës kundër racizmit dhe diskriminimit racor litet edhe mbi nevojën e parandalimit të „fjalorit të urrejtjes“, meqë „fjalori i urrejtjes“ **nxitë, arsyeton ose e madhështon diskriminimin në bazë të dallimeve etnike, gjinore, fetare, gjuhësore ose të ndonjë dallimi tjetër**. Falori i urrejtjes, i cili „përhapet“ përmes mediave, mundë të jetë shumë i rrezikshëm veçams në mjediset multietnike. Për këtë çështja e raportit të lirisë së shprehjes, ndalimit të diskriminimit dhe të drejtave të pakicave, është e rëndësishë thelbësore për rolin e mediave (lokale) në kushtet e tensionimeve në mjediset multietnike. Pjesa e dytë e Doracakut pikërishtë i është kushtuar këtij raporti.

1.3. Ndalimi i diskriminimit në Kushtetutën e Republikës së Serbisë

Kushtetuta e Republikës së Serbisë në nivelin deklarativ garanton barazinë e qytetarëve dhe e *ndalon diskriminimin*, kështu që në nenin 1. definojnë se Republika e Serbisë është shteti i popullit serb dhe i të gjithë qytetarëve që jetojnë në të, i bazuar në sundimin e së drejtës dhe drejtësisë sociale, parimeve demokratike, të drejtave dhe lirive të njeriut dhe pakicave dhe i përkatësisë së parimeve dhe vlerave europiane.

Kushtetuta e Republikës së Serbisë në nenin e veçantë i cili është emërtuar ndalimi i diskriminimit, proklamon se para kushtetutës dhe ligjit të gjithë janë njësoj, se secili ka të drejtë në mbrojtje të njëjtë ligjore, pa diskriminim si dhe është i ndaluar çdo diskriminim, i drejtëpërdrejtë apo i tërthortë, mbi çfardo baze, e në veçanti mbi bazë racore, gjinore, *përkatësisë nacionale*, të prejardhjes shoqërore, lindjes, *besimit*, të bindjeve politike ose të tjera, gjendjes ekonomike (pasurisë), kulturës, *gjuhës*, moshës dhe të invaliditetit fizik ose psikik. Kushtetuta parashehë edhe se me diskriminim nuk konsiderohen masat e veçanta të cilat mund t'i ndërmerret Republika e Serbisë me qëllim të arritjes së barazisë së plotë të personave dhe grupeve të personave të cilët janë në pozitë thelbësisht të pabarabartë me qytetarët e tjerë³²

Ndalimi i veçantë i diskriminimit të pakicave nacionale është përcaktuar gjithashtu në nenin e veçantë. Pjesëtarëve të pakicave nacionale Kushtetuta i garanton barazinë para ligjit dhe mbrojtje të njëjtë ligjore dhe e ndalon, përpos diskriminimit pozitiv, çfardo diskriminimi për shkak të përkatësisë së pakicës nacionale. Lidhur me ndalimin e e diskriminimit janë edhe një mori dispozitash të tjera kushtetuese, e disa nga ato kanë të bëjnë drejtëpërsëdrejti me pakicat nacionale.

³² Krahaso: *Ustav Republike Srbije*, „Službeni glasnik RS“ br. 98/06, čl. 21.

Ligji mbi ndalimin e diskriminimit (2009) se ligji „kulmor” në këtë fushë gjithashtu ka vend të rëndësishëm në ndalimin e diskriminimit të pakicave nacionale, përkatësishtë të pjesëtarëve të pakicave etnike, fetare dhe gjuhësore, për këtë edhe këtë do ta përfshijmë më së pari në pjesën që i përket të drejtave të pakicave nacionale në Serbi.³⁴

³³ Krahaso: *Ustav Republike Srbije*, „Službeni glasnik RS“ br. 98/06, čl. 76.

³⁴ Krahaso: *Zakon o zabrani diskriminacije*, „Službeni glasnik RS“ br.

5. MEKANIZMI I MBROJTJES SË TË DREJTAVE TË NJERIUT PARA GJYKATAVE NDËRKOMBËTARE DHE TRUPAVE TË TJERË

5.1 Vështrim i përgjithshëm

Me paktin mbi të drejtat qytetare dhe politike (1966) më saktë me *Protokolin opcional* të cilin e ka ratifikuar edhe Serbia si suksesor juridik i ish vendeve të krijuara me shkatërrimin e ish-Jugosllavisë me mandej edhe të Bashkësisë shtetërore Serbia dhe Mali i Zi), u konstitua kompetenca e Komitetit për të drejtat e njeriut për shkeljen e të drejtave të njeriut të parapara me Paktin.

Me Konventën mbi të drejtat e njeriut të Organizatës së shteteve amerikane (OAS) u konstitua Gjykata për të drejtat e njeriut të Organizatës së shteteve amerikane që mbron të drejtat e njeriut të përcaktuara me këtë Konventë.

Me Konventën europiane për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut (1950) u themelua edhe Gjykata europiane për të drejtat e njeriut. Kështu të drejtat e njeriut në vendet anëtare të këshillit të Europës (anëtare e së cilës Serbia është bërë në vitin 2003, kur edhe e ka nënshkruar KE e mandej edhe e ka ratifikuar dhe ia ka paraqitur dokumentet instrumentet ratifikuese Këshillit të Europës në mars të vitit 2004) mbrohen edhe para Gjykatës europiane për të drejtat e njeriut.

Deri më tani Gjykatë europiane për të drejtat e njeriut i janë drejtuar më shumë se 2.000 qytetar të Serbisë, ndërsa kjo gjykatë ka aprovuar deri më tani 20 aktgjykime kundër Serbisë për shkak të shkeljes së të drejtave të njeriut të përcaktuar në Konventë.

Pakti mbi të drejtat qytetare dhe politike dhe Komiteti i KB për të drejtat e njeriut

Komiteti i Kombeve të bashkuara për të drejtat e njeriut është themeluar me pjesën e katërt të paktit mbi të drejtat qytetare dhe politike. Që shkeljet eventuale të të drejtave të njeriut të përcaktuara me paktin me të vërtetë dhe të „rishqyrtohen“ nga ana e Komitetit, nevojitet që shteti jo vetëm se të ketë ratifikuar paktin, por edhe protokolin fakultativ krahas paktit mbi të drejtat qytetare dhe politike. Ish RSFJ qysh në vitin 1971. kishte ratifikuar paktin, ndërsa pakti ka hyrë në fuqi më vitin 1976, kur 35 shtete anëtare deponuan instrumentet për ratifikimin e tij. Mirëpo FRJ vetëm në vitin 2001, e ratifikoi edhe protokolin fakultativ, me ç'rast u vendos edhe kompetenca e Komitetit. Nga viti 2001 e deri më sot, gjithësejt disa qytetar të Serbisë i është drejtuar Komitetit, ndërsa rasti më i fuqishëm ishte ai i gazetares Zhele Bodrozhiq kundër Serbisë, i cili para Komitetit u përfundua në vitin 2005, rreth së cilës do të bëhet fjalë më vonë.

Komiteti për të drejtat e njeriut i përbërë prej 18 anëtarësh. Anëtarët duhet patjetër të kenë kualitete të larta morale dhe kompetentshmërinë e njohur dhe të pranuar në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, ndërsa disa prej anëtarëve duhet patjetër të jenë jurist. Anëtarët e Komitetit mandej e zgjedhin kryetarin, tre nënkryetar dhe raportuesin në periudhën e caktuar kohore, ndërsa Komiteti ka edhe Sekretariatin e vet me të cilin udhëheq Sekretari i përgjithshëm.

Komiteti i ka tri kompetenca thelbësore: (1) t'i zgjidhë kontestet në mes të shteteve antare në rast të shkeljes së Paktit; (2) t'i shqyrtoj raportet e shteteve anëtare mbi realizimin e të drejtave të përcaktuara me këtë pakt dhe (3) t'i shqyrtoj dhe të vendosë mbi parashtrësat e individëve nga shtetet anëtare të Paktit për shkak të shkeljes së pretenduar nga ata të të drejtave të tyre të përcaktuar me paktin. Kjo e fundit, don të thotë, se nënkupton se secili qytetari shtetit që ka

ratifikuar Paktin dhe protokolën, ka mundësi që me parashtrësë t'i drejtohet Komitetit kur konsideron se e drejta e tij, e përcaktuar me pakt, është shkelur, me kusht që paraprakishtë të jenë shterrur të gjitha mjetet juridike në shtetin – anëtar, si dhe të kushteve të tjera formale të përcaktuara me rregulloren (rregullat e procedimit të Komitetit).

Pas pranimit të parashtrësës dhe të përcaktimit se a janë përmbushur kushtet formale, Komiteti e drejton parashtrësën shtetit – anëtar kundër të cilës është ushtruar parashtrësja. Në gjashtë muajt e radhës shteti është i obliguar që Komitetit t'ia dërgoj sqarimet me shkrim ose deklaratën e cila duhet t'i kontribuojë zgjidhjes së rastit. Rregullat e përmendura të procedimit parashohin që me qëllim të përshpejtimit të procedurës (meqë me kalimin kohës numri i parashtrësëve rritje gjithnjë e më tepër), formohen grupe punuese të cilat mundë të jenë të përbëra më së shumti me nga pesë anëtarë të cilat i shqyrtojnë parashtrësat dhe i paraqesin Komitetit si dhe Raportuesit special rekomandimet mbi pranueshmërinë e tyre. Komiteti në seancën jopublike e shqyrton parashtrësën dhe propozim orientimin e mandej e njofton shtetin e interesuar dhe individin me gjetjet e konstatuara. Sekretariati është ai i cili i shpërndan orientimet bashkë me rekomandimet.³⁵

5.3. Konventa europiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore dhe Gjykata europiane për të drejtat e njeriut

Gjykata europiane për të drejtat e njeriut është themeluar me pjesëne dytë të Konventës europiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore nga viti 1950.³⁶ Gjykata duhej të

³⁵ Më detajishtë mbi Rregullat e procedimit të Komitetit: Dejan Milenković, *Zaštita ljudskih prava pred Komitetom za ljudska prava Ujedinjenih nacija*, Lex forum, 1-4, 2006. Pravnicu za demokratiju, Beograd, fq. 7-21.

³⁶ Krahaso: *Evropska konvencija za zaštitu ljudskih prava i osnovnih sloboda*, čl. 19-51.

paraqiste një mekanizëm mbinacional për mbrojtjen e të drejtave të njeriut të të drejtave nga gjenerata e parë të përfshira në pjesën e parë të Konventës, më saktë të drejtat qytetare dhe politike. Gjykata filloi punën në vitin 1959. për t'u siguruar rrespektimi dhe aplikimi i obligimeve të Konventës, qysh para krijimit të gjykatës filloi me punën Komisioni për të drejtat e njeriut (1954). Në periudhë deri në vitin 1998, ekzistonte një sistem «dublimi» i organeve i llojit të vet, me ç'rast një rol të caktuar kishte patur edhe Komiteti i ministrave të Këshillit të Europës. Me zgjerimin e Këshillit të Europës (këtë organizatë në vitin 1949 e kishin themeluar 10 shtete), , puna e Komisionit dhe e gjykatës u bë jofunksionale ndërsa numri i parashtresave të paraqitura në gjykatë ishte gjithnjë e më i madhë. Komisionit dhe Gjykatës i nevojtej disa vite që të bie vendimin rreth padive të paraqitura. Për këtë në vitin 1994 u hap për nënshkrim Protokoli shtesë nr. 11 i cili zëvendësoi pjesën e dytë të deriatëhershme të Konventës. Pjesa e dytë e tanishme e Konventës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore, është teksti i Protokolit nr. 11 dhe me këtë rregullohet përbërja e Gjykatës europiane, kompetencat dhe bazat e procedurës para gjykatës.³⁷

Kompetenca e Gjykatës europiane për parashtresat e qytetarëve të Serbisë të cilët konsiderojnë se iu është shkelur ndonjë e drejtë e garantuar me Konventë, u vendos vetëm pas ratifikimit të Konventës europiane. Bashkësia shtetërore Serbi dhe Mali i Zi, u pranua në anëtarësi në Këshillin e Europës më 03.4.2010 (kur njëkohësisht u nënshkrua edhe Konventa), ndërsa parlamenti i Bashkësisë shtetërore Serbia dhe Mali i Zi e ratifikoi në seancën e datës 26.12.2003 dhe ajo hyri në fuqi në ditën e tetë të publikimit në Fletoren zyrtare të SMZ më 03.01.2004.³⁸ Instrumentet e ratifikimit i janë paraqitur Këshillit të

³⁷ Mbi lindjen dhe zhvillimin e Gjykatës s europine më gjerësisht:: Dejan Milenković, Dejan Milenković, *Zaštita ljudskih prava pred Evropskim sudom za ljudska prava*, Lex forum, 1/2007. Pravnici za demokratiju, Beograd, fq. 7-22; Vesna Petrović, *Međunarodni postupci za zaštitu ljudskih prava*, Beogradski centar za ljudska prava, Beograd, 2001. fq. 165-171.

³⁸ Krahaso: *Zakon o ratifikaciji Evropske konvencije za zaštitu ljudskih prava i dodatnih protokola uz Konvenciju*, „Službeni list SCG, br. 9/03.

Europës në mars të vitit 2004, pas të cilës me rastin e shkeljes së të drejtave të njeriut të përcaktuara me Konventë, kësaj Gjykate kanë mundur t'i drejtohen edhe qytetarët e Serbisë. Në të vërtetë, me ratifikimin e Konventës europiane, secila nga palët e Larta nënshkruese (shteti –anëtar), ka pranuar kompetencën e Gjykatës europiane për të drejtat e njeriut që të procedojë m parashtrësat e qytetarëve, të organizatave joqeveritare dhe të grupit të personave kur konsiderojnë se nga shteti anëtar janë shkelur të drejtat e tyre, të përcaktuar me Konventën europiane (dhe me protokolet). Pas shpërbërjes së Bashkësisë shtetërore Serbia dhe Mali i Zi, menjëherë pas zbatimit me sukses të referendumit për pavarësi në Mal të Zi, Serbia si suksesor i saj juridik trashëgoi anëtarësinë në këtë organizatë, ndërsa Mali i Zi së shpejti sërish u pranua në Këshillin e Europës, me ç'rast u bë vendi i 57 anëtarë i kësaj organizate.

Gjykata europiane për të drejtat e njeriut përbëhet numerikishtë nga aq gjykatës sa ka edhe shtete kontraktuese të Konventës. Gjykatësitë duhet patjetër të kenë reputacion të lartë moral dhe të posedojnë kualifikime të nevojshme për ushtrimin e funksioneve të larta gjyqësore, përkatësishtë të jenë ekspert të njohur juridik. Për secilën palë nënshkruese gjykatësinë e zgjedh Kuendi parlamentar i Këshillit të Europës me shumicë votash, nga lista prej tri kandidatësh të cilin e propozon pala e lartë përkatëse. Gjykatësit zgjedhen për periudhën prej gjashtë vjetësh. Gjykata shqyrton parashtrësat në këshillat nga tre gjykatës, kolegjit prej shtatë gjykatës dhe në Këshillin e Madh prej shtatëmbëdhjetë gjykatës.

Procedura para gjykatës është përcaktuar me Konventë, ndërsa më hollësishtë është detajizuar me Rregulloren e Gjykatës europiane.³⁹

³⁹ Krahaso: *Zakon o ratifikaciji Evropske konvencije za zaštitu ljudskih prava i dodatnih protokola uz Konvenciju*, „Službeni list SCG, br. 9/03 i Poslovnik Evropskog suda za ljudska prava. Mbi udhëheqjen e procedurave më shumë detaje mund të gjenden në: Dejan Milenković, Dejan Milenković, *Zaštita ljudskih prava*

Për të ardhur deri te procedura para gjykatës, personat e autorizuar me Konventë së pari duhet t'i **drejtohen me parashtrësë**, për të cilën ekziston një ekstrakt i veçantë në të cilin është përcaktuar në detaje se cilat të dhëna duhet t'i theksoj parashtruesi, ndërsa krahas ekstraktit edhe kopjet e të gjitha dokumenteve të përmendura. Gjithashtu parashtruesi duhet të paraqes fakte që përkojnë në lejueshmërinë e parashtrësës, dhe se a ia ka parashtruar të njëjtën kërkesë cilit do trup tjetër ndërkombëtar për të njëjtën çështje (për shembull, Komitetit të KB për të drejtat e njeriut).

Që parashtrësja të merret në shqyrtim është e nevojshme që t'i përmbushë kushtet e **pranueshmërisë**. Gjykata mund ta merr parashtrësën në shqyrtim vetëm atëherë kur janë shterrur të gjitha mjetet e mbrendshme juridike (edhe pse edhe nga kjo rregull mund të ketë shmangie, p.sh. në rast të shkeljes së të drejtës në gjykim të drejtë) në pajtim me parimet përgjithësisht të pranura të së drejtës ndërkombëtare (kur është fjala për mjetet juridike të jashtëzakonshme kihet kujdes se a mos mjeti i tillë juridik mund të konsiderohet i frytshëm), edhe pse parashtrësja është paraqitur në afatin prej gjashtë muajsh nga dita e aprovimit të aktgjykimit të shkallës së prerë (në sistemin juridik të Serbisë, konsiderohet se janë shterrur të gjitha mjetet efektive juridike vetëm pasi paraqitjes dhe aprovimit të vendimit mbi ankesën kushtetuese). Gjykata nuk do të procedojë ndaj parashtrësës e cila është anonime ose thelbësisht e njëjtë me parashtrësën të cilën gjykata një herë tashmë e ka shqyrtuar ose parashtrësën e cila është paraqitur në ndonjë instancë tjetër ndërkombëtare me qëllim të shqyrtimit, përkatësisht zgjidhjes, e që nuk përmban fakte të reja relevante. Gjykata do ta shpallë parashtrësën të papranueshme dhe do ta hudhë atë edhe nëse konsideron se ajo është në mospërputhje me dispozitat e Konventës, mandej kur duket sheshit se nuk është e bazuar, ose kur vlerëson se paraqet keqpërdorim të drejtës në parashtrësë.

pred Evropskim sudom za ljudska prava, Lex forum, 1/2007. Pravnici za demokratiju, Beograd, fq. 7-22.

Sekretari i regjistron kërkesat e paraqitura. Kryetari i Gjykatës ia ndanë parashtrësën repartit, ndërsa repartit e cakton një gjykatës raportues i cili e shqyrton parashtrësën. Kur gjykatësi raportues konsideron se është fjala për parashtrësën e cila pa shqyrtim të mëtejshëm, për shkak të mospërmbushjes së kushteve formale konsiderohet e papranueshme, ai propozon që parashtrësja të shpallet e palejueshme dhe ajo të hudhet. Nga ana tjetër, kryetari i sektorit e konstituon Kolegjin prej shtatë gjykatësish, pasi që është vendosur që parashtrësën do ta shqyrtoj Kolegji. Kur ndaj parashtrësës procedon këshilli, atëherë këshilli para se të vendosë mbi lejueshmërisë së parashtrësës, do të merr në konsideratë raportin e gjykatësit raportues. Këshilli ka mundësi që me vendim unanim, ta shpallë parashtrësën të palejueshme, e nëse nuk e bënë këtë, bie ***vendimin mbi lejueshmërinë e parashtrësës***. Para miratimit të vendimit mbi lejueshmërinë, Kolegji mundet që qoftë me kërkesë të palëve ose me vetëiniciativë, të vendosë të mbajë shqyrtim publik. Mandej bihet vendimi mbi lejueshmërinë në të cilën Kolegji thekson se a është marrë vendimi njëzëri ose me shumicë votash.

Pasi që Kolegji me vendim e shpallë parashtrësën ***të lejueshme***, ai mund t'i ftoj palët që të paraqesin dëshmi shtesë dhe vërjetje me shkrim. Shqyrtimi në meritum do të mbahet vetëm nëse Kolegji vendos ashtu ose në rast që shqyrtimi e cila i përkiste meritumit nuk ishte mbajtur në fazën e vendosjes mbi lejueshmërinë, nëse këtë e kërkon njëra palë. Kolegji mund të vendos që aktgjykimi të jetë miratuar pa mbajtje të shqyrtimit publik.

Nëse parashtrësja është shapllur e lejueshme, Gjykata vazhdon shqyrtimin e lëndës së bashku me përfaqësuesit e palëve dhe nëse kjo është e nevojshme, ndërmer hetimin, për zbatimin e saj efikas shteti do t'i ofrojë gjithë ndihmën e mundshme. Gjykata gjithashtu mund t'i ofroj në disponim palëve në kontestë arritjen e ***marrëveshjes miqësore*** të bazuar në rrespektimin e të drejtave të njeriut të konstituara me

Konventë, gjë e cila më detajishtë është përpunuar me Rregulloren e Gjykatës europiane. Sekretari i Gjykatës atëherë hynë në kontakt me palët, ndërsa bisedimet mbi barazinë miqësore janë të besueshme. Nëse sekretari njofton Kolegjin se palët kanë arritur poravnanje, Kolegji pasi që të vërtetohet se barazimi është arritur, do ta shlyej rastin nga lista e Gjykatës.

Nëse në këtë fazë nuk është arritur *pajtimi*, procedura vazhdon. Konventa i jep të drejtë parashtruesit që në parashtrësë të theksoj edhe kërkesën për kompensimin të drejtë me rastine shkeljes së të drejtave të njeriut të përcaktuara me Konventë. Pas procedurës së zbatuar, Kolegji bie aktgjykimin. Nëse Kolegji vërteton se ka ardhur deri te shkelja e të drejtave të përcaktuara me Konventë (përkatësishtë, me protokolet shtesë), e është caktuar edhe kërkesa për kompensim, në aktgjykim do të vendoset edhe mbi kompensimin.

Pas aprovimit të *aktgjykimit*, në afat prej tre muajsh nga dita e miratimit të aktgjykimit të Kolegjit, secila palë mundet, në rastet e veçanta të kërkoj që lënda të paraqitet para Këshillit të madh. Pra, këshilli i Madh paraqet edhe instancën ankimore të llojit të vet. Atëherë kolegiumi prej pesë gjykatësishtë të Këshillit të madh, shqyrton se a duhet pranuar kërkesën apo jo (do ta pranoj, para së gjithash, kur lënda ka të bëjë me ndonjë çështje të rëndësishme lidhur me interpretimin e Konventës ose të një çështje serioze të rëndësisë së përgjithshme). Nëse kolegiumi e pranon kërkesën, atëherë Këshilli i madh vendos mbi lëndën e aktgjykimit. Në të kundërtën, aktgjykimi i Kolegjit mbetet në fuqi.

Aktgjykimi i Këshillit të madh është i plotëfuqishëm, ndërsa aktgjykimi i Kolegjit bëhet i plotëfuqishëm kur: palët deklarojnë se nuk do të kërkojnë që lëndën ta paraqesin në Këshillin e madh, kur tre muaj pas marrjes së aktgjykimit nuk kërkohet që lënda të paraqitet në këshillin e madh, ose kur kolegiumi e refuzon kërkesën për t'iu drejtuar Këshillit të madh. Aktgjykimi i plotëfuqishëm publikohet. Palët e larta kontraktuese e marrin obligimet që t'i nënshtrohen aktgjykimit të

shkallës së prerë të Gjykatës në secilën lëndë në të cilën ato janë palë. Aktgjykimi i shkallës së prerë i dërgohet Komitetit të ministrave i cili e mbikqyrë ekzekutimin e tij.

6. TË DREJTAT E PAKICAVE NACIONALE NË KUSHTETUTËN E SERBISË DHE NË LEGJISLATURËN SERBE

6.1. Kushtetuta e Republikës së Serbisë dhe të dejtat e pakicave nacionale

Kushtetuta e Republikës së Serbisë nga viti 2006 përmban një mori të tërë të dispozitave të cilat kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut dhe të pakicave. Mes tjerash pjesa e dytë e Kushtetutës edhe e mbanë emrin ***Të drejtat dhe liritë e njeriut dhe të pakicave.***⁴⁰

Pa marrë parasysh se, mundë të thuhet, se ka lëshime të caktuara në formulimin e disa zgjidhjeve kushtetuese në këtë pjesë⁴¹, në Pjesëne dytë të Kushtetutës janë përfshirë thuaja se të gjitha të drejtat dhe liritë të gjeneratës së parë dhe të dytë, më saktë të drejtat qytetare dhe politike, përkatësisht, të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore, amdje edhe disa të drejta të gjeneratës së tretë, për shembull, të drejtën në mjedis të pastër mjedisor.⁴²

Kushtetuta e Republikës së Serbisë, në këtë pjesë përmbanë edhe ***në veçanti kreun e sistematizuar*** në këtë pjesë të Kushtetutës. Kushtetuta i garanton pjesëtarëve të pakicave nacionale të gjitha të drejtat dhe liritë e njeriut të cilat i garanton Kushtetuta, por edhe disa të drejta të veçanta.

Mirëpo, menjëherë në pjesën e Parë të Kushtetutës – Parimet e Kushtetutës është përmbajtur edhe neni i veçantë – ***mbrojtja e pakicave nacionale***, me të cilën është përcaktuar se republika e Serbisë i mbron të drejtat e pakicave nacionale, dhe se garanton mbrojtje të veçantë të pakicave nacionale me qëllim të realizimit të barazisë së plotë dhe të ruajtjes së identitetit të tyre. Si parim, ky është neni më përfshirës i cili ka të bëjë me pakicat nacionale.⁴³

Në pjesëne Dytë të Kushtetutës, para pjesës së sistematizuar që

⁴⁰ Krahaso: *Ustav Republike Srbije*, „Službeni glasnik RS“ br. 98/06, čl. 18-81.

⁴¹ Krahaso: Marjana Pajvančić: *Komentar Ustava Republike Srbije*, Konrad Adenauer Stiftung, Beograd, 2009, str. 28-103.

⁴² Krahaso: *Ustav Republike Srbije*, „Službeni glasnik RS“ br. 98/06, čl. 74.

⁴³ Krahaso: *Ustav Republike Srbije*, „Službeni glasnik RS“ br. 98/06, čl. 14.

përkon me të drejtat e pakicave nacionale, në kuadër të dispozitave të përgjithshme mbi të drejtat e njeriut, ekzistojnë edhe ato të cilat më për së afërmi përkrijnë me pakicat nacionale. Kjo për më parë është dispozita e përgjithshme me të cilën është paraparëse të drejtat e njeriut dhe të pakicave të cilat janë garantuar me kushtetutën me Kushtetutë aplikohen drejtëpërsëdrejti: „me kushtetutë garantohen, dhe si të tilla, zbatohen drejtëpërsëdrejti të drejtat e njeriut dhe të pakicave të garantuara me rregullat përgjithësishtë të pranuar të së drejtës ndërkombëtare, të vërtetuara me kontratat dhe ligjet ndërkombëtare. Me ligj mund të rregullohet mënyra e realizimit të këtyre të drejtave vetëm nëse kjo është e paraparë prerazi me Kushtetutë ose nëse kjo është e domosdoshme për realizimin e ndonjë të drejte për shkak të natyrës së vet, me ç’rast ligji në asnjë rast nuk guxon të ndikoj në thelbin e të drejtës së garantuar. Dispozitat mbi të drejtat e njeriut dhe të pakicave interpretohen në dobi të përparimit të vlerave të shoqërisë demokratike, në pajtim me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe pakicave që janë në fuqi , si dhe praktikës së institucioneve ndërkombëtare të cilat mbikqyrin zbatimin tyre“. Pas kësaj, vijojnë edhe dispozitat e tjera të përgjithshme mbi: ndalimin e diskriminimit; nxitjen në rrespektimin e dallimeve dhe ndalimin e nxitjes së urrejtjes racore, nacionale dhe fetare, me ç’rast liria e të shprehurit të përkatësisë nacionale dhe ndalimi i shkaktimit të urrejtjes racore, nacionale dhe fetare, janë të a.q. të drejta apsolutishtë të mbrojtura prej të cilave nuk hiqet dorë as edhe në rastë lufte dhe të gjendjes së jashtëzakonshme.⁴⁴

Në pjesën veçanërishtë të sistematizuar të *Pjesës së dytë të Kushtetutës – Të drejtat e pjesëtarëve të pakicave*, së pari në dispozitën themelore është përcaktuar se para të drejtave të cilat janë të garantuara me Kushtetutë për të gjithë qytetarët, garantohen edhe *të drejta individuale dhe kolektive shitesë*. Të drejtat individuale realizohen individualishtë, ndërsa ato kolektive në bashkësi me të tjerët, në pajtim

⁴⁴ Krahaso: *Ustav Republike Srbije*, „Službeni glasnik RS“ br. 98/06, čl. 18, 21, 48, 49, 202.

me Kushtetutën, ligjin dhe kontratën ndërkombëtare. Përmes të drejtave kolektive të pjesëtarëve të pakicave nacionale, drejtëpërsëdrejti ose përmes përfaqësuesve të tyre, marrin pjesë në marrjen e vendimeve ose vendosin vetë mbi çështje të caktuara lidhur me kulturën e tyre, arsimin, informimin dhe përdorimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit, në pajtim me ligjin. Me qëllim të realizimit të së drejtës së vetadministrimit në kulturë, arsim, informim dhe përdorimit zyrtar të gjuhës dhe të shkrimit, pjesëtarët e pakicave nacionale mund të zgjedhin këshillat e tyre nacional në pajtim me ligjin.⁴⁵

Kushtetuta në vazhdim garanton edhe ***ndalimin e veçantë të diskriminimit të pakicave nacionale***, përkatësisht së pari iu garanton barazinë para ligjit dhe mbrojtje të njëjtë ligjore, ndalimine diskriminimit për shkak të përkatësisë të pakicës nacionale, mirëpo masat e a.q. të „aksionit pozitiv“, të cilat i ndërmerr Serbia me qëllim të arritjes së barazisë së plotë në mes të pjesëtarëve të pakicave nacionale dhe të qytetarëve të cilët i takojnë shumicës, e të cilat futen në jetën ekonomike, sociale dhe politike, nuk do të konsiderohen diskriminim.⁴⁶

Më tej Kushtetuta iu garanton pakicave nacionale ***barazinë në udhëheqjen e punëve publike*** nën kushtet e njëjta si edhe ndaj qytetarëve të tjerë dhe organeve shtetërore, shërbimeve publike, organeve të krahinës autonome dhe njësive të vetadministrimit lokal ia përcakton obligimin që me rastinë punësimit të kenë kujdesë mbi përbërjen nacionale dhe të përfaqësimit gjegjës të pjesëtarëve të pakicave nacionale.⁴⁷

Ndalimi i asimilimit të dhunshëm të pjesëtarëve të pakicave nacionale gjithashtu është përcaktuar me kushtetutë si dhe ndërmarrja e masave të cilat do të shkaktonin ndërrimin artificial të përbërjes nacionale të popullatës në territorin ku pjesëtarët e pakicave nacionale

⁴⁵ Krahaso: *Ustav Republike Srbije*, „Službeni glasnik RS“ br. 98/06, čl. 75.

⁴⁶ Krahaso: *Ustav Republike Srbije*, „Službeni glasnik RS“ br. 98/06, čl. 76.

⁴⁷ Krahaso: *Ustav Republike Srbije*, „Službeni glasnik RS“ br. 98/06, čl. 77.

jetojnë tradicionalishtë apo në numër të konsiderueshëm.⁴⁸

E drejta e ruajtjes së veçantisë, si nen i veçantë i kësaj pjese, parashehë që pjesëtarët e pakicave nacionale mes tjerash kanë të drejtën: e të shprehurit, ruajtjes dhe kultivimit, zhvillimit dhe të shprehurit publik të veçantisë nacionale, etnike, kulturore dhe fetare; në përdorimin e simboleve të veta në vendet publike, në shfrytëzimin e gjuhës dhe shkrimit të tyre; që në mjediset ku përbëjnë numër të konsiderueshëm të popullatës, organet të udhëheqin procedurën edhe në gjuhën e tyre, në shkollimin në gjuhën amtare në entet shtetërore dhe të krahinave autonome; në themelimin e enteve private arsimore e tj... Në bazë të ligjit dhe të dispozitave krahinore, mund të themelohen edhe të drejta shtesë të pakicave nacionale.⁴⁹

6.2. Disa prej ligjeve që kanë të bëjnë me pakicat nacionale në Serbi

Në sistemin juridik të Serbisë ekzistojnë një mori e tërë ligjesh të cilat në plotësishtë, pjesërishtë ose vetëm në disa prej dispozitave të caktuara kanë të bëjnë edhe me pakicat nacionale. Gjithësesi se ligji më i rëndësishmi është Ligji mbi mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave nacionale (2002), ndërsa prej ligjeve të tjera, me këtë rast do të përmendim edhe Ligjin mbi këshillat nacional dhe ligjin mbi ndalimin e diskriminimit (2009).

Ligji mbi mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave

⁴⁸ Krahaso: *Ustav Republike Srbije*, „Službeni glasnik RS“ br. 98/06, čl. 78.

⁴⁹ Krahaso: *Ustav Republike Srbije*, „Službeni glasnik RS“ br. 98/06, čl. 79.

nacionale (2002)⁵⁰ është ligji themelor i cili e rregullon statusin e pakicave nacionale. Është miratuar në nivel federal gjatë kohës së Republikës federative të Jugosllavisë, mirëpo ka vazhduar të jetë në fuqi në Serbi edhe pas referendmit me të cilin në pranverë të viti 2006 Mali i Zi u nda nga bashkësia shtetërore e SMZ. Në masë të madhe, ky ligj ka rrespektuar Konventën kornizë të Këshillit të Europës dhe në atë kohë kishte plotësuar zbrastësirën e cila kishte ekzistuar në sistemin kushtetues-juridik të ish-Republikës Federative të Jugosllavisë. Ashtu siç tashmë e pamë, më vonë Kushtetuta e Serbisë e vitit 2006, gjithashtu përmban një mori të tërë dispozitash të cilat kanë të bëjnë me pakicat nacionale. Është me rëndësi të përmendet se me këtë edhe u definua nocioni i pakicës nacionale, si të çdo grupi të shtetasve të RFJ (Serbisë), e cila numerikishtë është mjaft reprezentuese, edhe pse paraqet pakicë në territorin e RFJ (Serbisë), i takon ndonjërit prej grupeve të popullatës që janë në lidhje të afatgjate dhe të fuqishme me territori e RFJ (Serbisë) dhe posedon karakteristika siç janë gjuha, kultura, përkatësia nacionale dhe etnike, prejardhja ose besimi, me të cilat dallohet nga shumica e popullatës, dhe pjesëtarët e të cilit karakterizohen me brengën që së bashku të mbajnë identitetin e tyre të përbashkët, duke përfshirë kulturën, traditën, gjuhën ose religjionin. Me pakica nacionale në kuptim të këtij Ligji do të konsiderohen të gjitha grupet e shtetasve të cilët emërtohen ose caktohen si komunitete popullore, nacionale ose etnike, grupe nacionale dhe etnike, kombësi ose popullësi, e që i përmbushin kushtet e përmendura më parë. Me këtë ligj në vazhdim janë vërtetuar këto të drejta të pakicave nacionale: e drejta në orientim nacional; e drejta për bashkëpunim me bashkëkombasit në vend dhe në botën e jashtme; e drejta e përdorimit të gjuhës amtare; e drejta e përdorimit të simboleve nacionale; e drejta e kultivimit të kulturës dhe traditës; shkollimit në gjuhën amëtare, informimit publik në gjuhët e pakicave nacionale... në pjesën e veçantë të këtij ligji, është përcaktuar mënyra e pjesëmarrjes vepruese në marrjen e vendimeve mbi çështjet e veçantive, në qeverisje dhe administratë, përmes, gjatë kohës së sjelljes

⁵⁰ Krahaso: *Zakon o zaštiti prava i sloboda nacionalnih manjina*, „Službeni list SRJ“ br. 11/02.

së këtij ligji, të Këshillit federativ për pakica nacionale dhe të këshillave nacionale të pakicave nacionale.

Shpërbërja e RFJ e mandej edhe e Bashkësisë shtetërore të SMZ, pamundësoi këtë mënyrë të pjesëmarrjes vepruese, andaj në Serbi u krijua nevoja që të bihet Ligji i **veçantë** mbi këshillat nacional të pakicave nacionale. Propozim ligjin e hartuan grupi i ekspertëve vendosr nga sektori qeveritar dhe civil krahas përkrahjes së përfaqësuesve të të gjitha pakicave nacionale të cilat treguan interesim për këtë ligj. **Ligji mbi këshillat nacional të pakicave nacionale** u aprovua në gusht të vitit 2009. me të rregullohen kompetencat e këshillave nacionale (këshillat nacionale) në fushën e kulturës, arsimit, informimit dhe përdorimit zyrtar të gjuhës dhe shkrimit, të procedurës së zgjedhjes së këshillave nacionale, finansimin e tyre dhe çështje të tjera të rëndësishme për punën e Këshillave nacionale. Këshilli nacional e përfaqëson pakicën nacionale në fushën e arsimit, kulturës, informimit në gjuhën e pakicës nacionale dhe të përdorimit zyrtar të gjuhës dhe shkrimit, merr pjesë në procesin e vendosjes ose vendos mbi çështjet nga këto fusha dhe themelon ente, shoqëri ekonomike dhe organizata të tjera nga këto fusha..⁵¹

Ligji i tretë është **Ligji mbi ndaliminë diskriminimit** (2009).⁵² Ky është i rëndësishëm nga dy arsye themlore: e para është se përkatësia nacionale, si dhe prejardhja etnike, gjuha, bindjet fetare e të tjera janë caktuar në nocionin „diskriminimi“ ose „veprim diskriminues“ si njëra prej cilësive personale, e mandej edhe me atë se si formë e posaçme e diskriminimit është përcaktuar edhe fjalori i urrejtjes, dhe mandej diskriminimi i pakicave nacionale dhe diskriminimi fetar u përcaktuan si raste të veçanta të diskriminimit. Ligji e ndalon diskriminimin e pakicave nacionale dhe të pjesëtarëve të

⁵¹ Krahaso: *Zakon o nacionalnim savetima nacionalnih manjina*; „Službeni glasnik RS br. 72/09

⁵² Krahaso: *Zakon o zabrani diskriminacije*, „Službeni glasnik RS“, br. 22/09

tyre në bazë të përkatësisë nacionale, prejardhjes etnike, të bindjeve fetare dhe gjuhës, dhe se mënyra e realizimit dhe të mbrojtjes së të drejtave të pjesëtarëve të pakicave nacionale janë rregulluar me ligj të veçantë. Mirëpo, duhet përmendur se ajo është e rregulluar edhe me këtë ligj, meqenëse në rast të diskriminimit të pakicave nacionale përkatësishtë të pjesëtarëve të saj, ata ka mundësi që përmes padisë t'i drejtohen organit të pavarur të posakonstituar – Të ngarkuarit për mbrojtjen e barazisë, dhe për të cilin më shumë do të bëhet fjalë pakëz më vonë.⁵³

⁵³ Mbi këto çështje më gjerësishtë: Dejan Milenković, *Vodič kroz Zakon o zabrani diskriminacije*, Helsinški odbor za ljudska prava u Srbiji, Beograd, 2010.

7. VEPRIMET PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË NJERIUT DHE TË PAKICAVE NË REPUBLIKËN E SERBISË

7.1. Vështrim i pëgjishëm

Është e vështirë t'i ndashë veprimet për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të pakicave në republikën e Serbisë. Për shmebull, diskriminimi racor, nacional dhe fetar është vepër penale dhe në këtë konteskt, kryesi i veprës së tillë penale „i nënshtrohet“ përgjegjësisë penale dhe dënimit me burg. Shkelja e të drejtave të caktuara mund të jetë bazë për kompensimin e dëmit që ka qenë pasojë e një shkelje të tillë. Tashmë kemi treguar se të drejtat e pakicave mund të vështrohen edhe si individuale (të dejtat e një individi të caktuar) dhe të grupit të caktuar të personave. Nga ana tjetër, shkelja e të drejtave të njeriut të cilat i takojnë secilit person (duke përfshirë edhe personin i cili është pjesëtar i pakicës nacionale), mund të nënkuptojë edhe shkeljen e të drejtave të personave – pjesëtar të një grupi pakicë, përkatësisht të pjesëtarëve të pakicës nacionale.

Ligji mbi mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të pakicave nacionale, përcakton se pjesëtarët e pakicave nacionale dhe këshillat nacionale të pakicave nacionale mund të ngrisin *padi për kompensimin e dëmit* në gjykatën kompetente me qëllim të mbrojtjes të të drejtave të tyre (të përcaktuara me këtë ligj).

Mundësia tjetër e cila iu qëndron në dispozicion në pajtim me këtë ligj është *ankesa kushtetuese*. Resori përgjegjës ministror dhe këshilli nacional i pakicës nacionale do të jetë i autorizuar që të ushtrojnë ankesë kushtetuese në rast të vlerësimit se ka ardhur deri te shkelja e të drejtave dhe lirive kushtetuese të pjesëtarëve të pakicave nacionale, ose në rast që t'iu drejtohet pjesëtari i pakicës nacionale i cili konsideron se është cënuar në të drejtat dhe liritë e veta personale.

Mbrojtja e suksesshme e të drejtave të njeriut (dhe të të drejtave

të pakicave) sot sigurohet dhe përmes trupave të pavarur të kontrollit. Sot në Serbi ato janë *Mbrojtësi i qytetarëve* (ombudsman), i caktuar me Ligjin mbi mbrojtësin e qytetarëve (2005) dhe *I ngarkuari për mbrojtjen e barazisë* i caktuar me Ligjin mbi ndalimin e diskriminimit (2009).

Në vazhdim, do të flasim për karakteristikat themelore të procedurës para Gjykatës Kushtetuese me rastin e ankesës kushtetuese, të procedurës para Mbrojtësit të qytetarëve (ombudsmanit) dhe të procedurës para të Ngarkuarit për mrojtjen e barazisë.

7.2. Procedura me rastin e ankesës kushtetuese para Gjykatës kushtetuese

Gjykata kushtetuese është gjykatë kompetenca e të cilës është që të zgjidhë në rast të ankesës kushtetuese. Ankesa kushtetuese mund të ushtrohet kundër akteve individuale ose kundër veprimeve të organeve shtetërore ose organizatave të cilat janë të ngarkuara me autorizime publike, e në të cilat çënohen ose shkurtohen të drejtat dhe liritë e njeriut dhe të pakicave të garantuara me Kushtetutë, nëse janë shterrur ose nuk janë paraparë mjete të tjera juridike për mbrojtjen e tyre. Procedura sipas ankesës kushtetuese më për së afërmi është caktuar me Ligjin mbi Gjykatën kushtetuese.⁵⁴

Ankesa kushtetuese është mjet i posaçëm juridik me të cilin inicohet procedura para Gjykatës kushtetuese me qëllim të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut dhe të pakicave të garantuara me Kushtetutë. Procedura sipas ankesës kushtetuese bazohet në parimin e dispozicionit, që don të thotë se nga ushtruesi i autorizuar i ankesës kushtetuese varet se gjykata a do të zgjidhë dhe mbi çka do të zgjidhë.

⁵⁴ Krahaso: *Ustav Republike Srbije*, „Službeni glasnik RS“ br. 98/06, čl. 170 i Zakon o Ustavnom sudu 109/07, čl. 82-90.

Ankesa kushtetuese mund të ushtrohet kundër akteve ose veprimeve individuale të organeve shtetërore ose organizatave të cilave iu janë ngarkuar autorizime publike, e me të cilat çënohen ose shkurtohen të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me Kushtetutë, nëse janë shtetur të gjitha mjetet e tjera juridike ose kur nuk janë paraparë mjete të tjera juridike për mbrojtjen e tyre ose se me ligj është përjashtuar e drejta ndaj mbrojtjes së tyre gjyqësore. Gjithashtu, ankesa kushtetuese mund të ushtrohet edhe nëse nuk janë shtetur të gjitha mjetet juridike, në rastin kur ushtruesit të ankesës iu është çenuar e drejta për gjykim në afatin e arsyeshëm. Nga ajo që u tha del se: a) lëndë e ankesës kushtetuese janë aktet dhe vprimet individuale edhe atë vetëm se ato që rrjedhin nga organet shtetërore (organet e pushtetit ligjdhënës, administrativ dhe gjyqësor) ose organizatave të cilat janë të ngarkuara me autorizime publike;) ose të drejtat të cilat mbrohen në procedurën sipas ankesës kushtetuese janë të gjitha ato të drejta dhe liri të njeriut dhe të pakicave, individuale dhe kolektive, të cilat janë garantuar me kushtetutë (pra, jo vetëm se ato të drejta dhe liri të cilat janë përcaktuar si të veçanta në kapitullin me titull „Të drejtat dhe liritë e njeriut dhe të pakicave“, por edhe ato të drejta dhe liri të garantuara me dispozitat e tjera të Kushtetutës); b) që ankesa kushtetuese të jetë mjet juridik supsidiar, meqë mund të shfrytëzohet (ushtrohet) vetëm se nga arsyet e përcaktuara me kushtetutë, krahas përjashtimit të theksuar në rast të çënimit të të drejtës në gjykim në afat të arsyeshëm.

Kushtet (supozimi) për lejueshmërinë e ankesës kushtetuese –

Se një ankesë kushtetuese do të ishte e lejuar, gjegjësisht që Gjykata kushtetuese të mund të lëshohet në shqyrtim dhe vendosje mbi lëndën e kontestit, nevoitet të përmbushen kushtet e caktuara (supozimet). Këto kushte prej të cilave varet lejueshmëria e mbrojtjes juridike e cila realizohet përmes ankesës kushtetuese në procedurën kushtetuese gjyqësore, emërtohen dhe supozime procesuale.

Kushtet (supozimet) e lejueshmërisë të ankesës kushtetuese përcaktohet në një pjesë me Kushtetutën e Republikës së Serbisë, ndërsa pjesërisht me Ligjin mbi Gjykatën kushtetuese. Sipas

Kushtetutës ankesa kushtetuese mund të ushtrohet kundër aktve individuale ose të veprimeve të organeve shtetërore ose organizatave të ngarkuara me autorizime publike, e me të cilat çënohen ose shkurtohen të drejtat dhe liritë e njeriut dhe të pakicave të garantuara me Kushtetutë, nëse janë shterrur të gjitha mjetet juridike ose nuk janë paraparë mjete të tjera juridike për mbrojtjen e tyre.

Me këtë janë caktuar edhe disa prej kushteve për lejueshmërinë e ankesës kushtetuese: *i pari*, lëndë e vet kontestit (në të vërtetë, lëndë e ankesës kushtetuese mundë të jetë vetëm se akti individual ose të veprimi i organeve shtetërore ose organizatave të ngarkuara me autorizime publike); *i dyti*, lëndë e vetë kontestit (përndryshe lëndë e kontestit kushtetues me rastine ankesës kushtetuese mund të jetë vetëm se çënimi i të drejtave dhe lirive të njeriut dhe të pakicave nacionale të garantuara me Kushtetutë); kushti *i tret*, të jenë shterrur të gjitha mjetet juridike ose të mos jenë paraparë mjete të tjera juridike për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të çënuara ose të shkurtuara.

Ligji mbi Gjykatën Kushtetuese përcakton edhe kushtet e tjera për lejueshmërinë e ankesës kushtetuese: *i pari*, që ankesa kushtetuese mund të ushtrohet edhe nëse me ligj është përjashtuar e drejta në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të çënuara dhe të shkurtuara; *idyti*, që ankesa e kushtetuese mund të ushtrohet edhe nëse nuk janë shterrur të gjitha mjetet juridike, në rastin kur paraqitësit të ankesës kushtetuese i është çënuar e drejta për gjykim në afat të arsyeshëm; *i treti*, që ankesën kushtetuese mund ta ushtroj secili person (person juridik ose fizik) i cili konsideron se me ndonjë akt individual ose të veprimit të organit shtetëror ose organizatës e cila është e ngarkuar me autorizime publike i është çënuar ose shkurtuar e drejta dhe liria njerëzore dhe e pakicës të garantuar me Kushtetutë; *i katërti*, afati në të cilin mund të ushtrohet ankesa kushtetuese; *i pesti*, përmbajtja e ankesës kushtetuese; *i gjashti*, rregullshmëria formale e ankesës kushtetuese (kuptueshmëria, qartësia, plotësia e të ngj.) Ekzistojnë edhe kushtet e tjera të lejueshmërisë së ankesës kushtetuese të cilat nuk janë përshkruar në mënyrë të prerë, gjegjësisht të emërtuar me ligj, porse janë të podvedeni nën nocionin e

përgjithshëm „supozimeve të tjera procesuale“. Në këtë të a.q. supozimet e tjera procesuale mund të përfshihen: a) që mbi të njëjtën gjë në mes të palëve të njëjta të mos vijojë procedura kushtetuese-gjyqësore dhe b) lënda kushtetuesegjyqësore nuk guxon të jetë lënda e gjykuar tashmë.

E drejta në ushtrimin e ankesës kushtetuese. – Ankesën kushtetuese mund ta ushtrojë secili person (juridik dhe fizik) i cili konsideron që se me ndonjë akt individual ose të veprimit të organit shtetëror ose organizatës e cila është e ngarkuar me autorizime publike i është cënuar ose shkurtuar e drejta dhe liria njerëzore dhe e pakicës të garantuar me Kushtetutë. Pra, personi juridik ose fizik mund ta ushtroj ankesën kushtetuese vetëm nëse bëhet fjalë për cënimin të drejtave (të tij) personale, përkatësishtë ai duhet të ketë interes personal ose real që të mënjanohet akti i kontestuar, përkatësishtë të parandalohet veprimi ose të urdhërohet bërja. Ankesën kushtetuese në emër të personit fizik ose juridik, në bazë të autorizimit të tij të veçant me shkrim, mund ta ushtrojë edhe personi tjetër fizik ose juridik, përkatësishtë organi shtetëror ose organ tjetër kompetentë për përcjelljen dhe realizimin e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe të pakicave. Mungesa e autorizimit të veçantë për ushtrimin e ankesës kushtetuese paraqet mangësi procesuale që pamundëson udhëheqjen e mëtejme të procedurës, gjë që për pasojë ka hudhjen e ankesës.

Afati për ushtrimin e ankesës kushtetuese. – Ankesa kushtetuese mund të ushtrohet në afat prej 30 ditësh nga momenti i dorëzimit të aktit të sjellur pas shpalljes së mjetit të fundit juridik, kur janë në pyetje ankesat kushtetuese lëndë e të cilave janë aktet individuale, përkatësishtë, nga dita e ndërmarrjes ose ndërprerjes së veprimit, kur janë në pyetje ankesat kushtetuese lëndë e të cilave janë, me atë që në këtë rast afati llogaritet nga dita kur bartësi i ankesës kushtetuese ka kuptuar mbi ndërmarrjen ose ndërprerjen e veprimit. Për veprimin e lejuar afati llogaritet në secilin rast konkret, varësishtë nga sjellja e organit dhe sjellja e paraqitësit të ankesës kushtetutës. Afati për ushtrimin e ankesës kushtetuese është e karakterit ekskluziv, gjë që

domethënë se në lëshimin e këtij afati vie deri te humbja e të drejtës së kompensimit, ndërmarrja e sërishme e veprimit të lëshuar – ushtrimi i ankesës kushtetuese. Mirëpo, është lejuar kthimi në gjendjen e mëparshme personit i cili për shkaqe të arsyeshme e ka lëshuar afatin për ushtrimin e ankesës kushtetuese, me kusht të: a) që propozimin për kthimin në gjendjen e mëparshme ta paraqesë në afat prej 15 ditësh nga dita e shkëputjes së arsyeve që kanë shkaktuar lëshimin e afatit dhe b) që njëkohësishtë me këtë propozim, të paraqitet edhe ankesa kushtetuese. Gjithësesi, me kalimin e tre muajve nga dita e lëshimit nuk mund të kërkohet kthimi në gjendjen e mëparshme.

Ajo që u tha përkon me situatën kur ankesa kushtetuese ushtrohet me hyrjen në fuqi të ligjit mbi Gjykatën kushtetuese.

Përmbajtja obligative e ankesës kushtetuese. – Ankesa kushtetuese duhet patjetë t'i përmbushë edhe disa kushte të caktuara formale në pikëpamje të elementeve detyruese të cilat duhet t'i përmbaj patjetër. Kështu ankesa kushtetuese duhet të përmbaj emrin dhe mbiemrin, numrin personal të qytetarit, vendbanimin ose vendqëndrimin, përkatësishtë emërtimin dhe selinë e paraqitësit të ankesës kushtetuese, emrin dhe mbiemrin e personit të tij të autorizuar, numrin dhe datën e aktit kundër të cilit është ushtruar ankesa dhe emërtimi i organit që e ka sjellur atë, shenjën e të drejtës dhe të lirisë së njeriut ose pakicës të garantuar me Kushtetutë për të cilën thotë se është cënuar me shenjën e dispozitës së Kushtetutës me të cilën kjo e drejtë, përkatësishtë liri garantohet, arsyet e ankesës dhe ajo që thekset në të cilat përmbahet cënimi ose shkurtimi, kërkesa mbi të cilën Gjykata kushtetuese duhet të vendosë dhe nënshkrimi i paraqitësit të ankesës kushtetuese. Krahas ankesës kushtetuese patjetër duhet të paraqet edhe përshkrimin e aktit individual të kontestuar, dëshmitë se janë shterrur të gjitha mjetet juridike, si dhe dëshmi të tjera të rëndësishme për vendosje. Përmbushja e kushteve në pikëpamje të elementeve obliguese të përmbajtjes së ankesës kushtetuese është supozimi procesual që kushtëzon ekzistimin dhe hulumtimin e supozimeve të tjera procesuale. Mbi mungesën e cilit do element Gjykata kushtetuese e njofton

paraqitësin e ankesës kushtetuese dhe e fton atë që në afatine caktuar të njëjtën ta mënjanoj, krahas paralajmërimit se ankesa kushtetuese do të hudhet, nëse për vendosje mungojnë elementet të cilat pamundësojnë procedimin e Gjykatës.

Vendosja mbi ekzistimin e supozimeve procesuale. – Marrja e vendimit të Gjykatës mbi ekzistimin e supozimeve nënkupton që Gjykata nuk vendos mbi lëndën (përmbajtjen) e kontestit, por vendos mbi ekzistimin, përkatësisht mosekzistimin e supozimeve procesuale të domosdoshëm për udhëheqjen e procedurës me qëllim të vendosjes mbi bazueshmërinë e ankesës kushtetuese. Me këtë rast Gjykata ka mundësi që me aktvendim: a) *ta ndërpresë procedurën* edhe atë në këto raste: 1. nëse ankesa kushtetuese është tërhequr; 2. nëse organi i cili ka sjellur aktin individual të kontestuar e anulon, e heq ose e ndryshon atë akt në pajtim me kërkesën nga ankesa kushtetuese ose nëse është ndërprerë veprimi e cila e kishte shtakatur cënimin ose shkurtimin e të drejtën dhe lirinë e garantuar me Kushtetutë, krahas pajtimit të paraqitësit të ankesës kushtetuese, dhe 3. nëse ndërpriten supozimet e tjera procesuale për udhëheqjen e procedurës dhe b) *ta hudhë ankesën kushtetuese* në rast 1) kur vërteton se nuk është kompetent për vendosje; 2) nëse nuk është paraqitur në afatin e caktuar; 3) kur në afatin e lënë bartësi i kërkesës nuk i ka mënjeluar mangësitë të cilat e pamundësojnë veprimin; 4) kur për udhëheqjen e procedurës dhe të vendosjes nuk ekziston supozime të tjera të përcaktuara me ligj.

Vendosja mbi lëndën e kontestit. – Mbi bazueshmërinë, përkatësisht pabazueshmërinë e kërkesës kushtetuese ankimore Gjykata kushtetuese vendosë me vendim me të cilën ankesa kushtetuese aprovohet ose refuzohet si e pabazuar. Vendosja mbi lëndën e kontestit nënkupton vendosje mbi bazueshmërinë e ankesës kushtetuese (se a është apo nuk është shkelur e drejta e garantuar me Kushtetutë), me ç'rast Gjykata kushtetuese nuk mund të vendosë në vend të organit akti ose veprimi individual i të cilës është lëndë e procedurës sipas ankesës kushtetuese. Me rastin e vendosjes, Gjykata kushtetuese, në pikëpamje të vërtetimit të shkeljes ose të shkurtimit të së drejtës ose lirisë, „lidhur“

me kërkesën nga ankesa kushtetuese dhe me rastin e vendosjes lëvizet në kufijtë e kërkesës së caktuar.

Kur Gjykata kushtetuese vërteton se me aktin, individual, përkatësishtë me veprimin e kontestuar, është cënuar ose shkurtuar e drejta dhe liria e njeriut ose e pakicave e garantuar me kushtetutë, Gjykata me vendim aprovon ankesën kushtetuese dhe përcakton se me aktin ose veprimin e kontestuar është cënuar ose shkurtuar e drejta dhe liria e njeriut ose e pakicave e garantuar me kushtetutë dhe e cakton mënyrën e përmbushjes së drejtë.

Përfundimishtë, kur Gjykata kushtetuese e aprovon ankesën kushtetuese dhe vëret se me aktin ose veprimin e kontestuar është cënuar ose shkurtuar e drejta dhe liria e njeriut ose e pakicave e garantuar me dipsozitën konkrete të Kushtetutës, e në mënyrë tjetër nuk mund të mënjanohej pasojat e dëmshme, Gjykata e anulon aktin individual, dhe lëndën e kthen në procedurë të përsëritur dhe për vendosje organit akti i të cilit është anuluar (me këtë rast Gjykata mundet të caktoj sjelljen e aktit të ri ose ka mundësi të urdhëroj përfundimin e procedurës në afati më të shkurtër të mundshëm), përkatësishtë do ta ndaloj ushtrimin e mëtejshëm ose do të urdhëroj ushtrimin e veprimit të caktuar dhe të caktoj që të mënjanohej pasojat e dëmshme në afatin e caktuar. Kur Gjykata me vendim e aprovon ankesën kushtetuese, Gjykata kushtetuese përcakton edhe se a është ky vendim bazë për kompensimin e dëmit.

Natyra juridike dhe efekti juridik i vendimit të Gjykatës kushtetuese. – Vendimi ndaj ankesës kushtetuese është i prerë (dhe i plotëfuqishëm), meqenëse kontesti i zgjidhur me vendimin e Gjykatës kushtetuese nuk mund të zgjidhet sërish nga ana e të njëjtit ose të gjykatës tjetër kushtetuese ose të cilit do trup tjetër ose organit as kundër vendimit të Gjykatës kushtetuese ka revokim, përkatësishtë ajo nuk mund të rrëzohet me asnjë mjet të çfardoshëm juridik, ndërsa ankesa kushtetuese e cila ka sjellur deri te përfundimi meritore të kontestit është lëndë e gjykuar me vendim të shkallës së prerë. Gjithashtu, vendimet e Gjykatës kushtetuese janë ekzekutive, e kjo

cilësi e vendimit del nga prershmëria e tij dhe obligueshmëria e përgjithshme. Vendimi mbi anulimin e aktit individual ose të ndalimit të kryerjes së vperimit ka efekt konstitutiv. Me anulimin e aktit individual anulohen edhe pasojat juridike me efektin nga momenti i paraqitjes së cënimit ose shkurtimit të çfardo të drejte ose lirie të njeriut dhe të pakicave të garantuar me Kushtetutë. Vendimi i Gjykatës kushtetuese me të cilën është aprovuar ankesa kushtetuese ka efekt juridik nga dita e dërgimit të saj pjesëmarrësve në procedurë. Edhe pse vendimet e Gjykatës kushtetuese, në pajtim me Kushtetutën, janë përgjithësisht obliguese, duhet thënë se në rast të ankesës kushtetuese ato veprojnë, në rregullin, në mes të pjesëmarrësit në procedurë, mirëpo ky efekt zgjerohet edhe në personat e tjerë edhe atë në rast kur me ndonjë akt individual ose veprim është cënuar ose shkurtuar e drejta dhe liria njerëzore dhe e pakicës të garantuar me Kushtetutë më shumë personave , e që vetëm se disa prej tyre kanë paraqitur ankesën kushtetuese – me atë rast vendimi i Gjykatës kushtetuese përkon dhe me personat të cilët nuk kanë paraqitur ankesë kushtetuese, nëse gjenden në pozitë të njëjtë juridike.

Ankesa kushtetuese, sipas rregullit, nuk pengon aplikimin e aktit individual ose veprimit kundër të cilit është ushtruar. Përgjithësisht, Gjykata mund ta shtyjë ekzekutimin e aktit individual ose të veprimit, me kusht që: a) paraqitësi i ankesës kushtetuese kërkon (propozon) shtyerjen, b) ekzekutimi do të shkaktonte dëm të pakompensueshëm ndaj paraqitësit, dhe c) që shtyerja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që me shtyerje t'i shkaktohet dëm më i madh personit të tretë. Mbi propozimin për shtyerjen e ekzekutimit të aktit individual ose veprim kundër të cilit është ushtruar ankesa kushtetuese, Gjykata kushtetuese sipas rregullit do të vendos në afat prej 90 ditësh nga dita e pranimit të propozimit. Në këtë rast fjala është rreth afatit instruksionues, e jo për afatin ekskluziv.

Kompensimi i dëmit material. – vendimi i Gjykatës kushtetuese me të cilën aprovohet ankesa kushtetuese është bazë

juridike për paraqitjen e kërkesës për kompensimin e dëmit ose të mënjnimit të pasojave të tjera të dëmshme para organeve kompetente, në pajtim me ligjin. Në bazë të vendimit të Gjykatës kushtetuese me të cilën është aprovuar ankesa kushtetuese, paraqitësi i ankesës kushtetuese mund të paraqes kërkesën për kompensimin e dëmit Komisionit për kompensimin e dëmit, me qëllim të arritjes së marrëveshjes mbi lartësinë e kompensimit. Nëse kjo kërkesë nuk do të aprovohet ose ndaj saj Komisioni nuk bie vendim në afat prej 30 ditësh nga dita e paraqitjes së kërkesës, paraqitësi i ankesës kushtetuese ka mundësi që të gjykata kompetente të ushtroj padi për kompensimin e dëmit.⁵⁵

7.2. Procedura para Mbrojtësit të qytetarëve

Ligji mbi mbrojtësinë e qytetarëve është miratuar në vitin 2005,⁵⁶ me të cilin Serbia më në fund fitoi institucionin e ombudspersonit. Mirëpo, për shkak të rrethanave të ndryshme, siç janë zgjedhja e Mbrojtësit të qytetarëve, të zëvendësve të tij, mungesa e hapësirës për punën e shërbimit të tij e tj. Solli deri te ajo që ky trup i ri e i paanshëm në sistemin juridik të Serbisë u bë „efikas“ vetëm nga viti 2008. Me aprovimin e kushtetutës së Republikës së Serbisë, Mbrojtësi i qytetarëve u bë edhe organ shtetëror i rangut „kushtetues“. Në pajtim me Kushtetutën (dhe ligjin)...“ Mbrojtësi i qytetarëve është organ shtetëror i pavarur i cili i mbron të drejtat e qytetarëve dhe bënë kontrollin e punës së organeve të administratës shtetërore, të organeve kompetent për mbrojtjen juridike të të drejtave dhe interesave pronësore të Republikës së Serbisë si dhe të organeve dhe organizatave të tjera, të ndërmarrjeve dhe enteve të cilat janë ngarkuar me autorizime publike. Mbrojtësi i qytetarëve nuk është i autorizuar ta kontrolloj punën e

⁵⁵ Krahaso: Ustav Republike Srbije, „Službeni glasnik RS“ br. 98/06, čl. 170 i *Zakon o Ustavnom sudu* 109/07, čl. 82-90. Komentet në lidhje me procedurën sipas ankesës kushtetuese janë marrë nga web prezentimi të Gjykatës kushtetuese: <http://www.ustavni.sud.rs>

⁵⁶ *Zakon o zaštitniku građana*, „Službeni glasnik RS“ br. 79/05, 54/07.

Kuvendit popullor, të kryetarit të Republikës, Qeverisë, të Gjykatës kushtetuese, të gjykatave dhe të prokurorive publike. Mbrojtësi i qytetarëve zgjedhet dhe shkarkohet nga Kuvendi popullor në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin. Mbrojtësi i qytetarëve për punën e tij i përgjigjet Kuvendit popullor. Mbrojtësi i qytetarëve gëzon imunitetin si edhe deputeti popullor. Mbi imunitetin e mbrojtësit të qytetarëve vendos Kuvendi popullor. Mbi mbrojtësin e qytetarëve bihet ligj“. Kështu Ombudspersoni, gjegjësishtë mbrojtësi i qytetarëve më në fund u bë kategori kushtetuese në Republikën e Serbisë.

Mbrojtësi i qytetarëve inicon procedurën sipas ankesës së qytetarëve ose me iniciativë të vetën. Krahas të drejtës në incimin dhe udhëheqjen e procedurës, mbrojtësi i qytetarëve ka të drejtë që ***përmes ofrimit të shërbimeve të mira, me ndërmjetësimin dhe dhënien e këshillave*** dhe mbi çështjet nga kompetenca e tij vepron në mënyrë parandaluese, me qëllim të përparimit të punës së organeve të administratës dhe të përparimit të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut. Secili person fizik dhe juridik, person i vendit apo i huaj i cili konsideron se me ndonjë akt, veprim ose të mosbërjes së organit të administratës i është cënuar e drejta mund të paraqes ankesë te Mbrojtësi i qytetarëve. Nëse bëhet fjalë për shkeljen e të drejtave të fëmiut, ankesën në emër të fëmiut të mitur mund ta paraqet prindi i tij, përkatësishtë përfaqësuesi ligjor, e nëse bëhet fjalë për cënim të të drejtës së personit juridik, ankesën mund ta paraqes personi i autorizuar për përfaqësimin e atij personi juridik. Para paraqitjes së ankesës bartësi i ankesës është i obliguar që të tentojë që të drejtat e veta t'i mbroj në ***në procedurën gjegjëse administrative.*** Mbrojtësi i qytetarëve do ta udhëzoj paraqitësin e ankesës në incimin e procedurës gjegjëse administrative, nëse procedura e tillë është e paraparë, ndërsa nuk do ta inicioj procedurën deri sa të mos ***shterren të gjitha mjetet juridike.*** Kjo dispozitë ligjore, edhe pse deri diku joprecize, megjithatë tregon se ankesa paraqitet kur janë shterrur të gjitha mjetet në ***një procedurë*** (p.sh. me procedurë të përgjithshme administrative) e që ***mundësia e udhëheqjes së procedurës tjetër*** para bie fjala instancës gjyqësore (p.sh. kontestit administrativ kundër aktvendimit të shkallës së prerë) nuk e

pengon subjektin ta paraqes ankesën edhe te Mbrojtësi i qytetarëve. Mbrojtësi i qytetarëve mundet në rastet e jashtëzakonshme ta inicioj procedurën edhe para se të jenë shterrur të gjitha mjetet juridike, ***nëse paraqitësit të ankesës do t'i shkaktohej dëmë i pakompensueshëm*** ose nëse ankesa përkon me ***cënimin e parimit të administratës së mirë***, në veçanti raporti jokorrekt të organit administrativ sipas paraqitësit të ankesës, për punë të jashtëkohëshme ose të shkeljeve të tjera të rregullave të sjelljes etike të të punësuarëve në organet e administratës. Ankesa nuk do të shqyrtohet nëse është anonime, mirëpo edhe nga kjo rregull mund të ketë përjashtim. Përjashtimishtë, nëse konsideron që në ankesën anonime ka bazë për procedimë saj, Mbrojtësi i qytetarëve mund të inicioj procedurën me vetëiniciativë.⁵⁷

Ankesa paraqitet në ***formë të shkruar*** ose ***gojarishtë*** në procesverbal dhe në paraqitjen e ankesës nuk paguhet kurrfar takse, as edhe kompensim tjetër. Ankesa mund të ushtrohet ***më së voni në afat prej një viti*** nga shkelja e kryer të të drejtës së qytetarit, përkatësishtë nga procedura e fundit, përkatësishtë të mosprocedimit të organit të administratës në lidhje me shkeljen e bërë të të drejtës së qytetarit. Në ankesë theksohet: ***emërtimi i organit ndaj punës të të cilëtka të bëjë ankesa***, përshkrimi i shkeljes së të drejtës, faktet dhe dëshmitë të cilat e mbështesin ankesën, të dhënat mbi atë se cilat mjete juridike janë shfrytëzuar dhe të dhënat e paraqitësit të ankesës. Personat e privuar nga liria kanë të drejtë që ankesën ta paraqesin në plikon e vulosur. Mbrojtësi i qytetarëve është i obliguar të veproj ndaj secilës ankesë vetëm nëse lënda ndaj të cilës ka të bëjë ankesa nuk bie në kompetencë të mbrojtësit të qytetarëve, nëse ankesa është paraqitur pas skadimit të afatit për paraqitje, nëse ankesa është paraqitur para përdorimit të të gjitha mejteve juridike në disponim, nëse ankesa është anonime, nëse ankesa nuk përmban të dhënat e nevojshme për procedim, e që paraqitësi atë mangësi nuk e mënjanon as edhe në afatin shtesë të caktuar për plotësimin e ankesës, e as që i drejtohet shërbimit të

⁵⁷ Krahaso: *Zakon o zaštítniku građana*, „Službeni glasnik RS“ br. 79/05, 54/07, čl. 24-25.

Mbrojtësit të qytetarëve për ndihmë profesionale në mënjanimin e mangësisë. Në rast se nga këto arsye nuk ka bazë për procedimin nga ana e Mbrojtësit të qytetarëve, mbrojtësi **do ta hudhë ankesën**, mbi të cilën është i obliguar ta njoftoj paraqitësin, krahas theksimit të arsyeve për hudhjen.⁵⁸

Mbi inicimin dhe përfundimin e procedurës së Mbrojtësi i qytetarëve **e njofton paraqitësin e ankesës**, si edhe **organi i administratës kundër të cilit është ushtruar ankesa**. Organi i administratës është i obliguar të përgjigjet në të gjitha kërkesat e Mbrojtësit të qytetarëve, si dhe t'ia dërgoj të gjitha informatat e kërkuara dhe shkresat në afat të cilit ai e cakton, e i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se 15 ditë, e as më i gjatë se 60 ditë. Mbrojtësi i qytetarëve në rastet posaçërisht të arsyeshme, mundet që organit të administratës mos t'ia zbuloj identitetin e paraqitësit të ankesës. Nëse organi kundër të cilit është paraqitur ankesa vet e mënjanon mangësinë, Mbrojtësi i qytetarëve për këtë do ta informoj paraqitësin e ankesës dhe t'i ofroj afat 15 ditësh që të deklarohet se a është i kënaqur me atë procedurë. Nëse paraqitësi i ankesës përgjigjet se është i kënaqur me mënyrën në të cilën është mënjanuar mangësia, si dhe nëse paraqitësi i ankesës nuk përgjigjet fare në afatin e ofruar, Mbrojtësi i qytetarëve do ta ndërpres procedurën.⁵⁹

Pas vërtetimit të të gjitha fakteve dhe rrethanave relevante Mbrojtësi i qytetarëve mund ta njoftoj paraqitësin e ankesës se ankesa është e pabazuar ose mund të vërtetohet se kanë ekzistuar mangësitë në punën e organit të administratës. Nëse gjenë se **kanë ekzistuar mangësi në punën e organit të administratës**, Mbrojtësi i qytetarëve do t'i udhëzoj **rekomandim organit** mbi atë se si të mënjanohet mangësia vërejtur. Organi i administratës është i obliguar që më së voni në afat

⁵⁸ Krahaso: *Zakon o zaštitniku građana*, „Službeni glasnik RS“ br. 79/05, 54/07, čl. 26-29.

⁵⁹ Krahaso: *Zakon o zaštitniku građana*, „Službeni glasnik RS“ br. 79/05, 54/07, čl. 30.

prej 60 ditësh nga dita e marrjes së rekomandimit ta njoftoj Mbrojtësin e qytetarëve mbi atë se a ka vepruar sipas rekomandimit dhe a e ka mënjanuar mangësinë, përkatësisht ta njoftoj mbi arsyet për shkak të të cilave nuk ka proceduar sipas rekomandimit. Përgjashtimisht, nëse ekziston rreziku që për shkak të mosmënjanimit të mangësisë, të drejtat e paraqitësit të ankesës do të jetë e përhershme dhe i zhdëmtuar në vëllim të konsiderueshëm, Mbrojtësi i qytetarëve në rekomandimin e vet organit të administratës mund t'ia përcaktoj afatin edhe më të shkurëtr për mënjanimin e mangësive, me atë që ai afat nuk mund të jetë më i shkurtër se 15 ditë. Nëse organi i administratës ***nuk procedon sipas rekomandimit***, Mbrojtësi i qytetarëve mundet mbi këtë ta lajmëroj ***opinionin, Kuvendin dhe Qeverinë***, por mundet që edhe ***të rekomandoj përcaktimin e përgjegjësisë së funksionarit*** i cili udhëheq me organin e administratës.⁶⁰

Mbrojtësi i qytetarëve mund të procedoj edhe me vetëiniciativë kur në bazë të njohurive të veta ose njohurive të fituara nga burimet e tjera, përfshirë këtu edhe ankesat anonime, vlerëson se me aktin, veprimin ose mosbërjen e organit të administratës ka ardhur deri te cënimi i lirive ose të drejtave të njeriut.⁶¹

3. Procedura para të Ngarkuarit për mbrojtjen e barazisë

I ngarkuari për mbrojtjen e barazisë është organ i pavarur shtetëror i themeluar ***me Ligjin mbi ndalimin e diskriminimit*** (2009).⁶² I ngarkuari është zgjedhur në fillim të prillit të vitit 2010, ndërsa konstituimi i shërbimit të tij edhe më tutje nuk ka përfunduar.

⁶⁰ Krahaso: *Zakon o zaštitniku građana*, „Službeni glasnik RS“ br. 79/05, 54/07, čl. 31.

⁶¹ Krahaso: *Zakon o zaštitniku građana*, „Službeni glasnik RS“ br. 79/05, 54/07, čl. 32.

⁶² Krahaso: *Zakon o zabrani diskriminacije*, „Službeni glasnik RS“, br. 22/09, čl. 35-40

Në realizimin e të drejtave të veta askush nuk mund të jetë i diskriminuar mbi kurrfar cilësive të vet personale përfshirë këtu edhe përkatësinë nacionale, ndërsa nocioni diskriminim në këtë Ligj është caktuar në këtë mënyrë: „Diskriminimi“ dhe „procedimi diskriminues“ konsiderohen *çfardo bërje e dallimit të paarsyeshëm ose procedim jo i njëjtë, përkatësisht çfardo lëshimi* (përrjashtimi, kufizimi ose dhënia e përparësisë), në raport ndaj personave ose të grupit ose ndaj anëtarëve të tyre të familjes, ose ndaj të afërmeve të tyre, në mënyrë të hapur ose të fshehtë, e i cili bazohet në racë, ngjyrën e lëkurës, paraardhësit, shtetësinë, përkatësinë nacionale ose prejardhjen etnike, gjuhën, bindjet fetare ose politike, gjininë, identitetin gjinor, orientimit seksual, gjendjen e pasurisë, lindjes, veçorive gjenetike, gjendjes shëndetësore, invaliditetit, statusit martesor dhe familjar, gjykueshmërisë, moshës, dukjes, anëtarësisë në organizatat politike, sindikale ose në organizata e tjera ose të vetive të tjera objektive, përkatësisht të supozuara.

Ashtu siç më parë tashmë ishte fjalë për këtë, përkatësia nacionale, prejardhja etnike ose gjuha dhe bindjet fetare si cilësi personale shpesh sjell te diskriminimi ndaj një “pakice” të caktuar përkatësisht personit pjesëtar të grupit të caktuar. Diskriminimi i pakicave nacionale dhe diskriminimi fetar në bazë të këtij ligji konsiderohen raste të veçanta të diskriminimit. Për këtë edhe procedura pranë të Ngarkuarit për mbrojtjen e barazisë është shumë e rëndësishme nga këndvështrimi i këtij Doracak.

I Ngarkuari me mbrojtjen e barazisë është organ i pavarur shtetëror, i pavarur në ushtrimin e punëve të përcaktuara me ligj. Njëra prej kompetencave më të rëndësishme të të Ngarkuarit është që të ***pranoj dhe shqyrtoj ankesa për shkak të cënimit të dispozitave*** të këtij ligji dhe të ***jep mendime dhe rekomandime***, dhe në rastet konkrete edhe të ***shqiptoj masat përkatëse***. Kjo kompetencë me Ligjin mbi ndalimin e diskriminimit është dashur patjetër që për së afërmi të detajizohet, më saktë, me këtë ligj është dashur patjetër të jetë paraparë procedura e veçantë në të cilën i Ngarkuari procedon sipas ankesave të qytetarëve të

cilët konsideron se kanë pësuar diskriminim, në të cilën bie mendim dhe rekomandim si dhe procedurën për shqiptimin e masës të përcaktuar me këtë ligj.

Procedura para të Ngarkuarit për mbrojtjen e barazisë ka ngjajshmëri të konsiderueshme me procedurën para mbrojtësit të qytetarëve (ombdsmanit). Së pari, fjala është si edhe te procedura para Mbrojtësit të qytetarëve mbi procedurën joformale, i cili përfundon me sjelljen e mednimit dhe rekomandimit. Megjithatë për dallim nga Mbrojtësi i qytetarëve i Ngarkuari për mbrojtjen e barazisë e ka mundësinë të shqiptoj *masën e përcaktuar me këtë ligj (vërejtjen-paralajmërimin)* gjë që nuk është rasti me Mbrojtësin e qytetarëve. Mbrojtësi i qytetarëve nga ana tjetër mund të inicoj procedurë jo vetëm se me ankesën e ndonjë personi por këtë mund ta bëjë edhe me vetiniciativë për dallim nga i Ngarkuari për mbrojtjen e barazisë i cili këtë mund ta bëjë vetëm se me ankesën e qytetarëve. Për dallim nga ligji mbi mbrojtësin e qytetarëve i cili në tërësi e cakton procedurën para mbrojtësit, ky nuk është rast me procedurën para të Ngarkuarit për mbrojtjen e barazisë, meqenëse një pjesë e procedurës (mirenje) është përcaktuar me ligjin tjetër, më sakt me Ligjin mbi medijimin nga viti 2005.⁶³

Procedura para të ngarkuarit mund ta inicoj secili ... „*person i cili konsideron se ka pësuar diskriminim*“. Pasi që fjala „person“ nënkupton personin fizik dhe juridik (subjekte të së drejtës), kjo don të thotë se këtë procedurë mund ta inicoj edhe personi fizik dhe ai juridik (i vendit dhe i huaj). Procedura para të Ngarkuarit inicohet përmes *ankesës*. Mirëpo Ligji, nuk përmban *sa duhet dispozita orientuese* se çfarë duhet të përmbaj ankesa, se a duhet patjetër apo jo të jetë e nënshkruar, ose për shembull, a mundet i Ngarkuari të procedoj (dhe në cilat raste) sipas ankesës anonime. E vetmja gjë që kërkohet nga paraqitësi i ankesës është se krahas ankesës të paraqes edhe dëshmi *për*

⁶³ Krahaso: Dejan Milenković, *Vodič kroz Zakon o zabrani diskriminacije*, Helsinški odbor za ljudska prava u Srbiji, Beograd, 2010. fq. 51.

aktin e pësuar të diskriminimit mirëpo edhe atëherë shtrohet pyetja se a është ky ndonjë akt juridik, i shkruar, shpalje në konkurs ose ndonjë deklaratë e dëshmitarëve ose dëshmi e paraqitësit të ankesës. Me rastin e rrethanave të theksuara, duket se i Ngarkuari do të jetë ai që në të ardhmen do të duhej ta rregulloj ekstraktin e ankesës si dhe elementet që ai ekstrakt duhet t'i përmbaj (emrin dhe mbiemrin e paraqitësit ose emërtimin dhe selinë e personit juridik të cilin e konsideron se ka pësuar diskriminim, mandej përshkrimin e shkurtës të situatës, të ngjarjes së veprimit e të ngj. Të cilat sipas mendimit të paraqitësit të ankesës paraqesin diskriminim, ose për shmebull deklaratën se personi i cili paraqet ankesën nuk e ka inicuar procedurën e caktuar para gjykatës e tj.) ankesa paraqitet sipas rregullit me shkrim. Megjithatë, përjashtimisht, ligji ofron mundësinë që personi i cili konsideron se ka pësuar diskriminim ankesën e paraqet edhe gojarishtë në procesverbal.

Ligji mbi ndalimin e diskriminimit, **prerazi parasheh** që i Ngarkuari **nuk procedon sipas ankesës**: 1) nëse duket sheshit se nuk ka cënim të të drejtës për të cilën thotë paraqitësi, 2) nëse në të njëjtën gjë tashmë ka proceduar e nuk janë ofruar dëshmi të reja si dhe 3) nëse vërteton se për shkak të kalimit të kohës nga cënimi i shkaktuar i të drejtës është e pamundur të arrihet qëllimi i procedimit. Andaj, mund të thuhet se këto arsye ligjore për „hudhjen“ e ankesës, përkatësisht për mosprocedim të Ngarkuarit sipas ankesës. Ligji nuk parasheh në cilën mënyrë paraqitësi mbi këtë do të njoftohet, mirëpo parasheh se në procedurë para të Ngarkuarit do të aplikoj supsidiarishtë Ligjin mbi procedurën e përgjithshme administrative (nga i cili del se „mosveprimi i të Ngarkuarit“ do të duhej „të konstatohej“ me përfundim mbi hudhjen e ankesës e cila i dërgohet personit i cili e ka paraqitur ankesën).

I Ngarkuari pasi që konstaton se nuk ekzistojnë arsye për mosprocedim sipas ankesës, ankesën do t'ia përcjellë personit kundër të cilit ankesa është paraqitur në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të ankesës. I Ngarkuari mandej i konstaton gjendjen faktike. Mirëpo, dispozita ligjore e cila ka të bëjë me konstatimin e gjendjes faktike

paksa është e paqartë. Personi kundër të cilit është paraqitur ankesa mund të deklarohet mbi thekset e ankesës në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të saj, ndërsa i Ngarkuari mandej konstaton gjendjen faktike duke pasur qasje në dëshmitë e paraqitura dhe me marrjen e deklarave nga paraqitësi i ankesës, nga personat kundër të cilëve është paraqitur ankesa, si edhe të personave të tjerë. Mirëpo, para ndërmarrjes së veprimev etë tjera në procedurë, i Ngarkuari mund të propozoj procedurën e *pajtimit*, në pajtim me ligjin me të cilin rregullohet procedura e medijimit (ndërmjetësimi).

Me ligjin mbi medijimin – ndërmjetësimin (2005) është përcaktuar se me këtë ligj caktohen rregullat e procedurës së medijimit – ndërmjetësimi në raportet kontestuese.⁶⁴ Një raport i tillë kontestues është në pajtim me Ligjin mbi ndalimin e diskriminimit dhe ai në të cilin ka ardhur ose se supozohet se ka ardhur deri te diskriminimi. Medijimi mund të aplikohet pavarësisht nga ajo se a bëhet ndërmjetësimi para ose pas inicimit të procedurës për zgjidhjen e raportit kontestues. Që medijimi-ndërmjetësimi të zbatohet, për këtë është i domosdoshëm pëlqimi ekskluziv i palëve. Kjo don të thotë, *vetë se atëherë* nëse personi që konsideron se ka pësuar diskriminim si edhe personi kundër të cilit është paraqitur ankesa *pajtohe prerazi* që të zbatohet procedura e medijimit, atëher kjo procedurë edhe do të zbatohet. Në procedurën e pajtimit të palët janë të barabarta. Mirëpo nëse nuk ka ardhur deri te pëlqimi për udhëheqjen e procedurës së ndërmjetësimi, si edhe në rastin kur „pajtimi“ nuk ka pasur sukses, procedura para të Ngarkuarit vazhdohet në mënyrën në të cilën është përcaktuar me ligjin mbi ndalimin e diskriminimit. Procedura e medijimit zbatohet ashtu që palët merren vesh mbi mënyrën në të cilën procedura e „pajtimit“ do të zbatohet. Nëse palët nuk arrijnë marrëveshje mbi mënyrën e zbatimit të procedurës, ndërmjetësi do ta zbatoj procedurën e ndërmjetësimi në mënyrën në të cilën mendon se

⁶⁴ Krahaso: *Zakon o medijaciji – posredovanju*, „Službeni glasnik RS“ br. 18/05, čl. 8-25; Dejan Milenković, *Vodič kroz Zakon o zabrani diskriminacije*, Helsinški odbor za ljudska prava u Srbiji, Beograd, 2010. fq. 52-56.

është më e përshtatshme, duke pasur parasyshë rrethanat e raportit të kontestuar, interesat të cilat palët dëshirojnë t'i reealizojnë krahas rrespektimit të parimit të urgjencës. Ndërmjetësi mundet të udhëheq bisedime të përbashkëta dhe të ndara me palët, si dhe që krahas pëlqimit të njërës palë t'ia përcjellë palës tjetër dhe t'ia paraqesë propozimet dhe qëndrimet mbi çështje të caktuara. Ndërmjetësi mund të jep propozime mbi mënyrat e mundshme për zgjidhjen e kontstit, por jo edhe propozimin e vet zgjidhjes. I Ngarkuari për mbrojtjen e barazisë nuk është mediator në procedurën e pajtimit. Sipas Ligjit mbi ndërmjetësimin – medijimin, eprori i organit, përkatësisht në këtë rast konkret i Ngarkuari, e emëron ndërmjetësin nga radhët e ekspertëve të dalluar (gjykatës, avokat e tj.) të cilët i përmbushin kushtet për ushtrimin e ndërmjetësimin dhe e regjistrojnë në Listën e ndërmjetësuesve të cilin e udhëheq i Ngarkuari. Ndërmjetësuesi duhet patjetër t'i plotësoj kushte të caktuara të përcaktuara me këtë Ligj, si për shembull që të ketë shkollimin superior; që të ketë së paku pesë vjet përvojë pune në procedurat e zgjidhjes së kontesteve dhe konflikteve; që të jetë i regjistruar në Listë; që ta ketë vijuar programin e aftësimin për ndërmjetësues e tj.

Me rastin e inicimit të procedurës para të Ngarkuarit, palët me marrëveshje e zgjedhin ndërmjetësuesin nga lista. Nëse palët nuk merren vesh, ndërmjetësuesin në rastin konkret do ta caktoj i Ngarkuari, nga lista e ndërmjetësuesve sipas renditjes në listë. Procedura e ndërmjetësimin mund të zgjasë më së shumti 30 ditë. I ngarkuari megjithatë mund edhe ta shtyj afatin e zgjatjes së procedurës për shkaqe të arsyeshme, me kërkesë të ndërmjetësuesit ose palëve. Procedura e ndërmjetësimin përfundohet: (1) me përmbylljen e marrëveshjes së palëve, (2) me vendimin e ndërmjetësuesit, pas konsultimit me palët, që procedura të ndërpritet, meqenëse procedura e dhënë nuk është e arsyeshme; (3) me deklarinimin e palëve mbi tërheqjen nga procedura e mëtejme.

Kur procedura e pajtimit nuk ka pasur sukses vazhdohet

procedura para të Ngarkuarit. I Ngarkuari mandej jep ***mendimin*** mbi atë se a ka ardhur deri te cënimi i dispozitave të këtij ligji në afat prej 90 ditësh nga dita e paraqitjes së ankesës, dhe për këtë e njofton paraqitësin dhe personin kundër të cilit është paraqitur ankesa. Krahas mendimit, i Ngarkuari *i rekomandon* personit kundër të cilit është paraqitur ankesa *mënyrën e mënjanimi të shkeljes së të drejtës*.

Personi të cilit i është udhëzuar rekomandimi ***është i obliguar që të vproj sipas rekomandimit*** dhe ta mënjanoj cënimin e të drejtës në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të rekomandimit, si dhe që për këtë ta informoj të Ngarkuarin. Nëse personi të cilit i është udhëzuar rekomandimi nuk vepron sipas tij, përkatësishtë nuk e mënjanon shkeljen e të drejtës, i Ngarkuari ia shqipton *vërejtjen (paralajmërimin)*. Nëse as pas shqiptimit të vërejtje, personi i tillë këtë nuk e bënë as në afatë prej 30 ditësh nga dita e shqiptimit të vërejtjes, i Ngarkuari do ***njoftoj opinionin***. Vërejtja shqiptohet *me aktvendim kundër të cilit nuk është e lejuar ankesa e veçantë*.

PJESA E DYTË

LIRIA E SHPREHJES RËNDËSIA E MEDIAVE NË MJEDISËT

MULTIETNIKE

1. LIRIA E MEIDIAVE DHE E DREJTA E MEDIAVE

1.1. Liria e shprehjes në dokumentet ndërkombëtare

Liria e të shprehurit paraqet pjesë të korpusit të të drejtave tradicionale politike dhe qytetare të cilat veçmas janë përcaktuar dhe formësuar gjatë revolucioneve qytetare ka fundi i shekullit 18. ajo sot është përcaktuar edhe me dokumentet më të rëndësishme të kombeve të caktuara si organizatë universale – botërore dhe të këshillit të Europës si organizatë regjionale paneuropiane. Qytetarët aktiv dhe të informuar janë një supstrat jetik i secilës shoqëri demokratike. Gjatë dhjetëvjeçarëve të fundit e drejta individuale e njeriut në lirinë e të shprehurit është zgjeruar edhe me të a.q. »të drejtë shoqërore-kolektive të qytetarëve që të jenë të informuar« si dhe »me të drejtën e opinionit për të ditur«. Ajo në dokuemntet ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut dhe në kushtetutat e vendeve demokratike është kodifikuar jo vetëm se si e drejtë e qytetarëve për të përhapur ide të ndryshme dhe informacione, por edhe e drejtë e tyre që ato t'i pranojnë dhe t'i kërkojnë.

Liria e të shprehurit sot paraqet një fushë shumë komplekse dhe shumë dinamike e që ka një histori të bujshme dhe të gjatë e cila është fituar mes tjerash në betejat e mëdha për lirinë e shtypit. E drejta për kërkimin dhe shfrytëzimin e informacioneve dhe të ideve është gjithësesi unike në mesin e lirive të tjera. Ajo siç u tha në seancën e parë të kuvendit të përgjithshëm të Kombeve të bashkuara, ***guri themeltar i të gjitha lirive*** që janë synim i Kombeve të bashkuara ose siç e ka formuluar këtë gjykatësi i Gjykatës supreme të SHBA-ve Kardoz, ***baza dhe kushti i pashmangshëm thuaja se gati i të gjitha formave të tjera të lirisë***. Ajo sipas mendimit të Sllloanit, ***e cakton përmbajtjen e lirive të tjera***, meqë në vendin ku ekziston liria e të shprehurit dhe në të cilin mediat janë të lira, ka gjasa më të mëdha se do të rrespektohen edhe të

drejtat dhe liritë e tjera.

Me vetë këtë, sanksioni përfundimtar për cënimin e të drejtave të njeriut është fuqia e opinionit publik të edukuar, e pikërishtë këto janë shtypi dhe mediat e tjera, të cilat këtë opinion publik njëkohësishtë edhe e informojnë edhe e edukojnë. Përveç kësaj, atje ku ekzistojnë mediat e lira, janë mjet i fuqishëm për realizimin e të drejtave të njeriut edhe në planin ndërkombëtar.

Në nenin *19të Deklaratës universale të Kombeve të bashkuara mbi të drejtat e njeriut (1948) liria e mendimit dhe e shprehjes* është përcaktuar si në vijim: »Secili ka të drejtë në lirinë e mendimit dhe të shprehurit, që përfshinë edhe të drejtën të mos jetë i shqetësuar për shkak të mendimit të tij, si dhe të drejtën për të kërkuar, të pranojë dhe të përhap informata dhe ide me çfardo mjeti dhe pa marrë parasyshë kufijt«.

Një formulim i ngjajshëm është përmbajtur edhe në nenin *19 të Paktit ndërkombëtar mbi të drejtat qytetare dhe politike, të Kombeve të bashkuara*: »Askush nuk mund të jetë i shqetësuar për shkak të mendimeve të tija. Secili person ka të drejtë në lirinë e të shprehurit. Kjo e drejtë pavarësishtë kufijëve, nënkupton lirinë *e të shprehurit, pranimit dhe të përhapjes* së informatave dhe të ideve të të gjitha llojeve, gojarishtë, përmes shtypit ose formave artistike ose në çfardo mënyre tjetër sipas zgjedhjes së lirë. Realizimi i këtyre lirive përfshinë detyrime të veçanta dhe përgjegjësi. Duke pasur këtë, ajo mund t'i nënshtrohet kufizimeve të caktuara të cilat megjithatë duhet patjetër të jenë shprehimishtë të caktuara me ligj, e janë të nevojshme për këto arsye: rrespektimin e të drejtave dhe të nderit të personave të tjerë; të mbrojtjes së sigurisë shtetërore, të rendit publik, të shëndetit dhe moralit publik.«

Në nenin *13. të Konventës amerikane mbi të drejtat e njeriut* është përcaktuar që: Secili ka të drejtë në lirinë e mendimit dhe të

shprehurit. Kjo e drejtë përfshinë lirinë *e kërkimit, pranimit dhe të përhapjes së informacionit* dhe të ideve të të gjitha llojeve, pa marrë parasyshë kufijtë, si me gojë ashtu edhe me shkrim, në formë artistike dhe me çfardo mjete sipas zgjedhjes personale. Aplikimi i kësaj të drejte të siguruar me alinenë pararendëse nuk guxon të jetë lëndë e cenzurimit paraprak mirëpo do të jetë subjekt i kufizimeve pasuese, vëllimi i të cilave do të caktohet me ligj me qëllim të sigurimit: të rrespektimit dhe të nderit të të tjerëve ose të mbrojtjes së sigurisë nacionale, rendit publik, shëndetit publik ose moralit. Liria e të shprehurit nuk guxon të jetë e kufizuar me metoda të tërthorta, si për shembull keqpërdorimin e kontrollit publik ose privat përmes shtypit, të frekuencave të radios ose paisjeve e cila shfrytëzohet për përhapjen e informatave, ose të çfardo forme tjetër me qëllim që të ndërpritet komunikimi dhe përhapja e ideve dhe mendimeve”

Edhe neni 10. *i Konventës europiane mbi të drejtat e njeriut* (1950) garanton *shprehjen e lirë* në këtë mënyrë: “Secili ka të drejtë në lirinë e të shprehurit. Kjo e drejtë përfshinë lirinë e posedimit të mendimit personal, *të pranimit dhe të komunikimit* ë informacioneve dhe të ideve pa përzjerje të pushtetit publik dhe pa marrë parasyshë kufijt. Ky nen nuk pengon shtetet të kërkojnë leje për punën e ndërmarrjeve të radios e televizionit dhe atyre kinematografike.

Meqë shfrytëzimi i këtyre lirive tërheq pas vetes detyrime dhe përgjegjësi, *ajo mund t’i nënshtrohet formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose dënimeve të parapara me ligj dhe të domosdoshme në shoërinë demokratike në interes të sigurisë nacionale, integritetit territorial ose të sigurisë publike, me qëllim të parandalimit të çrregullimeve dhe kriminalitetit, të mbrojtjes së shëndetit ose moralit, të mbrojtjes së nderit ose të drejtave të tjerëve, parandalimit të zbulimit të informacioneve të marra në besim, ose me qëllim të ruajtjes së autoritetit dhe të paanshmërisë së gjykatave.”*

Në gjysmëne dytë të shekullit 20, nga e drejta e të shprehurit gradualishtë vie deri te ndarja e dy të drejtave të reja: *liria e informimit*

publik dhe liria e qasjes në informata.

Në kushtet bashkëkohore, *liria e informimit publik*, si e drejtë e cila nxirret nga e drejta e lirisë së shprehjes, *përfshinë të drejtën në informim të vërtetë, me kohë dhe objektiv si dhe të drejtën që publikisht të kritikohet dhe të kërkohen sqarime në raport ndaj procedurave përkatëse dhe të akteve të pushtetit dhe të subjekteve të tjera*. Në evoluimin e tyre nga e drejta në lirinë e të menduarit, përmes të drejtës për paraqitjen publike të mendimit personal e deri te e drejta që të jetë i informuar dhe liria e të shprehurit, liria e informimit publik bëhet pjesë përbërëse e një morie të instrumenteve juridike ndërkombëtare, si edhe i regjimeve përkatëse të brendshme të disa vendeve.

Liritë e tjera të cilat tradicionalishtë dalin nga liria e të shprehurit, paraqiten ka fundi i viteve të 60-ta të shekullit XX, kur SHBA-të, në vitin 1966 të parat e rregulluan me ligj *lirinë e qasjes në informacione*, pas të cilës, gjatë tridhjet viteve të fundit, duke pasuar konceptin e shtetit dhe administratës sociale si sistem për rregullimin social të procesve shoqërore, liria e qasjes në informacione u njoh në shumë legjislatura nacionale në mbarë botën dhe në të gjitha kontinentet (Kanada, Australi, Zelandë e Re, Finland, Portugali, Danimark, Suedi, Norvegji, Greqi, Irland, Francë, Holandë, Poloni, Shqipëri, Çeki, Sllovakia, Bosnjë dhe Hercegovinë, Bullgari, Rumani, Indi, Kolumbi, Afrikë të Jugut, Uzbekistan, Zimbabve...).⁶⁵ në disa vende liria e qasjes në informacione me kalimin e kohës u bë e drejtë dhe liri e njeriut dhe e qytetarit e garantuar edhe me Kushtetutë.⁶⁶

⁶⁵ SHBA (1966), Kanada, Australia (1982), Zelanda e re (1982), Portugalia (1993), Danimarka (1970), Norvegjia (1970), Greqia (1999), Irlanda (1997), Franca (1978), Holanda (1991), Polonia (2001), Shqipëris (1999), Çekia (1999), Sllovakia (2000), Bosnja dhe Hercegovina (2000), Rumania (2001)... Burimi: David Banisar, Privacy International, July 2002 + FOIA news.

⁶⁶ Krahaso: Toby Mendel, *Freedom of information (a Comparative Legal Survey)*, United Nations Educational Scientific and Cultural Organisation (UNESCO), New Delhi, India, 2003, p. iii.

Liria e qasjes në informacione më së shpeshti caktohet si e drejtë e secilit që nga bartësit e pushtetit, përkatësisht të autorizimeve publike, të kërkojë dhe të marrë informacione relevante me interes publik ashtu që në mënyrë vepruese të mundësojnë vështrim në punën dhe procededimin e atyre subjekteve të cilëve qytetarët ia kanë dhënë besimin në zgjedhjet e lira dhe demokratike, që në emër të tyre dhe në llogari të tyre të ushtrojnë funksionin e pushtetit dhe lidhur me këtë, që të udhëheqin me punët e tjera publike.⁶⁷ Thënë më thjeshtë, fjala është për të drejtën e secilit (person fizik dhe juridik – të brendshëm dhe të jashtëm) që të informohet mbi të dhënat me të cilat disponojnë organet publike dhe subjektet e tjera të ngarkuara për ushtrimin e autorizimeve publike.

1.2. Praktika e Gjykatës europiane për të drejtat e njeriut e që ka të bëjë me lirinë e të shprehurit

Me rastin e interpretimit të Konventës europiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore, Gjykata europiane fillon me zbatimin e testit tripjesësh: pasi që në bazë të gjendjes faktike shpallë të *lejueshme* ndonjë ankesë për shkak të shkeljes së të drejtave të përcaktuara me Konventë, gjegjësisht vlerëson se me vendimin e organit kompetent të shtetit ka ardhur deri te përzierja në ndonjërin prej të drejtave dhe lirive të përcaktuara me Konventë, Gjykata në shqyrtimin e mëtejshëm të meritimit juridik të kontestit përcakton dhe bie aktgjykim mbi *(pa)arsyeshmërinë e asaj përzierje, gjegjësisht përcakton se në rastin konkret a ka ardhur me të vërtetë deri te cënimi i ndonjë të drejte të caktuar* të përcaktuar me Konventë. Ky rregull, natyrisht ka të bëjë edhe me *lirinë e shprehjes*.

Liria e shprehjes e formuluar në Konventën Europiane, tregon

⁶⁷ Krahaso: Zoran Jelić, *U susret zakonskom regulisanju slobodnog pristupa informacijama*, Ekonomika, Beograd, br. 3/2002.

qartë se *ajo nuk është e drejtë absolute*, siç është rasti, p.sh. me *të drejtën për të jetuar, ndaliminë e torturës dhe ndalimin e skllavërisë dhe të punës së detyruar*. Kjo liri për këtë mund të jetë e kufizuar nëse *kumulativisht janë plotësuar tri kushte: kur përzierja* (në kuptimin formalitetit, kushteve, kufizimeve ose ndëshkimeve) *është paraparë me ligj*, mandej *kur përzierja e shtetit ka për qëllim mbrojtjen e një ose më shumë interesave dhe vlerave të përcaktuara me Konventë* (siguria nacionale, siguria publike, integriteti territorial, parandalim i çegullimeve dhe kriminalitetit, mbrojtja e shëndetit dhe moralit, mbrojtja e nderit dhe e të drejtave të të tjerëve, parandalimin në zbulimin e informatave të dhëna në besim uautoritetit dhe të paanshmërisë së gjyqësorit) dhe kur kjo përzierje *është e domosdoshme në shoqërinë demokratike (parimi i proporcionalitetit)*.⁶⁸ Me rastin e interpretimit të dretave dhe lirive themelore të njeriut të caktuara me Konventën europiane për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut, Gjykata europiane i qaset zbatimit të testit të *proporcionalitetit*. Pasi që në bazë të gjendjes faktike e shpall ndonjë ankesë *të lejueshme* për shkak të cënimit të të drejtave të përcaktuara me Konventë, gjegjësisht vlerëson se me vendimin e organit të autorizuar shtetëror të një shteti ka ardhur deri te përzierja e tij “legale” në ndonjë të drejtë dhe liri të përcaktuara me Konventë, Gjykata në shqyrtimin e mëtejshëm të meritumit juridik të kontestit përcakton dhe bie aktgjykim mbi *(pa)arsyeshmërinë e asaj përzierje*.

Në pesëdhjetë vitet e fundit, është konstituuar një përvojë e pasur gjyqësore e *Gjykatës europiane për të drejtat e njeriut* (ndërsa deri në vitin 1998 edhe i Komisionit europian), si një mekanizëm mbinacional i mbrojtjes së të drejtave të njeriut të përcaktuara me Konventë. Praktika e Gjykatës europiane *me nenin 10 të Konventës europiane (liria e shprehjes)* në kushtet e sotme paraqet një materie të çmuar për

⁶⁸ Krahaso: Monica Macovei, *Sloboda izražavanja – Vodič za primenu člana 10 Evropske konvencije o ljudskim pravima*, Savet Evrope, Beograd, 2006, fq. 50-51; Vesna Aliburić, *Sloboda izražavanja u praksi Europskog suda za ljudska prava*, Narodne novine, Zagreb, 2002, fq. 31-39.

përparimin e legjislativave dhe të dispozitivave nacionale me të cilat ajo sigurohet.⁶⁹

Në praktikën e deritanishme të Gjykatës europiane për të drejtat e njeriut lidhur me *lirën e shprehjes*, janë kristalizuar mes tjerash këto parime:⁷⁰

1) Debati mbi çështjet me *interes publik serioz*, veçmas në kontekst të *debatit politik*, gëzon shkallë më të lartë të mbrojtjes së Gjykatës europiane.

2) Mbrojtjen e veçantë të të drejtës në lirinë e shprehjes e gëzojnë mediat dhe gazetarët për shkak të rolit të tyre të veçantë shoqëror të furnizimit të opinionit me informacione me interes publik, përkatësisht të rolit të mediave *si »qenë rojtarë« të shoqërisë demokratike*. Në këtë kuptim, secili ndëshkim i mediave dhe gazetarëve, për shkak të publikimit të informacioneve ose të paraqitjes së mendimit mbi personat dhe çështjet me interes publik legjitim, duhet të jetë i pranueshëm vetëm » në rast të arsyeve me rëndësi të veçantë«.

3) Kufijtë e *kritikës së lejuar janë dukshëm më të gjera* kur janë në pyetje *politikanët përkatësisht personat publik*, se sa personat privat, meqenëse të parët »vullnetarisht dhe me vetëdije« i nënshtrohen mbikqyrjes, si nga ana e gazetarëve ashtu edhe të opinionit të përgjithshëm dhe se në pajtim me këtë ata duhet patjetër të tregojnë edhe shkallë më të lartë të tolerancës, veçmas kur edhe vetë japin deklaratat provokative.

4) Qeveria (pushteti) *duhet të duroj shkallë më të lartë të kritikizmit*

⁶⁹ Krahaso: *Sudska praksa u vezi sa članom 10 Evropske konvencije o ljudskim pravima* (botimi i dytë i plotësuar në gjuhën serbe), Kancelarija Saveta Evrope u Beogradu, Beograd, 2001.

⁷⁰ Krahaso: Vesna Aliburić, *Sloboda izražavanja u praksi Evropskog suda za ljudska prava*, Narodne novine, Zagreb, 2002, fq. 60-62.

sepse »pozita e tij dominuese« imponon më shumë vetëpërbajtje me rastin e rrekjes pas masave ndëshkimore, posaçërisht nëse ekzistojnë mënyra të tjera të përgjigjes ndaj sulmeve arsyeshme dhe kritika të kundërshtarit ose mediave me pasojë më të vogla për lirinë e shprehjes.

5) Kujdes i veçantë duhet t'i kushtohet patjetër dallimit në mes të *fakteve dhe gjykimeve vlerësuese (shpifjes dhe fyerjes)*. Deri sa vërtetësia e fakteve mund të dëshmohet, vërtetësia e gjykimit vlerësues mendimit) është e pamundur të dëshmohet, andaj kërkesat e tilla vetvetiu paraqesin kufizimin e lirisë së të shprehurit. Kjo nuk don të thotë se publikimi i secilit gjykim vlerësues, para së gjithash madje edhe të atij fyes, gëzon mbrojtje absolute, mirëpo në atë rast, duhet të kihet parasysh në përmasën e përzierjes në lirinë e të shprehurit, si dhe a ka ardhur deri te ajo në baza faktike për konstatimin e kontestueshëm.

1.3. Vështrim i përgjithshëm në dokumentet e Këshillit të Europës që kanë të bëjnë me lirinë e të shprehurit

Gjithashtu duhet theksuar, se Këshilli i Europës (organet e tij, e para së gjithash Komiteti i ministrave të Këshillit të Europës), që nga themelimi në vitin 1949 e deri më sot, ka sjellur një numër të madh të *rezolutave dhe rekomandimeve* të cilat kanë të bëjnë me lirinë e të shprehurit, e në të cilat janë përmbajtur parimet dhe standardet themelore të cilat shtetet-anëtare të Këshillit të Europës duhet t'i kenë dhe t'i implementojnë përmes sjelljes së ligjeve dhe të dispozitave të tjera dhe me këtë të sigurojnë lirinë e shprehjes dhe të drejtave dhe lirive të dalura nga kjo.

Për nga natyra e tyre, dokumentet e përmendura të Këshillit të Europës si organizatë ndërkombëtare, janë juridikisht joobliguese për shtetet –anëtare të kësaj organizate (për dallim nga Konventa). Ato në masë të dukshme kanë edhe dimension politik, me qëllim që shtetet anëtare të Këshillit të Europës që këtë nuk e kanë bërë ende, që në legjislativat e tyre të fusin standardet juridike të cilat si të tilla

parimishtë janë përcaktuar dhe detajizuar përmes rezolutave dhe rekomandimeve. Rekomandimet dhe rezolutat, para së gjithash të Komitetit të ministravë të Këshillit të Europës, bihen edhe si pasojë e aktgjykimeve përkatësishtë të qëndrimeve deri te të cilat Gjykata europiane për të drejtat e njeriut ka ardhur në aktgjykimet e veta.

Në këtë vend do të përmendimi vetëm se disa nga rekomandimet më të rëndësishme: *Rezoluta (74) 26 mbi të drejtën në përgjigje – pozita e individit në raport me shtypin; Rekomandimi nr. R (10)96 mbi garantimin e pavarësisë së servisit të pavarur radio-difuziv publik; rekomandimi nr. R (97) mbi ndalimin e gjuhës së urrejtjes; Rekomandimi nr. R(97)21 mbi mediat dhe promovimin e kulturës së teolerancës; Rekomandimi R(2000)23 mbi pavarësinë dhe të funksioneve të trupit rregullues në sferën e radio-difuzionit; Rekomandimi nr. R (2002) 2 mbi vështrimin në dokumentet zyrtare dhe të tjera.*⁷¹ Një pjesë e rekomandimeve dnalizohen veçmas në kuadër të pjesëve të mëvonshme të kësaj pjese të Doracakut.

⁷¹ Krahaso: *Zbornik pravnih instrumenata Saveta Evrope u vezi sa medijima* (botimi i dytë i plotësuar në gjuhën serbe), zyra e Këshillit të Europës në Beograd, Beograd, 2006.

2. RREGULLIMI KUSHTETUES DHE LIGJOR I LIRISË SË SHPREHJES DHE I PUNËS SË MEDIAVE NË SERBI

2.1. Një vështrim i përgjithshëm ndaj rregullimit Kushtetues dhe ligjor të punës së mediave

Nocioni *reregullim ligjor* (*statutory regulation*) aplikohet në çfarë mase me të cilën parlamenti ndikon ndaj punës së mediave. Në këtë kategori biejnë shpifjet, të cilat i hasim në të gjitha shtetet, normat ligjore kundër nxitjes së urrejtjes racore si dhe të ndalimit të të drejtës së gazetarëve që të publikojnë emrat e viktimave të dhunimit ose të keqëtrajtimit seksual. Mund t'i hasim në shumë shtete. Ekzistojnë dispozita ligjore të cilat kanë të bëjnë me raportimin nga proceset gjyqësore, raportimi mbi punën e Kuvendit ose të vetadministrimit lokal. Dispozitat mbi dipozicionueshmërinë e informatave e obligojnë pushtetin që të sigurojnë informata të gjithëve që i kërkojnë ato, andaj edhe gazetarëve. Kjo e drejtë në qasje në informata ka edhe përjashtime të caktuara. Dispozitat rigjide mbi sekretet shtetërore edhe më tej ekzistojnë në një numër të shteteve, mirëpo ata që avokojnë lirinë e informimit gjithnjë e më tepër dhe me më shumë sukses i konstestojnë këto kufizime. Në disa, por mjerisht jo edhe në të gjitha vendet europiane, me ligj është rregulluar obligimi i gazetarit që ta mbroj burimin e tij të informatave të besueshme. Ligji mund ta pengoj gazetarin e mirë, mirëpo asnjë ligj nuk mund ta krijoj atë. Meqenëse, gazetaria e mirë është çështje e përgjegjësisë, ndërsa askë nuk mund ta detyroni të jetë i përgjegjshëm. Gazetarëve nuk është e mundur t'iu imponohen dispozita të vrazhdëta dhe ndonjë mënyrë pune të përcaktuar. Si t'i imponohet norma mbi një nivel të caktuar të kujdesit të gazetarit i cili e përcjellë hetimin mbi korrupsionin ose raporton mbi donjë tragjedi të madhe? A është e mundur që saktësishtë të caktohet se

sa kohë është e nevojshme për përgatitjen e transmetimit të një ndeshje të madhe të futbollit? Megjithatë, *rregullacioni shtesë ligjor është i domosdoshëm* për raste të caktuara.

Në Serbi, krahas garancioneve kushtetuese të lirisë së shprehjes, të drejtat e mediave dhe e drejta në informim, ekzistojnë dy ligje sistemore dhe një mori e tërë e ligjeve të veçanta, të cilët pjesërishtë, ose vetëm në dispozita të caktuara kanë të bëjnë me lirinë e shprehjes, e me vetë këtë tërthorazi edhe me punën e mediave.

2.2. Kushtetuta e Republikës së Serbisë

Kushtetuta e Republikës së Serbisë, në pjesën që ka të bëjë me të drejtat e njeriut dhe të pakicave, garanton: lirinë e mendimit dhe të shprehjes, lirinë e të shprehurit të përkatësisë nacionale, lirinë e mediave dhe të drejtën në informim. Gjithësesi se sfera qendrore është liria e mendimit dhe e shprehjes, nga e cila mandej „ndahet“ liria e shprehjes së pakicave nacionale si dhe liria e mediave dhe e drejta në informim.

Liria e mendimit dhe e shprehjes, është garantuar në këtë mënyrë: „garantohet liria e mendimit dhe e shprehjes, si edhe liria që përmes të folurit, shkrimit, fotografisë ose në mënyrë tjetër *të kërkohen, pranojnë dhe të përhapen* informacione dhe ide“. Liria e shprehjes *mund të kufizohet me ligj*, nëse kjo është e domosdoshme *me qëllim të mbrojtjes së të drejtave dhe reputacionit të të tjerëve, të ruajtjes së autoritetit dhe të neutralitetit të gjykatës dhe të ruajtjes së shëndetit publik, moralit të shoqërisë demokratike dhe të sigurisë nacionale të Republikës së Serbisë.*

Kjo dispozitë kushtetuese, pjesërishtë është më e gjerë mirëpo edhe më e ngushtë nga ajo që përmban Konventa europiane. Për dallim nga neni 10 i Konventës europiane e cila me lirinë e shprehjes nënkupton të drejtën e pranimit dhe të përhapjes, Kushtetuea e

Republikës së Serbisë e njëh të drejtën e kërkimit të informacionit, që është e rëndësishme nga këndvështrimi i lirisë së qasjes në informacione. Nga ana tjetër, formulimi kushtetues i lirisë së shprehjes, kur është fjala mbi kufizimet e lirisë së shprehjes, në masë të dukshme e ngushton këtë liri. Mund të vërehet, se kufizimi i parë që është përcaktuar me Kushtetutë, është mbrojtja e të drejtave dhe e nderit të tjerëve, ndërsa Kushtetuta nuk e njëh kufizimin të përmbajtur në Konventën europiane e cila ka të bëjë me parandalimin e çrregullimeve dhe kriminalitetit. Edhe fjalët „të shoqërisë demokratike“ të përmbajtura në formulimin Kushtetues të kufizimit, mund të konsiderohen të polemizueshme, meqë në tekstin e Konventës europiane, ato shenjojnë nevojën që të zbatohet „testi i proporcionalitetit“ madje edhe atëherë kur në shikim të parë ekziston nevoja për lirinë e të shprehurit, mirëpo vetëm se atëherë kur kjo është e domosdoshme në „shoqërinë demokratike“ mirëpo duket se kjo nuk del të kuptohet nga kuptimi semantik i dispozitës kushtetuese.

Si liri që del nga liria e të shprehurit, Kushtetuta e RS si *liri të veçantë* e përcakton *lirinë e mediave* (neni 49). *Secili është i lirë që pa leje*, në mënyrën e përcaktuar me ligj, të themeloj gazeta dhe mjete të tjera të informimit publik. Stacionet televizive dhe të radios themelohen në pajtim me ligjin. Në Republikën e Serbisë *nuk ka censurë*. *Gjykata kompetente mundë të pengoj përhapjen e informacioneve dhe ideve* të shkaktuara përmes mjeteve të informimit publik, vetëm nëse kjo në shoqërinë demokratike është *e domosdoshme me qëllim të thirrjes për rrënimin e dhunshëm të rendit të përcaktuar me Kushtetutë ose të rrënimit të integritetit territorial të Serbisë*, parandalimit të propagandimit të luftës ose të nxitjes për dhunë të drejtëpërdrejtë ose *me qëllim të parandalimit të avokimit për urrejtje racore, nacionale ose fetare*, me të cilat nxitet diskriminimi, armiqësia ose dhuna. Realizimi i të drejtës *në përmirësimin e informatës së pavërtetë, jo të plotë ose jo të saktë, të transmetuar tashmë* me të cilën është çenuar e drejta ose interesi i dikujt dhe e drejta në përgjigje ndaj informatës së publikuar, rregullohen me ligj.

Kjo dispozitë kushtetuese në masë të dukshme “zgjeron” rastet e kufizimit të lirisë së shprehjes në media, ngase gjykata kompetente mund ta ndaloj përhapjen e ideve dhe informatave përmes mjeteve të informimit publik. Meqenëse Ligji është sjellur pas miratimit të ligjeve mbi mediat, mbetet e panjohur se si ka mundur që në dispozitën kushtetuese nuk është përdorur shprehja mjetet e informimit publik ose mediat publike, ashtu që ekziston “disharmonia” e shprehjeve të cilat shfrytëzohen në Kushtetutë dhe ligj. Gjithashtu me interpretimin e kësaj dispozite kushtetuese, më saktë, të pjesës në të cilën thuhet ...”të thirrjes për rrënim të dhunshëm të rendit të përcaktuar me Kushtetutë ose të prishjes së integritetit territorial të Republikës së Serbisë”, mundë sërish, në frymën e kuptimit gjuhësor të kësaj norme, të paraqes gjithashtu edhe një rast specifik të kufizimit të lirisë së shprehjes, ngase debati publik (medial) mbi integritetin territorial të një vendi e që nuk ka karakteristika të thirrjes për prishje të tij të dhunshëm, është krejtësisht legjitime nga pikëvështrimi i Konventës europiane, gjë të cilën Gjykata europiane në më shumë raste edhe e ka vërtetuar veçmas gjatë aktgjykimeve kundër Turqisë.

Si e drejtë e veçantë e garantuar me Kushtetutë “është njohur” edhe e *drejta në informim* (neni 51.). qysh më herët kemi thënë se në gjysmën e dytë të sekullit 20. nga liria e shprehjes gradualishtë u ndanë edhe dy të liri (drejta) të veçanta: liria e informimit publik dhe liria e qasjes në informacione. E drejta në informim e cila është përcaktuar me Kushtetutë, që pikërishtë i konsumon dy liritë e përmendura më parë. Mirëpo mbetet e paqartë që për këtë të drejtë është përdorur emërtimi: “e drejta në informim” e jo për shembull liria e informimit publik dhe liria e qasjes në informacione. Formulimi i alinesë së parë të nenit 51. të Kushtetutës, pashmangshëm na përkujton në definicionin tashmë të dhënë më parë të të drejtës në informim publik: “Secili ka të drejtë *në informim të vërtetë, të plotë dhe me kohë* për çështjet me interes publik dhe se mjetet e informimit publik janë të obliguara që këtë të drejtë ta rrespektojnë”. Përmes alinesë dy të nenit 51. të kushtetutës është

përcaktuar liria e qasjes në informacione (edhe pse në Kushtetutë, ajo nuk emërtohet kështu dhe është pjesë e të drejtës në informim: “Secili ka të drejtë në qasje ndaj të dhënave të cilat janë në posedim të organeve dhe organizatave shtetërore të cilat jnaë të ngarkuara me autorizime publike, në pajtim me ligjin.

Në masë të dukshme mund të përfundohet se dispozitat Kushtetuese të cilat përkojnë me lirinë e të shprehurit dhe mediat nuk janë të kqia, mirëpo ka ekzistuar nevoja për rregullimin e tyre më të mirë normativ, ngase disa formulime si të tilla janë hutuese dhe mund të sjellin deri te interpretimet e ndryshme juridike të cilat në veçanti në rastet e kufizimit të lirisë së shprehjes, mund të sjellin deri te kufizimet e papranueshme të lirisë së shprehjes. Gjithashtu edhe shprehjet të cilat shfrytëzohen mund të sjellin deri te dilemat, veçmas nëse sistemi juridik i një vendi vështrohet në konteskt të korpusit të normave të përgjithshme juridike të cilat paraqesin një tërësi unike dhe jo kundërthënëse.

2.3. Ligjet mbi mediat dhe ligjet e tjera në Serbi

2.3.1. Ligji mbi informimin publik

Gjithësesi, Ligji themelor i cili ka të bëjë me lirinë e shprehjes është *Ligji mbi informimin publik* (2003).⁷²

Me këtë ligj rregullohet e *drejta në informim publik si e drejtë në lirinë e shprehjes së mendimit, si dhe e drejta dhe obligimi i pjesëmarrësve në procesin e informimit publik*. E drejta në informim publik përfshin në veçanti lirinë e të shprehurit të mendimit, lirinë e grumbullimit, hulumtimit, publikimit dhe përhapjes së ideve, informacioneve dhe mendimeve, lirinë e të shtypurit dhe distribuimit të

⁷² *Zakon o javnom informisanju*, „Službeni glasnik RS“ br. 43/03 dhe ndryshimet e plotësimet e mëvionshme.

gazetave dhe të mjeteve të tjera publike, lirinë e prodhimit dhe të emitimit të programit të radios dhe televizionit, lirinë e pranimit të ideve, informacioneve dhe mendimeve si dhe lirinë e themelimit të personave juridik që merren me informimin publik.⁷³

Në këtë vend do të flasim vetëm se për disa prej parimeve më të rëndësishme:

1) ***Askush nuk guxon, as në mënyrë të tërthortë, ta kufizoj lirinë e informimit publik***, posaçërisht të keqpërdorimit të së drejtës, ndikimit ose të kontrollit mbi mjetet për botimin dhe distribuimin e gazetave ose mbi aparaturat për emetimin e frekuencave të radios, as me ndonjë mënyrë tjetër të përshtatshme për të kufizuar qarkullimin e lirë të ideve, informacioneve dhe mendimeve.

2) Askush nuk guxon të ushtroj çfardo ***presioni fizik apo presion tjetër*** ndaj gazetave publike dhe personelit të tyre, si dhe të ndikoj në pengimin e tyre në ushtrimin e detyrës.

3) Gazetari dhe redaktori përgjegjës të mjeteve publike të informacionit janë të obliguar që ***para publikimit të informacionit që përmban të dhëna mbi një ngjarje, dukuri ose personalitet të caktuar, me kujdesin në përputhje me rrethanat të verifikoj prejardhjen, vërtetësinë dhe plotësinë e informacionit.***

4) ***Bartësve të funksioneve shtetërore dhe politike iu janë të kufizuara të drejtat në mbojtjen e privatësisë*** të cilat i kanë personat ndaj të cilëve përkon informacioni, nëse informacioni është i rëndësishëm për opinionin, duke pasur parasyshë faktin se personi me të cilin ka të bëjë informata ushtron një funksion të caktuar.

5) Organet dhe organizata shtetërore, organet e autonomisë territoriale

⁷³ Krahaso: *Zakon o javnom informisanju*, „Službeni glasnik RS“ br. 43/03, čl. 1. dhe ndryshimet e plotësimet e mëvionshme.

dhe të vetadministrimit lokal, shërbimet publike dhe ndërmarrjet publike si edhe deputetët dhe këshilltarët, *e kanë për obligim* që informacionet mbi punën e tyre *t'i bëjnë publike për opinionin* edhe atë nën kushtet e njëjta për të gjithë gazetarët dhe të gjitha mjetet e informimit publik.

Është vërejtur se ligji edhe në dispozitat parimore mirëpo edhe në tërësi, përmban vetëm se disa norma juridike të cilat knaë *të bëjnë me gazetarët*, që del nga *qëndrimi ekskluziv* i Këshillit të Europës, se të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e gazetarëve, nuk rregullohen me ligj, por *përmes procesit të vetërregullimit dhe derregullimit*. Në kushtet bashkëkohore, në të drejtën krahasimtare, është e dukshme se *raportet në informimin publik dhe profesionalizmi medial dhe gazetaresk nuk rregullohen me ligj*, përkatësisht duke parapare rregulla të caktuara të sjelljes në fushën e informimit publik nga ana e shtetit, porse para së gjithash me Kodin e gazetarisë dhe përmes trupave të cilat i themelojnë vetë mediat, gazetarët dhe pronarët e mediave – i a.q. *Këshilli për media* (përkatësisht këshilli për shtyp).⁷⁴

Në këtë vend do të përmendim një dispozitë të tillë, e cila gjithësesi është e rëndësishë së madhe për ushtrimin e profesionit të gazetarit – *sekreti i gazetarit* (ose mbrojtja e burimit të gazetarit): Sipas ligjit, ..., *gazetari nuk është i obliguar që t'i zbuloj të dhënat lidhur me burimin e informacionit, përveç nëse të dhënat përkojnë me veprë penale, përkatësisht ndaj kryesit të veprës penale për të cilën kërcënon ndëshkimi me burgim prej së paku pesë vitesh*“.

Ligji e cakton nocionin e mediave publike, impresumin dhe regjistrimin e mediave publike dhe ndalimin e shpërndarjes së informacioneve. Ligji, gjithnjë deri te ndryshimet dhe plotësimet e fundit të cilat u pasuan në shtator të viti 2009, nuk përmbante detyrimin e mediave publike që të regjistrohen e as për udhëheqjen e regjistrimit të

⁷⁴ Krahaso: *Sloboda i odgovornost: Očuvanje slobode izražavanja putem medijske samoregulacije*, Article XIX (në botim dhe përkthim të komitetit të juristëve për të drejtat e njeriut), Beograd, 2005.

mediave publike (përveç mediave elektronike, mirëpo çështja e regjistrimit të mediave elektronike ishte e rregulluar me Ligjin mbi radiodifuzionin) ngase në procedurën e sjelljes së ligjit dhe në shqyrtimet publike të mbajtura në vitet 2000 dhe 2001, mbizotëroi qëndrimi se **regjistrimi i mediave publike mund të jetë bazë për ngushtimin e lirisë së shprehjes**, gjë e cila në Serbi ishte rast i shpeshtë gjatë viteve 90-ta. Gjithashtu me ndryshimet dhe plotësimet e ligjit, u përcaktua se themeluesi i medias publike mund të jetë **vetëm se person juridik i vendit** gjë e cila është në kundërshtim me formulimin kushtetues se çdokush, në pajtim me ligjin, mund të jetë themelues i mediave.

Kujdes të veçantë ligji i kushton **të drejtave dhe obligimeve të veçanta në informimin publik**.⁷⁵

Këto janë para së gjithash ruajtja e arkivave të mediumit publik; e drejta në qasje dhe arkivin e mediumit publik; **supozimi i pafajësisë; ndalimi i gjuhës së urrejtjes; mbrojtja e të miturve dhe ndalimi i ekspozimit publik të pornografisë**.⁷⁶

Duke patur në konsideratë rolin specifik të cilin e ka pasur një pjesë e mediave në të kaluarën, mirëpo, mjerisht edhe sot, veçmas duhet ndarë **ndalimin e gjuhës së urrejtjes**, ngase gjuha e urrejtjes edhe më tej është e pranishëm në masë të madhe në mediat serbe. Gjithashtu ndalimi i gjuhës së urrejtjes është përcaktuar edhe përmes disa rekomandimeve të Këshillit të Europës,⁷⁷ gjë e cila këtë bazë të kufizimit të lirisë së të shprehurit (natyrishtë në varësi nga karakteristikat e secilit rast konkret) e bënë plotësishtë **legjitim**. Gjithashtu ai është qenësor për të kuptuar rolin e mediave lokale në

⁷⁵ Krahaso: *Zakon o javnom informisanju*, "Službeni glasnik RS" br. 43/03, IV *Posebna prava i obaveze u javnom informisanju*, čl. 35-42.

⁷⁶ Krahaso: *Zakon o javnom informisanju*, "Službeni glasnik RS" br. 43/03, VII. *Posebna prava i obaveze u javnom informisanju* čl. 35-42

⁷⁷ Krahaso: Rekomandimi i Komitetit ministror të KE nr. R (97) o *zabrani govora mržnje*; Rekomandimi i Komitetit ministror nr. R (97) 21 o *medijima i promovisanju kulture tolerancije*.

mjediset multietnike. Përhapja e gjuhës së urrejtjes përmes mediave ka mundësi që dukshëm ta rëndoј situatën e atjeshme, madje edhe t'i kontribuoj në krijimin e situatave konfliktuoze, për të cilën më shumë do të flitet pakë më vonë.

Një numër i madhë i normave të përmbajtura në Ligjin mbi informimin publik ka të bëjë *me të drejtën e personave me të cilët ka të bëjë informacioni i caktuar*, veçmas në kontekst ndaj privatësisë,⁷⁸ Ligji njeh institutet tradicionale të lirisë së shtypit: *të drejtën për t'u përgjigjur dhe të drejtën e përmirësimit* dhe përcakton procedurën gjyqësore në rast të padisë për publikimin e përgjigjes dhe përmirësimit.⁷⁹ Ligji në formë të kapitujve të veçantë përmban edhe dispozita që kanë të bëjnë *me mbikqyrjen, gjobat si dhe dispozitat e përkohshme dhe përfundimtare*.

2.3.2. Ligji mbi radiodifuzionin dhe ligjet e tjera

Ligji tjetër është *Ligji mbi radiodifuzionin*.⁸⁰ Ai në mënyrë sistematike e rregullon punën e mediave elektronike. Me këtë ligj rregullohen kushtet dhe mënyra e ushtrimit të veprimtarisë radiodifuzive në pajtim me Konventat dhe standardet ndërkombëtare, përcakton procedurën për dhënien e lejes për emitim, përcakton kushtet për lëshimin e lejes për emitim të programit ta radios dhe televizionit dhe të emitimit të vetë programit, është themeluar Agjencioni republikan për radiodifuzion (ARR) si një trup rregullues i pavarur si dhe entet e servisit publik radiodifuziv të cilat është dashur të kontribuojnë shëndërrimit të RTS të atëhershëm në servis publik të liruar nga kontrolli politik. Në momentin e aprovimit, me ligj janë

⁷⁸ Krahaso: *Zakon o javnom informisanju*, "Službeni glasnik RS" br. 43/03, VIII Prava lica na koje se odnosi informacija, čl. 43-90.

⁷⁹ Krahaso: *Zakon o javnom informisanju*, "Službeni glasnik RS" br. 43/03, VIII Prava lica na koje se odnosi informacija, 2. Odgovor na informaciju i ispravka informacije, čl. 47-60.

⁸⁰ Krahaso: *Zakon o radiodifuziji*, „Službeni glasnik RS“ br. 42/02, 97/04, 76/05, 79/05, 62/06, 85/06, 86/06.

rrespektuar standardet e larta të përmbajtura në dokumentet e ndryshme ndërkombëtare të cilat kanë të bëjnë me këtë fushë e para së gjithash **standardet e Këshillit të Europës që janë pjesë e rekomandimeve të Komitetit të Ministrave të KE-së** (fjala është për rekomandimin R (96) 10 mbi garantimin e pavarësisë të servisit radiodifuziv dhe për Rekomandimin R (2000) 23 mbi pavarësinë dhe funksionet e organit regullator në fushën e radiodifuzionit).

Është me rëndësi të theksohet se Agjencioni i kryen edhe punët që kanë të bëjnë me **ndërmarrjen e masave në fushën e radiodifuzionit** me qëllim: të mbrojtjes së të miturve; të aplikimit të dispozitave mbi të drejtat autoriale dhe të ngjajshme me të; **parandalimine emitimit të programit** i cili përmban informacione me të cilat **nxitet diskriminimi, urrejtja ose dhuna kundër personave ose të grupit të personave për shkak të përkatësisës së tyre ose të mospërkatësisës së tyre racës, besimit, kombit, grupit etnik ose gjinisë**. Në këtë kuptim, ARR ndaj të gjithë emituesve është edhe mekanizëm i kontrollit“ i cili duhet të parandaloj shkeljen e të drejtave të njeriut dhe të pakicave të vetë pakicave nacionale para së gjithash përmes pengimit të diskriminimit dhe të parandalimit të gjuhës së urrejtjes.⁸¹

Ligji mbi radiodifuzionin, ka rrespektuar ekzistimin e stacioneve të radiove dhe televizioneve lokale të cilat para aprovimit të ligjit ishin themeluar në Serbi nga ana e vetadministratave lokale. Me ligj është përcaktuar, që nëse dy apo më shumë kuvende komunale të themelojnë një medium të përbashkët elektronik ose e themelon kuvendi i qytetit. Një medium i tillë elektronik ka karakter të radio stacionit dhe/ose stacionit televiziv të komunitetit regional. Sipas ligjit, njësitë e vetadministrimit lokal mund të themelojnë vetëm se një stacion të radios dhe/ose televizionit dhe të emetojnë vetëm se një program të

⁸¹ Krahaso: *Zakon o radiodifuziji*, "Službeni glasnik RS" br. 42/2002, 97/2004, 76/2005, 79/2005, 62/2006, 85/2006, 86/2006, čl. 6-21.

radios dhe /ose televizionit. Këto stacione kanë statusin e ndërmarrjeve publike, gjë që don të thotë se drejtorët por edhe anëtarët e këshillit mbikqyrës dhe drejtues i zgjedh dhe i shkarkon organi i njësisë së vetadministrimit lokal. Këto stacione e kanë statusin e ndërmarrjeve publike gjithnjë deri sa mjetet në pronësi shtetërore kanë pjesëmarrje shumicë në kapitalin e tyre të përgjithshëm. Këtyre stacioneve të radios dhe/ose televizionit leja iu jipet pas pjesëmarrjes në konkursin publik për zonën e dëshiruar të servisit.

Stacionet e radios dhe/ose televizionit të tilla janë ***të obliguara t'i përmbahen*** dispozitave të këtij ligji të cilat kanë ***të bëjnë me obligimet e veçanta të servisit publik radiodifuziv*** me rastin e prodhimit dhe të emitimit të programit, gjithnjë deri sa gëzojnë statusin e ndërmarrjes publike. Deri sa e kanë statusin e ndërmarrjes publike, drejtorët, redaktorët kryesor dhe përgjegjës dhe anëtarët e këshillave drejtues të radiove dhe/ose televizioneve lokale dhe/ose të komuniteteve regjionale nuk mund të jenë deputetët popullor, deputetët në kuvendin e krahinës autonome, këshilltarët, personat e zgjedhur, të caktuar dhe të emëruar në organet e Serbisë dhe Malit të Zi, në organet republikane, krahinore ose në organet lokale të pushtetit ekzekutiv, as edhe funksionarët e organizatave politike. Këto stacione të radios dhe/ose televizionit ishte dashur të privatizoheshin më së voni deri më 31 dhjetor 2007, mirëpo me aprovimin e Ligjit mbi vetadministrimin lokal dhe të ligjit mbi kryeqytetin, ky proces është ndërprerë në afat të pacaktuar.

Në territorin e një ose më shumë komunave, si dhe në territorin e qytetit, program të radiove dhe/ose të televizionit mund të emitojnë edhe stacionet private të radios dhe/ose televizionit dhe themelues i të cilave nuk është kuvendi i një ose më shumë komunave, përkatësisht kuvendi i qytetit ose që kapitali shtetëror nuk përbënë shumicën e tij.

Stacionet e tilla nuk kanë status të veçantë të stacionit të radios dhe/ose televizionit lokal ose regjional dhe ndaj tyre zbatohen dispozitat e këtij

ligji të cilat vlejnë për *stacionet komerciale radi-televizive*.

Në korpusin e një morie ligjesh të tjera të cilat pjesërishtë ose parçialishtë ose vetëm se në dispozita të caktuara kanë të bëjnë me gazetarët dhe mediat, duhet theksuar edhe *Ligjin mbi qasjen e lirë në informacionet e rëndësisë publike*, mandej, *Ligji mbi publikimin e informacionit*, *Kodi penal* (veprat penale të fyerjes dhe shpifjes dhe veprat e tjera), *Ligji mbi raportet obligative* (shkelja e nderit dhe autoritetit dhe kompensimi i dëmit material dhe jomaterial) e tj.

3. RAPORTI I TË DREJTËS MEDIALE DHE I STANDARDEVE ETIKE TË PROFESIONIT TË GAZETARISË

3.1. Vetërregullimi i mediave

Edhe procesi i vetërregullimit të mediave ka rëndësi të madhe edhe për rregullimin juridik të mediave. Prosesi i vetërregullimit nënkupton nënshtrim të vullnetshëm të gazetarëve ndaj vetërregullimit të profesionit gazetaresk. Vetërregullimi në çfardo profesioni ose sferë të shoqërisë supozon që normën shoqërore (etikën) ta zhvillojnë dhe zbatojnë ata sjellja e të cilëve rregullohet përmes atyre normave, e me qëllim të përmirësimit të shërbimeve të ofruara ndaj konsumatorëve, kërkuesve ose , sikur në rastine mediave, shoqërisë në përgjithësi. Ajo kërkon vendosjen e standardeve dhe përputhjen me standardet e individëve dhe institucioneve me të cilët ata kanë të bëjnë si edhe zhvillimi i procedurave dhe mekanizmave që munësojnë zbatimin e këtyre rregullave.⁸²

Pra normat etike janë formë e normës shoqërore të cilat ***nuk janë norma juridike***. Pasi që norma juridike është rregull obligative mbi sjelljen e njerëzve në shoqëri të garantuara me autoritetin e shtetit, gjë që nuk është kështu me normat etike, e cila garantohet para së gjithash me fuqinë e shoqërisë, grupe të caktuara shoqërore ose me fuqinë e profesionit të caktuar shoqëror. Kjo don të thotë, se shteti, para së gjithash gjykatat, nuk janë ato që luajnë rolin e arbitrit e as që zbatojnë rregullat e proklamuar, gjegjësisht normën etike, ato as që janë, për shembull, gazetarët, të cilët obligohen me këto rregulla, e as që këtë e bëjnë nën kërcënimin e sanksioneve, por para së gjithash për

⁸² Mbi çështjen e vetërregullimit të mediave më gjerësisht: *Sloboda i odgovornost – Očuvanje slobode izražavanja putem medijske samoregulacije*, Article XIX; London, 2003, Komitet pravnika za ljudska prava, Beograd, 2005. fq. 11-15.

shkak të dëshirës për zhvillimin dhe forcimin e mëtejshëm të autoritetit dhe besimit të profesionit. Vetërregullimi varet më së shumti nga mirëkuptimi dhe pajtimi i ndërsjellë i pjesëmarrësve mbi parimet etike të sjelljes dhe sistemit të vlerave të profesionit të tyre. Çështjet thelbësore të cilat duhet shqyrtuar në krijimin e konceptit dhe të zhvillimit të sistemit të vetërregullimit janë: kush konsiderohet përgjegjës, kujt i konsiderohet përgjegjës, cili është qëllimi i asaj përgjegjësie dhe si dhe me çfarë rezultati dëshirohet që kjo të realizohet.

Çështja e rezultatit të vetërregullimit ndërhyt thellë në thelbin e çështjes së qëllimit dhe të rolit që do të duhej ta kishte gazetaria në një shoqëri demokratike. Detyra e parë e gazetarit është të ofroj informata të sakta, të pavarura dhe me kohë në bazë të të cilave mund të bëhen zgjedhje dhe të bihen vendime. Për përmbushjen e rolit të »rojarit publik« mediat duhet patjetër ta ruajnë besimin e opinionit. Kjo kërkon standarde më të larta etike. Krijimi i sistemit efikas të vetërregullimit i cili do të ndihmonte zhvillimin e këtyre standardeve dhe vlerësimi i implementimit të tyre e forcojnë lidhjen në mes të mediave dhe opinionit publik.

Në të gjitha rastet, Këshilli i Europës e përkrah fuqishëm krijimin e trupave vetërregullues në fushën e gazetarisë. Këshilli e pranon se puna ligjëdhënëse mund të jetë e nevojshme nëse vetërregullimi nuk ka sukses, mirëpo së pari duhet sprovuar procesin vetërregulluar. Për shembull, në rezolutën e aprovuar në Konferencën e 4 ministrorë mbi çështjet e mediave masovike të mbajtur në vitin 1994, Këshilli ka nxitur pushtetet publike që të përmbahen dhe të japin rastin profesionit të gazetarisë që t'i detajizoj parimet e vetërregullimit. Për shembull, në formë të kodeksit të sjelljes i cili përshkruan se si të drejtat dhe liritë e tyre duhet të jenë patjetër në pajtim me të drejtat, liritë dhe interesat e të tjerëve me të cilët mund të vinë në konflikt, si dhe me përgjegjësinë e vet.⁸³

⁸³ Rezoluta e Këshillit të Europës nr. 2. mbi të drejtat dhe liritë e gazetarisë, e miratuar në Konferencën e 4 ministrorë mbi çështjet e masmediave.

Si rojtarë të standardeve etike andaj për këtë në shumë vende paraqiten ombudsmanët medial (Suedi), Këshillat për shtyp ose media (Gjermani) dhe tj. Atë e përbëjnë pjesëtarët e këtij profesioni përkatësishtë gazetarët me reputacion mirëpo shpesh edhe persona të tjerë të cilët tërthorazi janë të ndërlidhur me mediat (botuesit, redaktorët, përfaqësuesit e organizatës të cilët merren me mbrojtjen e të drejtave të njeriut).

Është thelbësore të thuhet se standardi/norma etike sipas rregullit është shumë më i »gjerë« se sa që është rasti me normën juridike.

Shpesh ndodhë që standardi etik i profesionit të gazetarisë të përcaktohet me Kodeksin e gazetarisë, njëkohësishtë, direkt ose tërthorazi, janë edhe standarde juridike të cilët si të tillë janë të përcaktuar edhe me normën juridike. Mirëpo gjerësia e normës etike dhe »fleksibilitetit« i saj, gjithësesi në masë të rëndësishme ndikon edhe në çështjen e »përgjegjësisë«. Sepse, ajo që në një rast mund të jetë e theksuar si cënim i normës juridike nga ana e Gjykatës në fushën e informimit publik, nuk do të thotë patjetër edhe cenimi i standardit të formuluar etik.

Nga ana tjetër, sipas rregullit, shkelja e normës etike njëkohësishtë paraqet edhe shkelje të normës etike, andaj edhe i normës juridike të gazetarëve. Për këtë rrespektimi i rregullave të vetërregullimit përkatësishtë të standardeve etike është shumë i rëndësishëm. Në vendet në të cilat rrespektohen standardet etike të profesionit të gazetarisë, andaj sipas rregullit, numri i procedurave të ndryshme të cilat udhëhiqen kundër gazetarëve, redaktorëve për këtë është shumë më i vogël.

[http://www.coe.int/t/e/human_rights/media/5_Documentary_Resources/1_Basic_Texts/4_Ministerial_Conferences/DH-MM\(2000\)004%20E%20European%20Conference.asp#P975_65057](http://www.coe.int/t/e/human_rights/media/5_Documentary_Resources/1_Basic_Texts/4_Ministerial_Conferences/DH-MM(2000)004%20E%20European%20Conference.asp#P975_65057)

3.2. Deklarata mbi parimet e procedimit të gazetarëve Federata ndërkombëtare e gazetarëve

Thuaja se në secilin vend janë aprovuar kodet etike të profesionit të gazetarisë. Në planin ndërkombëtar, gjithësesi se më e rëndësishmja është ***Deklarata mbi parimet e procedimit të gazetarëve e Federatës ndërkombëtare të gazetarëve*** të aprovuar në ***Seancën e dytë të Kongresit të federatës ndërkombëtare të gazetarëve***, në prill 1954, me amendamentet e aprovuara në Seancën e tetëmbdhjetë të Federatës ndërkombëtare të gazetarëve në qershor të vitit 1986.

Kjo deklaratë ndërkombëtare publikohet si standard i procedimit profesional të gazetarëve, punë e të cilëve është grumbullimi, transmetimi, përhapja dhe të komentimi i lajmeve dhe informacioneve dhe përshkrimin e ngjarjeve.

Obligimi i parë dhe më i rëndësishëm i gazetarëve është të ***respektojnë të vërtetën dhe të drejtën e opinionit që ta dijë të vërtetën.***

Duke e përmbushur këtë obligim, gazetari gjithmon do t'i mbroj parimet e grumbullimit dhe të publikimit të ndershëm dhe të lirë të lajmeve dhe të drejtën në koment dhe kritikë konkrete.

Gazetari do të informoj ***vetëm se në pajtim me faktet*** burimi i të cilit për të është i ditur.

Gazetari nuk do t'i fshehë informatat thelbësore e as t'i falsifikoj dokumentet.

Në grumbullimin e informacioneve, fotografive dhe dokumenteve, gazetari do të shfrytëzoj ***vetëm se mjetet e ndershme.***

Gazetari do të bëjë gjithë atë çka është e mundur për t'i ***përmirësuar informatat e publikuara*** për të cilën vërtetohet se për shkak të pasaktësisë mund ta çënoj dikë ose ta dëmtoj.

Gazetari do ***ta respektoj fshehtësinë profesionale*** dhe nuk do ta zbuloj burimin e informacionit i cili ka kërkuar ***të mbetet anonim.***

Gazetari duhet të jetë patjetër i ***vetëdijshëm nga diskriminimi të cilin***

mund ta përhapin mediat dhe do të bëjë gjithçka që ta shmang diskriminimin të bazuar, mes tjerash, në racë, gjini, orientim seksual, gjuhë, mendimin politik dhe mendimin tjetër, të prejardhjes nacionale dhe shoqërore.

Gazetari me *kundërvajtjen serioze* të rregullave profesionale do të konsideroj këto raste:

- *plagiatin;*
- *fyerjen, njollosje të nderit, shpifjes, akuzës së pabazuar,*
- *marrjes së mitos në çfardo formë që diçka të publikohet ose të pengohet publikimi.*

Gazetarët e denjë për këtë emër do ta konsiderojnë obligim të vetin se *besnikërishtë i përmbahen parimeve të përmendura*. Duke rrespektuar ligjet, gazetarët në atë që përkon me profesionin e tyre ta pranojnë vetëm se gjykimin e kolegëve të tyre, duke përjashtuar çfardo përzierje të pushtetit ose të kujtdo qoftë tjetër.

Siç mund të përfundohet, etika në media direkt është e lidhur edhe me të drejtën mediale dhe të drejtat dhe obligimet e gazetarëve në shoqërinë demokratike. Për këtë në pjesët në vazhdim, do ta vëmë theksin në ato standarde juridike të vendit dhe ndërkombëtare si dhe të standardeve etike të profesionit të gazetarisë të cilat duhet të sigurojnë mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të pakicave dhe t'i kontribuojnë kulturës së tolerancës veçmas në mjediset multinacionale dhe multietnike. Ata duhet t'i sigurojnë mediave lokale dhe gazetarëve »sjellje« të mirë veçmas në situatat e konflikteve dhe tensionimeve.

4. PARIMI I VËRTETËSISË DHE FUSHATËS MEDIALE

4.1.Parimi i vërtetësisë

Liria e informimit publik *përfshinë të drejtën në informim të vërtetë, me kohë dhe objektiv si dhe që publikishtë të kritikohen dhe t'iu kërkohet sqarime në raport ndaj veprimeve dhe akteve konkrete dhe të subjekteve të tjera publike.* Supozimi kryesor i lirisë së informimit publik është parimi i *vërtetësisë*.

Shkelja e parimeve të vërtetësisë nga ana e gazetarëve dhe mediave është shpesh edhe arsye e aktgjykimeve gjyqësore kundër mediave, redaktorëve dhe gazetarëve. Problem specifik me të cilat ballafaqohen vendet në tranzicion paraqet raportimi i mediave e cila mund të jetë e karakterizuar si thirrje për dhunë kundër personave apo grupeve, të cilat marrin karakter të *plasimit të qëllimshëm dhe në formë fushate të informacioneve të rrejshme, të paverifikuara dhe të pavërteta.* Në praktikën e Gjykatës europiane për të drejtat e njeriut ky »delikt« kryesishtë përmblihet në çështjen e ekzistimit të qëllimit që të *“nxitet” fushata e shpifjes (e pavërtetës).* Veçmas Gjykata europiane vlerëson, duke patur parasyshë kontekstin në të cilin zbatohet fushata dhe duke patur parasyshë pasojat që prodhon ndaj individit ose grupit ndaj të cilëve fushata është e drejtuar, duke treguar me atë rast edhe në shkallën më të vogël të mbrojtjes së bartësit të funksionit public (kur fushata të tilla udhëhiqen kundër tyre).

Sa i përket parimit të vërtetësisë, formulimi i alinesë së parë të nenit 51. të Kushtetutës së Republikës së Serbisë, me të cilin ëshë *rregulluar e drejta në informim* pashmangshëm na përkujton definicionin tashmë të dhënë më herët të së drejtës në informim publik:

»Secili ka të drejtë që të jetë i **informuar me vërtetësi, në plotësi dhe me kohë** mbi çështjet me rëndësi publike dhe se **mjetet e informimit publik janë të obliguara që këtë të drejtë ta rrespektojnë**«. Edhe në rastin e çështjes së përhapjes dhe të nxitjes së fushatave të rrejshme dhe të pavërteta, standardi juridik i përcaktuar me **Ligjin mbi informimin publik** qysh më parë është përmendur **obligimi i kujdesit gazetaresk**, i cili njëkohësisht është edhe rregull etik i profesionit të gazetarisë. Gazetari dhe redaktori përgjegjës të medias publike janë të obliguar që **para publikimit të informacionit i cili përmban të dhëna mbi ngjarjen, dukurinë ose personalitetin e caktuar, me kujdesin e duhur rrethor, ta verifikoj origjinën, vërtetësinë dhe plotësinë e sajë**.

Shkelja e **parimit të vërtetësisë**, shpesh shpie deri te pasojat juridike në dëm të gazetarëve të mediave publike, përkatësisht të themeluesve të mediave publike. Para së gjithash fjala është për **përgjegjësinë penale për shpifje** si vepër penale në njërin anë dhe kompensimin e dëmit material dhe jomaterial nga ana e gazetarit përkatësisht mediumit publik **për shkak të cënimit të nderit dhe reputacionit** nga ana tjetër. Mirëpo, e a.q. fushata e shpifjes, përkatësisht paraqitja dhe transmetimi i fakteve të rrejshme dhe të pavërteta, mund të jetë e orientuar edhe ndaj ndonjë **cilësie personale të individit përkatësisht të grupit të individëve**, madje mes tjerash edhe për shkak të përkatësisë nacionale ose fetare të personit të caktuar. Në atë rast, fushata e shpifjes mund të merr karakter të »gjuhës së urrejtjes« dhe »kriminalit nga urrejtja« dhe vija ndarëse mes kësaj është shumë e hollë.

4.2. Fyerja dhe shpifja në Serbi

4.2.1. Vështrim i përgjithshëm

Në sistemin juridik të Serbisë ekzistojnë disa forma të përgjegjësisë për **cënimin e reputacionit dhe të drejtës së të tjerëve**, përkatësisht e përkthyer në "gjuhën tonë juridike" **të cënimit të**

reputacionit dhe të *nderit të të tjerëve*, të cilët mund të jenë edhe bazë për përgjegjësi të gazetarit, si *përcjellësit të ideve, informatave* dhe *mendimeve*. Me këtë rast do të përmendim disa: *përgjegjsia penale* e formësuar në veprat penale të *fyerjes* dhe *shpifjes dhe të veprave të tjera penale nga korpusi i veprave penale kundër reputacionit dhe të nderit të të tjerëve si dhe sanksionit penalo-juridik* për ato vepra (dënim me burg ose me të holla); *përgjegjësia qytetare* e formësuar në *kompensimin e dëmit* sipas regjimeve të përgjithshme dhe të veçanta të përgjegjësishë dhe *përgjegjësia kundravajtëse përkatësishtë përgjegjësia për shkelje ekonomike*. Në vazhdim po flasim mbi përgjegjësinë penale dhe përgjegjësinë civilo-juridike për dëmin.

4.4.2. Përgjegjësia penale dhe sanksionimi penal për fyerje dhe shpifje (fyerja dhe shpifja si vepra penale)

Kur është fjala mbi *përgjegjësinë penale*, pas fushatës së fuqishme shumëvjeçare të shoqatave të gazetarëve, të organizatave joqeveritare dhe ndërkombëtare, me aprovimin e *Kodit të ri penal* i cili ka hyrë në fuqi 01. janar 2006, në Serbi është bërë *depenalizimi* (heqja e dënimit me burg) por jo edhe dekriminalizimi i plotë i shpifjes dhe i fyerjes si vepra penale. Kjo mund të konsiderohet *përparim i rëndësishëm* në legjislaturë i cili është realizuar në këtë fushë, me ç'rast e drejta jonë është bërë e përputhshme në *Onventën europiane për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut*. Megjithatë, figura e disa veprave të tjera penale, *edhe më tutje mund të jenë bazë për shqiptimin e dënimeve me burgim ndaj gazetarëve në ushtrimin e profesionit të tyre*, ndërsa me këtë veprat penale të fyerjes dhe të shpifjes edhe më tutje do të mbeten lëndë e padive të individëve të cilat do t'i shqyrtojnë gjykatat në procedurat penale. Në rast se gazetarit i shqiptohet dënimi me të holla për vepër penale të fyerjes dhe të shpifjes, ndërsa gazetari nuk e paguan gjobën në afatin ligjor, gjobitja në të holla *zëvendësohet me dënim me burg* e jo me dënimin e punës së dobishme shoqërore. Në këtë kuptim, *tërthorazi*, pasoja e aktgjykimit të gjykatës

për fyerje dhe shpifje edhe më tutje mund të jetë edhe dënimi me burg.

Fyerja si vepër penale është caktuar në Kodin penal në këtë mënyrë: *krysh fyen tjetrin*, do të ndëshkohet me dënim me të holla nga njëzet deri më njëqindë shumash ditore ose me dënim me të holla prej dyzet deri më dyqindmijë dinarë. Ligji njeh edhe formë të *kualifikuar (më të rëndë)* të veprës penale dhe ajo ekziston kur *vepra është kryer* përmes *shtypit, radios, televizionit ose të mjeteve të ngjajshme ose në tubime publike*. Me atë rast kryesi mund të jetë dënohet me dënim me të holla nga tetëdhjetë deri më dyqindë e dyzetë shumash të përmendura ditore ose me dënim në të holla nga njëqindë e pesëdhjetëmijë deri në katërqindë e pesëdhjetëmijë dinarë. Duhet që *posaçrishtë tërhequr vëmendjen* që *fyerja nuk është publikimi i fakteve të rrejshme përkatësisht të pavërteta* (dhe në këtë konteskt nuk do të duhej që direkt të shqyrtohet në kuadër të këtij parimi), por është *gjykim vlerësues negativ*. Në praktikën e gjykatës europiane, gjykimi vlerësues nuk mund të jetë lëndë e dëshimit, mirëpo gjykimi skajshmërisht negativ ka mundësi të jetë lëndë e kufizimeve të lirisë së shprehjes. Se a do të vie deri te kjo, para së gjithash varet nga të gjitha rrethanat e rastit.

Njëri prej rasteve karakteristike të cilin e ka zgjidhur Gjykata europiane rreth kësaj çështje është rasti *Oberschlick (nr.2) kundër Austrisë*. Zotëriu *Oberschlick* në vitin 1990 në revistën austriake *Forum*, redaktor i të cilës ai ishte në atë kohë, në tekstin e tij autorial e kishte quajtur kryetarin e atëhershëm partisë së lirisë në Austrisë *Jerg Hajderin "hajvan" (idiot)*. Kjo fyerje kishte pasuar reagimene redaktorit ndaj fjalimit të mbajtur me rastin e Ditës së paqes më 10 tetor 1990. Hajder në atë fjalim kishte glorifikuar rolin e "gjeneratës së ushtarakëve" e cila kishte marrë pjesë në Luftën e dytë botërore, me ç'rast kishte thënë se *të gjithë ushtarët, përfshirë edhe pjesëtarët e Vermahtit gjerman kanë luftuar për paqe dhe liri*. Pasi që gazetari në tekstin e tij, duke e quajtur Hajderin hajvan kishte "fyer" atë, pas së cilës Hajderi e kishte paditur për vepër penale të *fyerjes*. Me akgjykimin e shkallës së parë të Gjykatës së Vjenës e më pas edhe të

gjykatës regjionale të Austrisë nga viti 1991, *Oberschlick* u gjykua për *vepër penale të fyerjes*, me ç'rast gazetari ishte urdhëruar të paguante dënimi me të holla në shumë prej 1.000 shilinga austriak. Në *aktgjykimin* e saj me këtë rast, *Gjykata europiane* në vitin 1997 vërtetoi se aktgjykimi i Gjykatës austriake paraqet *përzierje të padrejtë të shtetit në lirinë e të shprehurit* dhe se fjala është mbi cënimin e nenit 10. të konventës europiane. Në arsyetimin e aktgjykimit të saj, Gjykata europiane vërtetoi se fjalimi i Hajderit, *ka pasur për qëllim të dukshëm që të jetë provokativ*, dhe me vet këtë që të shkaktoj reagime të rrepta. Edhe pse fjalët e gazetarit mund të konsiderohen polemizues (mendohet në fjalën „hajvan“), ato për këtë *nuk paraqesin sulm të paarsyeshëm personal*, meqenëse autori në teksin gazetaresk *ka dhënë sqarime* të cilat i ka bazuar në fjalimin e tij politik me objektivitet dhe me arsye, i cili vetvetiu ishte *provokativ*. Pa dyshim se t'i thuash hajvan një politikanin, kjo edhe mund ta fyej politikanin. Mirëpo, në këtë rast *nuk bëhet* se kjo fjalë është në shpërputhje në krahasim të *hidhërimit* që Hajderi me fjalimin e tij kishte *provokuar me vetëdije*. Gjykata europiane gjithashtu përkujtoi se neni 10 nuk i mbron vetëm se përmbajtjen e ideve dhe informacioneve të shprehura por edhe *formën* përmes të cilës ato janë shprehur. Kështu Gjykata europiane vërtetoi se përdorimi i fjalës „hajvan“ *është në përpjestim të drejtë me indignatën të cilën e ka shkaktuar me vetëdije fjalimi i politikanit, dhe se aktgjykimi i gjykatës së gjykatës nacionale është i paarsyeshëm* dhe paraqet *cënimin e lirisë së shprehjes*.⁸⁴

Për vepër penale të fyerjes në Serbi, *nuk do të dënohet kryesi* nëse ekspozea e tij është dhënë në kuadër të *kritikës serioze* në veprën shkencore, letrare ose artistike, *gjatë ushtrimit* të detyrës zyrtare, *të thirrjes së gazetarit*, të veprimtarisë politike, në mbrojtjen e ndonjë të

⁸⁴ *Oberschlick v. Austrija* nr. 2) aktgjykimi 1. korrik 1997, Zbornik 1997-IV 31; Aktgjykimi pjesërisht është publikuar në përmbledhjen: *Sudska praksa u vezi sa članom 10 Evropske konvencije o ljudskim pravima* (botim i dytë i plotësuar), Savet Evrope, Kancelarija u Beogradu, Beograd, 2006, fq. 15 ndërsa në tërësi mund të gjendet në faqen e internetit të Këshillit të Europës: www.coe.int

drejte dhe të mbrojtjes së interesave të arsyeshme, nëse nga mënyra e të shprehurit ose nga rrethanat e tjera shihet se kjo ***nuk është bërë me qëllim të nënçmimit***.⁸⁵ kjo është një bazë e rëndësishme të përjashtimit të përgjegjësisë për vepër penale të fyerjes gjë që është e rëndësishme edhe për gazetarët, mirëpo, shtrohet pyetja se a ka mundësi që ***nënçmimi*** të ketë karakter ***të kritikës serioze***, gjë e cila veçmas është shprehur në rastin e ***Bodrozhiq kundër Serbisë***.

Rasti më karakteristikë në lidhje me gjykimin e gazetarit për fyerje është ***rasti Bodrozhiq***.⁸⁶ Sa për krahasim, ky rast është në lidhje të ngushtë me aktgjykimin ***Oberschlich v. Austria*** për të cilin tashmë u folë. Në javoren lokale ***“Kikindske”***, më 11 janar 2002, është publikuar teksti me titull ***“Të lindur për reforma”*** në të cilin gazetari Zhelko Bodrozhiq përshkroi skenën politike e cila shënonte vitin e parë të tranzicionit në Kikindë. Duke shpjeguar se pas ndryshimeve demokratike në Serbi të viti 2000 nuk kishte ndryshuar asgjë me rëndësi, meqenëse në krye të pushtetit të ri demokratik kishin mbetur elita e politikanëve të vjetër, Bodrozhiq i indinjuar me ngjarjet në Kikindë, pati një vështrim kritik ndaj gjendjes së atëhershme në këtë qytet. Në mesin e kikindasve të tjerë të cilët i kishte “përmendur” në tekstin e tij autorial, Bodrozhiq si shembull të ngjarjeve në skenën e atëhershme politike në Kikind edhe anëtarine dikurshëm të Sekretariatit të Këshillit ekzekutiv të Partisë socialiste dhe drejtorin e fabrikës “Toza Markoviq”, D.Sh.

Vetëm se një ditë më vonë D.Sh në cilësinë e ***padiësit privat*** gjykatës komunale në Kikindë i kishte paraqitur ***padinë*** kundër Bodrozhiqit për vepra penale të fyerjes dhe shpifjes, meqenëse në tekstin mbi të paditësin kishte thënë: “... Pasi që milionat e Tozës shkuan në fushatën e PSS-JUL dhe në lojërat e ndryshme partiake, pasi

⁸⁵ Krahaso: *Krivični zakonik*, "Službeni glasnik RS", br. 85/2005, 88/2005, 107/2005, čl. 170.

⁸⁶ Vërejtja: përfaqësuesit ligjor të Zhelko Bodrozhiqit në gjithë procedurën ishin avokatët e YUCOM-it

që Slloba, para se ta “shqelmonin” në burgun e Hagës, e kishte rrahur “shoku im D.”, pasi që me Sheshelin kishte organizuar protesta për shkak të “futjes në qorkë” të shokut Sllobo, pas momenteve të kaluara në yje të cilat i kishte përjetuar në pjesëne parë të të vitit të kaluar (ishte bërë shef i Socialistëve në parlamentin federativ, anëtar i udhëheqjes më të ngushtë...) duke parë se më nuk ka “tërta-mërta”, vendosi që ta tregonte “gishtin e mesëm” edhe partisë së tij dhe të bëhet “zëdhënës i madh” i reformave të cilat po zbaton Qeveria e shokut, ops-zotëriut të kancelarit Gjigjiq...”.

Gjykatësi i Gjykatës komunale në Kikindë në aktgjykimin e tij e kishte shpallur fajtor Zhelko Bodrozhiqin për kryerjen e veprës penale të **fyerjes** dhe e gjobiti atë me denim në të holla. Gjykatësja vërtetoi se gjitha thekset të cilat Zhelko Bodrozhiq në tesktin e tij kritik I cili ishte lëndë e padisë private mbi drejtorin general të IMN “Toza Markoviq”, D.Sh. **të saktë dhe të pakontestueshme**, mirëpo se edhe **i gjithë teskti është fyes me që fjalët e përdorura e dëmtojnë reputacionin dhe nederin e paditësit Shegërt**. Shkurtimishtë: **edhe pse Zhelko Bodrozhiq në raportimin e tij gazetaresk mbi paditësinë nuk kishte paraqitur fakte të rrejshme, e as që kishte kryer vepër penale të shpifjes për të cilën është paditur**, sipas mendimit të gjykatësës **kishte bërë vepër penale të fyerjes ngase kishte përdorur zhargonin, e jo t ë folurit letrar I cili do të ishte I aplikueshëm për kritikë dhe kishte shfrytëzuar shenjat e interpunksionit të cilit iu ishin shtuar si rrethanë rënduesemeqë theksonin zhargonin të cilin e kishte shfrytëzuar gazetari**. Kështu që kishte ndodhur që **Zhelko Bodrozhiq të jetë gazetari I pare në historinë e gazetarisë serbe I cili duke raportuar të vërtetën do të gjykohej për atë se nuk e kishte shfrytëzuar gjuhën letrare sipas shijes së gjykatësit**. Në procedurën e ankimimit, aktgjykimin e kishte vërtetuar edhe Gjykata e Qarkut në Zrenjanin, me çka akgjykimi bëhet i formës së prerë në nëntor të vitit 2002. Disa javë më vonë, Bodrozhiq permes përfaqësuesve të tij ligjor paraqet kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë e cila mandej ishte refuzuar.

Pasi që ishin shterrur të gjitha mjetet efektive, përfaqësuesi ligjor I Bodrozhiqit si zgjidhje e vetme I kishte mbetur në atë moment (meqenëse atëbotë Serbia dhe Mali I Zi sa ishin bërë anëtare të këshillit të Europës por që ende nuk e kishin ratifikuar Konventën europiane), me *parashtrësë* I drejtohen *Komitetit të KB për të drejtat e njeriut* në bazë *Protokolit opcional të Paktit ndërkombëtar mbi të drejtat e qytetare dhe politike* me të cilën kishin kërkuar që Komiteti të përcaktoj se Serbia (atëherë Serbia dhe Mali I Zi) ka rrezikuar lirinë e shprehjes e cila është garantuar me nenin 19 të paktit ndërkombëtar mbi të drejtat qytetare dhe politike..⁸⁷

Komiteti i Kombeve të bashkuara për të drejtat e njeriut në seancën e 85 të mbajtur në tetor dhe nëntor të vitit 2005, me rastin e parashtrësës së Zhelko Bodrozhiqit kishte vërtetuar se *shteti i Serbisë (Serbia dhe mali i Zi) nuk kishte dhënë argumente të mjaftueshme për ndjekje penale dhe gjykimi për veprë penale të fyerjes si masë e domosdoshme për mbrojtje të të drejtës dhe reputacionit e z. Shegërtit, se në artikullin Zhelko Bodrozhiqit me rastin e shprehjes së mendimit të tij nuk ka ardhur deri prishja e paarsyeshme i të drejtave dhe reputacionit të z. Shegërtit, e në veçanti jo për aplikimin e sanksionit penal. Komiteti* posaçërishtë kishte konstatuar se *në kushtet të debateve publike në shoqërinë demokratike, e veçmas në media, të cilat përkojnë me personalitetet nga jeta politike, Pakti si vlerë të veçantë i kushton raportimit të papenguar. Nga kjo pason se gjykimi i autorit, paraqet shkelje të nenit 19. alinea 2. të paktit* (liria e mendimit dhe e shprehjes). Krahas kësaj Komiteti i urdhëron Serbisë që gazetarit Zhelko Bodrozhiq *t'i sigurojë mjet juridik efikas, gjë që nënkupton heqjen e gjykimit, restituimin e dënimit ndaj të cilës autori ka qenë i detyruar, kompensimin e shpenzimeve të gjykimit të cilat autori i ka paguar, dhe kompensim të drejtë për shkeljen e të drejtave të*

⁸⁷Mbi rregullat e procedimit para Komitetit të KB për të drejtat e njeriut më gjerësishtë: Dejan Milenković, *Zaštita ljudskih prava pred Komitetom za ljudska prava Ujedinjenih nacija*, Lex forum, Lawyers for Democracy, Beograd, br. 1-4/2006, 7-22.

përcaktuara me Paktin. Në pajtim me Protokolin opcional krahas këtij Pakti, shteti ishte obliguar që në afat prej 90 ditëve ta informoj Komitetin mbi masat të cilat i ka ndërmarr që këto qëdrime të zbatohen në vepër dhe që këto qëndrime të Komitetit t'i obligoj. Mirëpo, beteja e Bodrozhiqit, për shkaqe procedurale nga më të ndryshmet, të mungesës së mjetit adekuat juridik dhe për shkak të mosgatishmërisë së shtetit për t'ia paguar kompensimin adekuat zgjati edhe për disa vite me radhë.⁸⁸

Shpifja si ***vepër penale*** krahas formës themelore e ka edhe formën e kualifikuar. ***Shpifja*** është ***publikimi dhe transpenti i fakteve të pavërteta të cilat mund ta dëmtojnë nderin dhe reputacionin e dikujt.*** Kryesi i kësaj vepre penale mund të jetë i dënuar me të holla nga pesëdhjetë deri në dyqind shumash ditore ose me dënim në të holla nga njëqindëmijë deri në katërqindmijë dinarë. Dënimi me të holla është paraparë edhe kur vepra është kryer ***përmes shtypit, radios, televizionit ose të mjeteve të ngjajshme ose në tubimin publik.*** Nëse shpifja solli deri te pasojat e rënda për të dëmtuarin, kryesi do të gjobet me dënim me të holla nga njëqindënjëzetë deri më treqindëegjashtëdhjetë shumash ditore ose me dënim në të holla nga pesëqindmijë deri në milion dinarë.⁸⁹

Dhe deri sa sanksioni penal (para së gjithash dënimi me burg) në shoqërinë demokratike nuk konsiderohet masë e domosdoshme kur është fjala për lirinë e shprehjes,⁹⁰

⁸⁸ Mbi problemet me të cilat është ballafaquar gazetari Bodrozhiq pas paraqitjes së qëndrimit të Komitetit, më gjerësishtë: Milan Antonijević, *Postupak izvršenja odluka Komiteta za ljudska prava UN i nedostasci zakonodavstva Srbije*, Lex forum, Lawyers for Democracy, Beograd, br. 1-4/2006, 23-28; Milan Antonijević, *Velika pobeda koja ne može biti presedan*, Dosije o medijima, br. 24, april-jun 2008. fq. 4-9.

⁸⁹ Krahaso: *Krivični zakonik*, "Službeni glasnik RS", br. 85/2005, 88/2005, 107/2005, čl. 171.

⁹⁰ Krahaso: *Oberschlick v. Austrija* (br. 2) presuda od 1. jula 1997, Zbornik 1997-IV 31; *Dalban v. Rumunija*, br. 28114/95, CEDH 1999 VI, 28. septembar 1999; *Scharsach i News Werlagsgesellschaft v. Austrija* (br. 2). Br. 40284/98, novembar 2003; Aktgjykimi pjesërishtë është publikuar në përmbledhjen: *Sudska praksa u vezi*

Këshilli i Europës si dhe Gjykata europiane për të drejtat e njeriut mbajnë qëdrimin se *kompensimi i dëmit për cënimin e nderit dhe të reputacionit*, mundet (dhe është) masë adekuate, natyrishtë, në varësi nga *rrethanat e secilit rast konkret* dhe të *përmbushjes kumulative*, të kushteve të përmendura më herët. Mirëpo lidhur me *kompensimin e dëmit* për shkak të cënimit të nderit dhe reputacionit, në praktikën e Gjykatës europiane është kristalizuar qëdrimi se *gjykimi i kërkesave të larta zhëmtuese* për shkak të cënimit të nderit dhe të reputacionit, *nuk paraqet masë të domosdoshme* në shoqërinë demokratike.⁹¹

4.4.3. Përgjegjësia qytetare dhe kompensimi i dëmit për cënimin e nderit dhe të reputacionit. Fyerja qytetare dhe shpifja

Regjimi i përgjithshëm i kompensimit të dëmit material dhe jomaterial, në Serbi është përcaktuar me *Ligjin mbi raportet obligative*. Kur është fjala për kompensimin e dëmit material, sipas dispozitave të këtij ligji, ajo paraqiet në rast të *cënimit të nderit dhe të reputacionit të ndonjë personi* ose në rast të *përhapjes së fjalëve të pavërteta mbi ndonjë person*. Është me rëndësi të *theksohet*, që *Ligji mbi raportet obligative*, nuk i përdor nocionet *fyerje* dhe *shpifje*. Vetë norma ligjore është përcaktur ashtu, që në shikim të parë duket se cënimi i nderit dhe i reputacionit të ndonjë personi dhe publikimit dhe të transmetimit të fjalëve të pavërteta mbi ndonjë person janë dy gjëra të ndryshme. Mirëpo, në të dy rastet, bëhet fjalë për cënimin e nderit, me dallimin se në njërin rast kemi të bëjmë mbi cënimin ndërsa në rastin tjetër mbi shpifjen. Mirëpo, *gjuha arkaike* të cilën e shfrytëzon *Ligji*

sa članom 10 Evropske konvencije o ljudskim pravima (Botimi i dytë i plotësuar), Savet Evrope, Kancelarija u Beogradu, Beograd, 2006, fq. 15, 19, 27.

⁹¹ Krahaso: *Tolstoy Miloslavsky v. Ujedinjenog Kraljevstva*, presuda od 13. jula 1995, serija A br. 316-B. Aktgjykimi pjesërishtë është publikuar në përmbledhjen: *Sudska praksa u vezi sa članom 10 Evropske konvencije o ljudskim pravima* (drugo dopunjeno izdanje), Savet Evrope, Kancelarija u Beogradu, Beograd, 2006, fq. 14.

mbi raportet obligative nga viti 1978, në masë të rëndësishme i kontribuon konfuzionit, ndërsa fakti se nocionet e fyerjes dhe shpifjes në të drejtën penale janë më qartë të caktuara, e me vetë këtë edhe më “të afërta” me paditësit potencial, shpesh ata i **përcakton për inicimin e procedurës penale** për veprat e kryera penale. Cënimi i nderit mund të shkaktoj edhe paraqitjen e dëmit jomaterial, mes tjerash edhe për shkak të cënimit të nderit, gjë e cila gjithashtu është përcaktuar me **Ligjin mbi raportet obligative**. Gjithësesi se regjimi i përgjithshëm i cili ka të bëjë me cënimin e nderit dhe të reputacionit, duhet ndryshuar dhe përparuar, dhe se me caktimin më të qartë të nocionit të **fyerjes dhe të shpifjes “qytetare-juridike”** dukshëm do të zvogëlohej numri i procedurave penale për vepra penale të cënimit dhe shpifjes.⁹²

Mirëpo edhe kërkesat me vlera të larta për kompensimin e dëmit tashmë të gjykuara, sipas qëndrimit të Gjykatës europiane për të drejtat e njeriut nuk konsiderohen „masë të domosdoshme“ në shoqërinë demokratike. Kjo më së miri dëshmohet përmes rastit **Tolstoy Miloslavski & UK** para Gjykatës europiane për të drejtat e njeriut.

Një gazetar britanik, në tekstin e publikuar e kishte akuzuar drejtorin e një kolexhi britanik, lordin Aldington për krime lufte në Luftën e dytë botërore, meqë i kishte dorëzuar kozakët dhe pjesëtarët e forcave të armatosura të ish Mbretërisë Jugosllave, forcave ruse dhe partizanëve para përfundimit të luftës. Pjesa e madhe e tyre mandej është vrarë pa kurrfar gjykimi. Gazetari sipas ligjit britanik ishte gjykuar për cënim të nderit dhe të reputacionit (shpifje), dhe gjykata i shqiptoi kompensimin e dëmit prej 1,5 funtash britanike, gjë që deri më atëherë ishte shuma tre herë më e madhe e shqiptuar ndonjëherë për cënimin e nderit dhe të reputacionit (në praktikën e Gjykatës europiane dhe të Këshillit të Europës, gjykohet ashpër dënimi penal i gazetarëve për fyerje dhe shpifje, mirëpo Gjykata përkrah pagimin e kompensimit e dëmit të gazetarit dhe medias për shkak të cënimit të nderit dhe

⁹² Krahaso: *Zakon o obligacionim odnosima*, „Službeni list SFRJ“, br. 29/78, 39/85, 45/89, 57/89, Službeni list SRJ”, br. 31/93, čl 198-200.

reputacionit).

Në aktgjykimin e saj, Gjykata europiane mbajti qëndrimin se kompensimi »i tepruar« me të holla e shqiptuar për cënimin e nderit dhe të reputacionit në rastin konkret, nuk ka qenë e domosdoshme në shoqërinë demokratike përkatësishtë e domosdoshme për mbrojtjen e reputacionit të të drejtave të tjerëve dhe se aktgjykimet e tilla mundën vetëvetiu të paraqesin kufizim të tepruar të lirisë së shprehjes.

Shkelja e parimeve të *vërtetësisë* mund të jetë bazë për fushata penale dhe civile, mirëpo edhe mediale, të orientuara kundër ndonjë personi të caktuar ose grupi të personave ndaj ndonjë cilësi të tyre personale, mes tjerash dhe të përkatësisë nacionale ose prejardhjes etnike, mund të sjellë deri te »*gjuha e urrejtjes*« dhe *diskriminimi*, përkatësishtë cënimi i të drejtave të njeriut dhe pakicave.

4.5. Parimi i vërtetësisë si parim etik dhe fushatat mediale në konteskt të rolit të mediave në situatat konfliktuoze dhe tensionuese

Parimi i vërtetësisë është edhe njëri prej standardeve themelore etike të profesionit të gazetarisë. Deklarata mbi parimin e procedimit të gazetarëve të Federatës ndërkombëtare të gazetarëve, parasheh se ...«obligimi i parë dhe më i rëndësishëm i gazetarit është të rrespektoj *të vërtetën dhe të drejtën e opinionit që ta dijë të vërtetën*. Duke përmbushur këtë obligim gazetari gjithëmon do të mbroj parimin e lirisë për grumbullim dhe publikim të ndershëm të lajmit dhe të drejtën në komentimin korrekt«. Me kodeksin e gazetarëve gjerman të cilin e ka aprovuar Këshilli për shtyp është paraparë se »rrespektimi i të *vërtetës, mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe informimi objektiv* janë parimit më të larta të shtypit. Gjithashtu kodeksi parasheh se lajmet dhe fjalët e paverifikuara dhe supozimet si të tilla duhet të jenë të shenjuara.

Ngjajshëm është përcaktuar edhe me kodeksin etik në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe në vendet e tjera.

Parimi i *së vërtetës*, si rregull etik është përcaktuar edhe me *Kodeksin e gazetarëve të Serbisë* të cilin e kanë aprovuar shoqatat e gazetarëve në vitin 2006. Në këtë Kodeks e vërteta është përpunuar shumë detajisht nëpër gjithë pjesën e parë të Kodeksit i cili edhe e mban titullin *Vërtetësia e raportimit*. Në këtë pjesë mes tjerash edhe është paraparë se detyra themelore e gazetarit është që mbi ngjarjet me rëndësi për opinionin të raportoj me saktësi, objektivitet, në plotëni dhe me kohë, duke rrespektuar *të drejtën e opinionit për ta ditur të vërtetën...*

Parimi i së vërtetës, është shumëshpresor, ngase praktikishtë prëfshinë tri koncepte të ndërlidhura: *1) se informimi duhet patjetër të jetë i saktë; 2) se krahas saktësisë i domosdoshëm është edhe të kuptuarit dhe 3) se artikulli duhet të jetë patjetër i ndershëm dhe i baraspeshuar*. Në kuadër të *së vërtetës* si postulat i etikës së gazetarisë, shpesh në komunitetin gazetaresk shqyrtohen rastet e të a.q. *“etheve patriotike”* kur gazetarët, duke pranuar informacione në mënyrë jokritike të fituara nga funksionarët shtetëror dhe liderëve politikë, madje edhe prej “burimeve anonime” posaçrishtë në rastet e tragjedive nacionale, luftërave, sulmeve terroriste, sillen në mënyrë “jokritike” dhe me këtë tregojnë se nuk janë gjithnjë në gjendje të “barten” me problemin.

Problemi i »situatave kritike« kulmon dhe atëherë humbet kontrolli, në momentin kur edhe vet shikuesit, dëgjuesit ose lexuesit përkatësishtë »opinionit« fundoset në »patriotizëm«, gjë e cila vetëm sa i kontribuon vërshimit të thashëethënave dhe të fakteve të paverifikuara, me ç'rast gazetarët nuk kanë shembuj në të cilët do të mbështeten, ose ata »shembuj« në mënyrë jokritike vazhdojnë edhe më tej të nxisin rrëfimin mbi patriotizmin. Nën ndikimin e grupit të artikujve, deklaratave dhe raporteve, ose thënë më mirë »të fushatës« dhe »të marramendjes së përgjithshme« paraqiten gabime serioze gazetareske, të cilat duke u

përhapur në opinion krijonë gjendje »të histerisë nacionale« gjë e cila mund të shkaktoj dëmë shumë të madh kur raportohet mbi një dukuri ose ngjarje të caktuar ose kur informacioni ka të bëjë me një person të caktuar, të grupit të personave.

Në Amerikë si shembull i tillë shpesh theksohet fushata e »gazetarisë patriotike« pas sulmeve terroriste në New York më 11 shtator 2001, kur shumë pjesëtar të komuniteteve Arabe iu ishin nënshtruar diskriminimit dhe akuzave të pabazuara, mirëpo shpejtë reagueshan edhe gazetarët por edhe qeveritarët, ngase pasuan apelet e zyrtarëve të rëndësishëm për tolerancë dhe mirëkuptim me qëllim të »amortizimit« të dëmit të dukshëm që kishin shkaktuar gazetarët gjë të cilën këta të fundit edhe e pranuan. Me këtë problem, në veçanti duhet të jenë të njoftuar mediat lokale dhe gazetarët në mjediset multietnike, ngase ekziston rreziku i eskalimit të konflikteve, si pasojë e raportimit jo të saktë ose të paverifikuar.

Kur është fjala për fushatën mediale dhe parimin e së vërtetës, shkelja e këtij rregulli etik sipas rregullit janë të ndërlidhura me shkeljen e rregullave dhe standardeve të tjera etike, si p.sh. supozimit të pafajësisë ose të mosverifikimit të informacioneve të burimeve anonime dhe të përhapjesë së intolerancës kundër grupit të caktuar të njerëzve, grupeve të caktuara ose personaliteteve.

Ja një prej shembujve të tillë. Në një të përditshme, në vitin 2007, ishte publikuar teksti: «*Murgësja e masakruar*». Këtë informacion e kishin transmetuar edhe gazetaret dhe mediat e tjera elektronike. Në tekst fillimishtë si fakt paraqitet e dhëna se ...”murgësja e kishës pravosllave serbe.. në mënyrë brutale ishte vrasë në trenin që qarkullon në relacionin Selanik – Beograd, dhe “në bazë të insinuatës se kryesit e këtij krimi të tmerrshëm janë shqiptar nga Kosova. Më tutje në tekst, gazetari tregon se kjo informatë së pari u vërtetua nga dy burime në Patrikanën e Pejës (të cilët nuk e dinin identitetin e murgësjes) dhe se mandej informatata ishte demantuar, mirëpo kjo nuk e kishte penguar

gazetarin e kësaj të përditshmeje, që në vazhdim të tekstit, të spekuloj dhe të vazhdoj më tutje teorinë e vdekjes së murgeshës. Në këtë tekst mund të vërejmë një matricë të caktuar; publikimi i informacioneve të rrejshme me qëllim të shkakimit të urrejtjes dhe të tmerrimit së opinionit serb ndaj shqiptarëve të Kosovës e cila duhet të nxisë urrejtje dhe jotolerancë. Ky gjithësesi nuk është shembull i rolit dhe të rëndësisë së mediave në shoqërinë demokratike, veçmas në rastet e konflikteve dhe tensionimeve në mes të komuniteteve të ndryshme nacionale, posaçrishtë në mjediset lokale.

Për këtë arsye gazetari para publikimit të kësaj informate, duhet të veproj me kujdes që i përgjigjet rrethanave. Meqë informatat e tilla mund të shpiejnë në konflikte dhe tensionim, duhet shqyrtuar se a duhet publikuar kjo informatë kur është «plasuar» nga ana e burimit anonim (mbi të cilën më shumë do të flitet në kapitullin e radhës) para se ajo të verifikohet nga dy burime të njohura. Shkelja e parimit të vërtetësisë në këtë rast konkret mund të sjellë deri te një mori pasojash të padëshiruara në mjediset multietnike dhe të krijimit të tensionimeve të panevojshme në mes të popullatës shumicë dhe pakicë.

Shmebulli i dytë, mbase më mirë e dëshmon ndërlíkueshmërinë e parimit të së vërtetës. Në Preshevë në vitin 2006 ishte publikuar informacioni mbi bombën e vënë në oborrin e xhamisë e cila gjendet mu në qendër të qytetit por edhe në afërsi të drejtëpëdrejtë të stacionit të autobusave. Gati të gjitha mediat në Serbi e kishin marrë këtë lajm nga mediat lokale në Preshevë që shkaktoi një tensionim dhe panik të panevojshme. Çfarë dëshmoi hetuesia? As që bëhej fjalë për bombë, porse disa nxënës duke u kthyer nga një shkollë e afërme kishte hedhur disa mjete piroteknike. Nxënësit ishin të përkatësisë shqiptare dhe nuk e kishin pasur për qëllim të shkaktojnë kurrfarë incidenti. Këtë e kishin bërë sa për t'u argëtuar duke mos meduar se me këtë mund t'i shqetësojnë shumë besimtarë. Bomba që përmendej nuk u gjet kurrë, mirëpo dëmi me këtë rast gjithësesi ishte shkakuar. Pra, ajo që ka ndodhur ka qenë eksplozimi dhe kjo është ajo që ka qenë e saktë (e

vërtetë). Mirëpo, insinuata se bëhet fjalë për bombë, nuk ka qenë as e arsyeshme e as e saktë. Duket se mediat në këtë komunë nuk kanë treguar kujdes të duhur as edhe të kuptuarit e kësaj ngjarje në kontekst të të gjitha rrethanave në këtë komunë, sa që edhe vet raportimi nuk ka qenë i baraspeshuar.

5. MBROJTJA E BURIMIT ANONIM DHE TRANSMETIMI I I INFORMACIONEVE ME BURIM ANONIM

5.1. Vështrim i përgjithshëm

Për dallim nga standardi – parimi i mëparshëm ai i vërtetësisë, te i cili standardi etik dhe juridik «konvalidojnë», kjo nuk ndodhë te mbrojtja e burimit anonim dhe te transmetimi i informacioneve me burim anonim. Standardi juridik ekskluzivishtë lidhet për mbrojtjen e burimit anonim, ndërsa ai etik, me publikimin e informacionit të cilin e «zbulon» burimi anonim. Në Serbi, standardi juridik dhe etik lidhur me burimin anonim «nërthurret» vetëm se përmes obligimit të përgjithshëm të kujdesit gazetaresk (si standard juridik dhe etik). Në këtë Doracak, ky standard është sqaruar para së gjithash me qëllim gazetarëve dhe njerëzve të medias në mediumet lokale, veçmas në mjediset multietnike dhe në kushtet e konfliktit dhe të tensioneve, të mund ta kuptojnë «rrezikun» që pason nga publikimi i informacioneve të cilat rrjedhin nga burime anonime.

5.2. Standardi juridik i mbrojtjes së burimit anonim në dokumentet ndërkombëtare dhe në dhe në Serbi

Dokumentet më të rëndësishme lidhur me mbrojtjen e burimit anonim është Rekomandimi i Komitetit të ministrave të Këshillit të Europës nr. 7. (2000) me të drejtat e gazetarëve që mos t'i zbulojnë burimet e veta të informacionit. Theksi në këtë Rekomandim është vënë në kërkesat për mbrojtje adekuate të gazetarëve për t'i mos i zbuluar burimet e informacionit ashtu që të ruhet liria e gazetarit dhe e drejta e opinionit që të jetë i informuar përmes mediave. Mbrojtja e raportit profesional të gazetarëve dhe të burimeve të tyre në këtë pikëpamje ka rëndësi më të madhe nga vlera reale e atyre informacioneve e për opinionin. Mirëpo edhe ky Rekomandim, jep mundësinë, por vetëm se me përjashtime të caktuara, që organet e pushtetit publik të kërkojnë nga gazetari ta zbulojë burimin e informacionit. Kjo ndodhë në rast se

ekziston *një interes dukshëm më i lartë publik* dhe kur rrethanat kanë karakter qenësor dhe serioz, dhe se zbulimi mund të konsiderohet i domosdoshëm në shoqërinë demokratike. Me Rekomandim janë përcaktuar edhe *kriteret* të cilat mund të jenë të rëndësishme për vlerësimin e asaj *domosdoshmërie*.

Në Serbi, *Ligji mbi informimin publik të Serbisë* (2003), gjithashtu e parashehë mundësinë kur gazetari është i obliguar ta zbuloj burimin e informacionit: *Gazetari nuk është i obliguar t'i zbuloj të dhënat lidhur me burimin e informacionit, përveç nëse të dhënat kanë të bëjnë me veprën penale, përkatësisht kryesin e veprës penale për të cilën parashihet dënimi me së paku 5 vjet burgim*«.

Për shfrytëzimin e informacioneve nga burimet anonime, gjithashtu është i rëndësishëm edhe neni 3. - tashmë i përmendur në më shumë raste – *i Ligjit mbi informimin publik*, me të cilin në form të normës juridike është formuluar rregulla: *»Gazetari dhe redaktori përgjegjës i medias publike janë të obliguar që para publikimit të informacionit e cila përmban të dhëna mbi një ngjarje të caktuar, dukuri ose personalitet, që me kujdesin përgjegjës ndaj rrethanave ta verifikojnë origjinën e saj, vërtetësinë dhe plotësinë*«.

Gjithashtu duhet thesuar edhe dispozitat e *Kodit penal* (neni 38-41), përkatësisht dispozitat e veçanta mbi *veprat penale të kryera përmes shtypit dhe mjeteve të tjera të informimit publik*. Në këtë pjesë të Kodit penal flitet mbi përgjegjësinë e *redaktorit, botuesit, shtypësit dhe prodhuesit* për vepra penale të kryera përmes shtypit dhe mjeteve të tjera të informimit publik, me të cilin është e rregulluar edhe *mbrojtja e burimit të informacionit*. Personat e përmendur nuk do të konsiderohen kryes të veprës penale për shkak se gjykatës ose organit tjetër kompetent nuk ia kanë zbuluar identitetin e autorit të informacionit ose të burimit të informacionit, përveç në rast se është kryer vepër penale për të cilën parashihet masa më e vogël e dënimit burgim në kohëzgjatje nga pesë e më tepër vite, ose që kjo është e domosdoshme ashtu që

kryerja e një vepre të tilla penale të parandalohet.

5.3. Transmetimi i informacioneve të burimit anonim si parim etik

Mbrojtja e burimit anonim gjithësesi është njëra nga regullat më të rëndësishme etike në gazetari. Për këtë ajo është përmbajtur në kodekset etike të profesionit të gazetarisë në shumicën e vendeve. Mirëpo, kodekset etike të shumë vendeve në raste të shpeshta nuk e përmbajnë vetëm *se formulimin mbi mbrojtjen e burimit anonim*, por edhe nevojën *analizës kritike të informacioneve* që rrjedhin nga burimet anonime.

Përndryshe, burimet anonime, gjithkund, e veçmas në vendet në tranzicion, shpesh e shfrytëzojnë pozitën e tyre të »privilegjuar« duke përhapur dhe ndërfutur informacione të rrejshme duke bërë kështu ndikim të rëndësishëm (dhe të gabueshëm) në opinion, lidhur me dukuritë ngjarjet dhe personalitetet e caktuara,. Shpesh burimet anonime janë persona nga kreu i qeverisjes, partive politike, të elitave ekonomike madje edhe të shërbimeve sekrete, të cilët »me lëshimin« e balonave provues dhe të informacioneve të rrejshme formësojnë opinionin publik dhe krijojnë klimë shoqërore dhe një »realitet virtual« i cili është më së pari dhe vetëm në interes të tyre.

Për këtë në gazetarinë profesionale, ekzistojnë edhe rezerva rreth publikimit të informacioneve të cilat vijnë nga burimet anonime. Ekzistojnë disa prej arsyeve kryesore për këtë, ndërsa më të rëndësishmit janë - siç thamë edhe më herët –veprimi i burimit anonim të shkaktuar nga motive *që shpesh nuk janë as të moralshme e as të ndershme*. Disa nga burimet anonime dëshirojnë të ndikojnë në opinionin publik ashtu që gazetarëve i dërgojnë informacionin në këmbim të besueshmërisë dhe se të tillët shumë shpesh përshkruhen si »njerëz në pozita të larta« ose »mirë të informuar«. Të tjerët paraqiten nga interesi personal siç janë urrejtja dhe hakmarrja. Në raste të

caktuara burimi anonim e shfrytëzon »*besueshmërinë*« si »*mburojë*« për ta sulmuar palën e tretë e cila nuk mund të mbrohet nga sulmuesi i panjohur, duke dërguar në këtë mënyrë qëndrime dhe pikëpamje të cilat nuk do t'i dërgonin kur emri i tyre do të publikohej.

Në *Deklaratën* mbi parimet e veprimit të gazetarëve të *Federatës ndërkombëtare të gazetarëve*, është përcaktuar se *gazetari do ta rrespektoj sekretin profesional dhe nuk do ta zbuloj burimin e informacionit i cili ka dëshiruar të mbetet anonim (parimi 5).*

Ky është njëri nga shkaqet, për shkak të të cilit edhe shoqatat dhe asociacionet e tjera të rëndësishme ndërkombëtare siç është rasti me *International Centre for Journalists*, kanë marrë qëndrimin që me qëllim të saktësisë dhe vërtetësisë së informacionit si postulate themelore të së drejtës në informim, mediat, redaktorët dhe gazetarët, kur është fjala për informacionet të cilat rrjedhin nga burimet anonime duhet të udhëheqin politikën e *mospublikimit të informacioneve kundërthënëse*, përveç në rastet kur ato *janë të vërtetuara nga së paku dy burime të pavarura të informacionit.*

Me Kodeksin e gazetarëve të Bosnjës dhe Hercegovinës është përcaktuar se gazetarët, *kurdo që kjo është e mundur duhet të mbështeten në burime të hapura dhe të identifikuar të informacionit.* Burimet e tilla duhet të jenë *epuror të burimeve anonime, nderin dhe saktësinë e të cilëve opinioni nuk mund ta vlerësoj* (neni 13.).

Kodeksi danez, parasheh se ndaj burimit të lajmit duhet patur raport kritik, posaçërishtë kur deklaratat e dhëna mund të jenë të *ngjyrosura me interesa personale dhe në prapavi kanë qëllime të tjera të panjohura.*

Në *Serbi*, me Kodeksin etik është paraparë se gazetari është i obliguar që ta rrespektoj kërkesën e burimit të informacionit për anonimitet. Mirëpo, Kodeksi parasheh se *trillimi i burimeve anonime është shkelje e rëndë* e rregullave të profesionit të gazetarisë. Me

kërkesë të redaktorit, gazetari është i obliguar që t'ia komunikoj identitetin e burimit i cili dëshiron të mbetet anonim, ndërsa redaktori është i obliguar ta mbroj anonimitetin e burimit.

Rasti Arkansas & Democrat-Gazette në ShBA

Kështu prej rastit *Arkansas & Democrat-Gazette në ShBA* gazeta në fjalë ka pësuar dëmë shumë të madhë ngase para publikimit, nuk e kishte verifikuar vërtetësinë e informacionit të lëshuar nga burimi i paidentifikuar. Menjëherë pas publikimit doli që informacioni kishte qenë i rrejshëm, ndërsa lexuesit e kësaj gazete, pas kësaj ngjarje humbën besimin dhe më nuk e blenin atë.⁹³

Sjellja e tillë e mediave, redaktorëve dhe e gazetarëve, del nga parimi i dytë i rëndësishëm i profesionit të gazetarisë – ***parimi i kujdesit gazetaresk. Obligimi i kujdesit gazetaresk***, në Serbi jo vetëm se paraqet ***rregull etike por edhe ligjore***. Në të vërtetë në nenin 3. të ***Ligjit mbi informimin publik***, në formë të normës juridike është formuluar rregulli:

“Gazetari dhe redaktori kryesor i medias publike janë të obliguar që para publikimit të informacionit i cili përmban të dhëna mbi ngjarjen, dukurinë ose personalitetin e caktuar, janë të obliguar që me kujdesin që i përgjigjet rrethanave ta verifikojnë prejardhjen, vërtetësinë dhe plotësinë e saj.”

Pikërishtë ky kujdes që i përgjigjet rrethanave, në rast të marrjes së informacionit nga burimi i paidentifikuar, është në të vërtetë verifikimi paraprak i informacionit nga më së paku dy burime (të pavarura) që janë të njohura.

⁹³ Krahaso: *Kopaj duboko & ciljaj visoko – Deset koraka u istraživačkom novinarstvu*, Lucinda S. Fleeson, Copyright 2000, International Centre for Journalists, Washington, DC, USA, fq. 9

Edhe pse implementimi i këtij standardi në këtë dhe në rastet e tjera nuk »garanton« se megjithatë në mjetet e informimit publik, edhe pse më rrallë, nuk do të paraqitet informacion i rrejshëm përkatësishtë i pavërtetë, mirëpo është fakt se ekziston një kufi objektiv deri te i cili gazetarët përkatësishtë redaktorët kryesor duhet dhe nevojitet patjetër të shkojnë para publikimit të informacionit të caktuar. Natyrishtë se as gazetari dhe as redaktori nuk mundën që para publikimit ta verifikojnë vërtetësinë e një informacioni të caktuar në mënyrën në të cilën këtë e bënë gjykata, mirëpo kanë mundësi që me kujdesin konform rrethanave ta verifikojnë **prejardhjen, vërtetësinë dhe plotësinë e tij**, në veçanti kur informacioni »vie« nga burimi anonim.

Me verifikimin e informacioneve të tilla te burimet e njohura, verifikohen motivet e burimit anonim nga njëra anë dhe saktësia e informacionit në anën tjetër, me çka përmbushet edhe postulati themelor etik i gazetarisë – **parimi i kujdesit gazetaresk**.

Afera Votergejt - Vashington Post

Gazetarët e Vashington post-it të cilët kishin zbuluar aferën Votergejt, vetëm pas 30 vitesh më vonë, në maj të vitit 2005, vërtetuan se Mark Felt, ish zëvendës drejtori i Biros amerikane të hetimit (FBI) me të vërtetë kishte qenë **burimi sekret** i informacionit i cili shkaktoi dorëheqjen e kryetarit të ShBA-ve Riçard Niksonit në vitin 1974. Identitetin e Feltit si burim e kishte konfirmuar edhe ish redaktori i tyre Bexhamin Bredlli, i cili ishte **i vetmi krahas gazetarëve të vet** e kishte ditur se kush është burimi. Edhe vet Mark Felt, i cili në vitin 2005 në moshën e tij 91 vjeçare kur jetonte në Santa Rosi në Kaliforni, në magazinën Veneti Fer e pranoi se ishte personalishtë ai »zgavra e thellë« e burimit të informacioneve që iu kishte dhënë gazetarëve sekretet lidhur me operacionin Votergejt në gjysmën e parë të viteve 70-ta të shekullit të kaluar.

Identiteti i personit të vërtetë i cili ua kishte dorëzuar

informacionet më kryesore gazetarëve Bobi Vudvordu, sot redaktorit kryesor të kësaj gazete dhe Karlla Brestinës, për tri dekada ishte njëra prej sekreteve të pazgjidhura. Identiteti i njërit prej burimeve më të famshme anonime në historinë e gazetarisë ishte njëherit edhe njëri prej informacioneve më së miri të ruajtura në mesin e gazetarëve. Burimi gazetaresk i emërtuar si Zgavra e thellë, ishte emërtuar sipas një porno-filmi të njohur të asaj kohe. Në stilin e trilerit të spiunazhit, ai iu kishte ndihmuar Vudvordit dhe Bernstinit ashtu që ju jepte udhërrëfyes edhe paralajmërues të shkurtër mbi detajet e operacionit të përgjimit që ushtrohej nga ana e partisë republikane të Niksonit.

Paralajmërimi i tillë më i njohur ishte ...«paso gjurmët e parave» - përkatësishtë sugjerimi i cili kishte çuar deri te zbulimi i lidhjeve të personit që futej fshehurazi në ndërtesën Votergejt, në selinë e partisë demokratike, rivale të republikanëve dhe të donacioneve të Republikanëve.

Me dekada është spekuluar se cili ishte burimi sekret gazetaresk, mirëpo gjithnjë deri në vitin 2005 askush nuk është prezentuar si burim anonim në këtë aferë. Mark Felt atëbotë ishte në FBI i dyti për nga rangu, ndërsa kishte folur vetëm atëherë kur familja e tij kishte kërkuar të tregonte se çfarë kishte për të thënë mbi vlerësimet historike të asaj çka kishte punuar. Nipi i tij – Nik Xhoni, me këtë rast kishte deklaruar se gjyshi i tij M. Felt një hero i madh amerikan i cili kishte shkelur shumë lartë mbi kërkesat zyrtare të pozitës së tij të atëhershme, iu ishte nënshtruar rreziqeve për të shpëtuar vendin e tij nga një padrejtësi e tmerrshme.

5.4. Parimi i transmetimit të informacionit nga burimet anonime si dhe parimi etik në kontekst të rolit të mediave në situatat e konflikteve dhe tensioneve.

Mjerishtë në procesin e tranzicionit të mediave në Serbi, shpesh jemi dëshmitarë kur mediat transmetojnë informacione nga të a.q.

“burime të paidentifikuara”, pa kurrfar verifikimi nga ana e gazetarëve dhe redaktorëve dhe pa kurrfar mbështetje në burime të tjera të pavarura dhe të njohura, me ç’rast, shpesh publikojnë informacione të cilat më shumë kanë karakter të informacioneve të cilat futen, nëpër media për arsye dhe nevoja të ndryshme, nga qendra të ndryshme të ndikimit, se sa që janë burim i vërtetë i informacionit. Nëse problemin me të a.q. “burime të paidentifikuara” e vendosim në kontesktin e legjislaturës së brendshme ose të standardeve ndërkombëtare, do të vërejmë se në mediat serbe shpesh publikohen informacione të cilat nuk janë të verifikuara nga ana e burimeve anonime, gjë e cila veçmas ka të bëjë me të a.q. “informacione” të cilat plasohen nga burime anonime, dhe se informacionet e plasura në këtë mënyrë sipas rregullit radhiten në rrethin e informacioneve me rastin e të cilave nga gazetari, sikur sipas standardeve vendore por edhe të atyre ndërkombëtare, mund të kërkohet zbulimi i burimit të informacionit. Në pjesën e parë të vitit 2007 për shembull, të rëndësishme konsideroheshin **grupi i informacioneve të cilat dilnin nga burime të paidentifikuara** e të cilat përkonin me çështjen e statutit të Kosovës dhe të raportit ndaj shqiptarëve të Kosovës. Sa i përket Kosovës, informacionet nga burime të paidentifikuara (të cilat natyrishtë nuk janë verifikuar) nuk i përkisnin vetëm çështjeve të cilat kanë të bëjnë vetëm se me *statusin e Kosovës* por përgjithësishtë me raportin ndaj shqiptarëve të Kosovës, e të cilat mund të kenë edhe pasoja shumë të mëdha nëpër mjediset multinacionale ku shumicën e përbën njëri apo kombi tjetër.

Kështu burimi i paidentifikuar i Kuririt, para disa vitesh, në artikullin **“Hitleri jeton në Kosovë”**, i cili siç thuhet, ishte një gazetar amerikan (!?) thoshte se në një fshat të vogël në Kosovë jeton dhe punon pronari i një kafeneje i cili për nga pamja është i ngjajshëm me Hitlerin, si dhe ajo kafene është e rregulluar si në stilin e viteve të 40-ta, ndërsa aty përshëndeten me **“Hajl Hitler”** dhe se flasin mbi atë se “duhet vrarë të gjithë serbët”. Tendencioziteti i këtij teksti është i dukshëm, gjithashtu edhe asocijimi, ndërsa qëllimi është i qartë: nxitja e mosdurimit nacional të serbëve ndaj shqiptarëve

Në një tjetër të përditshmeje, përafërsisht në të njëjtën kohë, gazetari në tekstin **“Deri te qëllimi edhe me dhunë të re”** flitet mbi “lidhjen e thellë” të Albin Kurtit –lider i lëvizjes kosovare “Vetëvendosje” dhe të shqiptarëve ekstremist, të cilët, sipas **asaj që thotë bashkëbiseduesi i mirëinformuar** nga Qendra bashkërenduese për Kosovë, udhëhiqen nga Ramush Haradinaj. As në këtë rast nuk ka asnjë shenjë të tentimit të gazetarit që para publikimit këtë informacion ta verifikoj nga së paku dy burime të njohura, nga Qendra bashkërenduese ose nga Qeveria e Serbisë që është themeluese e Qendrës, gjë e cile e sjell në dyshim tendenciozitetin e informacionit të transmetuar.

Vërehet se në këtom raste, kur është fjala për informacionet e „plasura“ nga „burime anonime“ e kemi shkelje të ndërlidhur edhe të standardeve të tjera të etikës profesionale me çka paraqitet kjo matricë: **përhapja e informacioneve të pavërteta dhe të paverifikuara përmes burimeve të paidentifikuara, e të cilat sjellin deri te fushata negative ndaj shqiptarëve të Kosovës gjë e cila krijon urrejtje dhe intolerancë**, me qëllim të krijimit të opinionit publik ndaj shqiptarëve të Kosovës përgjithsishtë, gjë e cila mund të shkaktoj pasoja të rënda ndaj jetës së përbashkët të serbve dhe shqiptarëve, veçmas në jug të Serbisë.

6. NDALIMI I GJUHËS SË URREJTJES SI STANDARD JURIDIK DHE ETIK

6.1. Nocioni “gjuha e urrejtjes”

“Gjuha e urrejtjes” në kuptimin më të gjerë mund të definohet si *shprehje e cila përmban porosi të urrejtjes apo të mosdurimit ndaj grupit racor, nacional, etnik apo fetar apo pjesëtarëve të tyre*. Kohët e fundit, gjuha e urrejtjes përfshinë edhe fjalimin i cili është drejtuar në prodhimin e urrejtjes dhe të mosdurimit *ndaj gjinisë dhe orientimit seksual*, ndërsa gjithënjë e më shpesh ky nocion përfshinë edhe *mosdurimin ndaj mendimit politik ndryshe dhe mendimit tjetër si dhe prejardhjes nacionale dhe shoqërore*.

Kanosja esenciale ndaj shprehjes së mendimeve me elementet e gjuhës së urrejtjes qëndron në porosinë e cila me këso shprehje i dërgohet qytetarëve, dhe ka për qëllim të shkaktojë pasoja negative për personin e caktuar respektivisht për grupin e personave varësisht nga *vetia e tyre personale apo përkatësisë ndaj grupit të caktuar* që mund të manifestohet përmes:

- Krijimit të urrejtjes ndaj personit të caktuar apo grupit;
- Krijimit të stereotipit negativ ndaj personit të caktuar apo grupit;
- Nxitjes së diskriminimit dhe armiqësisë;
- Dënimit të rrethit ndaj personit të caktuar apo grupit;
- Shkaktimit të ndjenjës së pasigurisë dhe frikës te personi i caktuar/ apo pjesëtari i caktuar i grupit;
- Shkaktimit të dhembjeve fizike dhe psikike personit të caktuar respektivisht pjesëtarit të grupit;
- Kanosjes së personit të caktuar respektivisht grupit;
- Krijimit të ndjenjës tek numri i madh i qytetarëve se një sjellje e tillë ndaj një personi të caktuar/grupi shoqërisht është e dëshirueshme dhe e arsyeshme;
- Shkaktimit të ndjenjës tek një rreth i gjer i qytetarëve se një sjellje do të tolerohet, dhe nuk do të jetë objekt e përgjegjësisë.

Gjuha e urrejtjes, treguan edhe luftërat në hapësirat e ish

Jugosllavisë, është mjet i fuqishëm për të nxitur linçin, diskriminimin, dhunën, armiqësinë dhe sjelljen mizore, krimet e luftës dhe të arriturat tjera anticivilizuese dhe stereotipet të cilët janë bazë e veprës penale **krim nga urrejtja**, për të cilën më vonë do të bëhet fjalë.

Vetia personale e personit të caktuar respektivisht **përkatësisë së grupit të caktuar të ndjeshëm** është e rëndësishme jetike për përkufizimin apo specifikimin e vetisë së grupit të rrezikuar. Këto veti personale janë: 1) raca; 2) përkatësia nacionale apo etnike; 3) besimi fetar; 4) gjuha; 5) gjinia; 6) orientimi seksual; 7) bindja politike apo bindja tjetër; 8) prejardhja shoqërore; 9) vetitë tjera personale.

Njëra nga detyrat më të rëndësishme me rastin e vërtetimit të **metodologjisë së njohjes së gjuhës së urrejtjes** është sigurisht zbulimi i procesit të **dehumanizimit** me të cilën viktimat e gjuhës së urrejtjes janë ekspozuar. Dehumanizimi paraqet proces i cili duhet të bie deri te ajo që personi i cili paraprakisht është liruar nga statusi i tij njerëzor mos të shkaktoj kurrfarë ndjenje të përgjegjësisë morale për dëmin i cili i shkaktohet atij. Në këto persona të dehumanizuar nuk aplikohen principet e zakonshme të veprimit moral. Nëse grupi i njerëzve vrojtohet në tërësi vetëm në kuptimin e kategorisë të cilës i takojnë (grupet e ndryshme të marginalizuara), kufizimet morale kundër dhunës ndaj këtij grupi lehtë mospërfillen. Dehumanizimi i armikut ekziston në çdo luftë, por edhe në të gjitha shoqëritë e pazhvilluara sepse në ato shoqëri ekziston dehumanizimi i kategorive të caktuara i njerëzve të cilët janë të stigmatizuar dhe të marginalizuar. Ato janë grupe viktime të cilat formohen në opinionin publik në bazë të paragjykimëve dhe të stereotipeve.

Rreziku kyç i cili rezulton nga “gjuha e urrejtjes” është gjithsesi në atë se mund të sjell deri te ashtuquajtura “krim nga urrejtja”.

“Krimi nga urrejtja” më së shpeshti caktohet si **çdo vepër penale e kryer nga urrejtja ndaj ndonjë personi apo grupi të personave për shkak të racës, ngjyrës së lëkurës, gjinisë, orientimit seksual, gjuhës, besimit fetar, bindjes politike apo të bindjes tjetër, prejardhjes nacionale apo sociale, pasurisë, lindjes, arsimimit, pozitës shoqërore, moshës, gjendjes shëndetësore dhe vetive tjera.**

Prandaj, karakteristikë kryesore e krimit nga urrejtja është *motivi* që ndonjë vepër penale të *kryhet nga urrejtja* për shkak të disa vetive të viktimës. Në shumë vende, është vërejtur se rrallë dënohet për forma të ndryshme të sjelljes së dhunshme të motivuara për arsye të vetive respektivisht për shkak të përkatësisë grupit nga ana e personit të caktuar. Për këtë krimi nga urrejtja konsiderohet element kualifikues i të gjitha krimeve.

Ajo para së gjithash manifestohet përmes shkaktimit të dhimbjeve fizike dhe psikike dhe vuajtjeve ndaj personit të caktuar për shkak të përkatësisë së tij grupit të rrezikuar, provokimit dhe dhunës ndaj personit të caktuar apo grupit (rrahjet, lëndimet, kanosjet, vrasjet ndaj individëve të grupit të rrezikuar për shkak të vetive të tyre personale); shkaktimi i mosdurimit nacional, racor dhe fetar bie deri te gjenocidi dhe krimet e luftës dhe veprave të ngjashme e të cilat janë të motivuara nga urrejtja sipas vetive personale të pjesëtarit të grupit të caktuar. Në këtë pikëpamje, dokumentet ndërkombëtare të cilat i referohen gjuhës së urrejtjes, në vete *sublimojnë* edhe krimet *nga urrejtja*. Ai është krim *motivimi i të cilit është i lidhur me vetinë e personit të caktuar respektivisht grupit*. Në këtë pikëpamje, gjuha e urrejtjes dhe krimi nga urrejtja më së shpeshti janë të *lidhura pandashmërisht* dhe ndërmjet tyre ekziston lidhja shkak – pasojë.

6.2. Gjuha e urrejtjes dhe qëndrimi politik, ideologjik dhe kritik

Gjuha e urrejtjes shpesh përzihet me qëndrimin apo mendimin ideologjik dhe politik. Për këtë arsye qëndrimi ideologjik dhe politik shpallet si gjuhë e urrejtjes edhe kur ai nuk ekziston. *Qëndrimi i ndryshëm ideologjik dhe politik* në shoqërinë demokratike është njëri nga postulatet themelore të demokracisë *me kusht që ai qëndrim të mos nënkuptojë diskriminimin dhe thirrjen për dhunë për shkak të vetive të caktuara të personalitetit apo të përkatësisë grupit të caktuar*. Qëndrimet e caktuara ideologjike, sidomos ato të cilat mund t'i quajmë

konservative *shpesh nuk paraqesin* gjuhë të urrejtjes. Debatet në të cilat janë të përfaqësuara qëndrimet ideologjike lidhur me të drejtat e pjesëtarëve të pakicave të caktuara nacionale apo etnike apo të pjesëtarëve të gjinisë së caktuar apo orientimit seksual janë krejt legjitime në shoqërinë demokratike mirëpo *me kusht* që me të *mos të nxitet* urrejtja, jotoleranca, nacionalizmi agresiv apo etnocentrizmi, mos të glorifikohen krimet apo superioriteti i racës apo kombit, apo të mohohen krimet e luftës, gjenocidi apo kujtimi për personat që kanë humbur jetën në ato ngjarje.

Shkak për këtë është se ideologjia e bazuar në thirrjen për urrejtje, dhunë dhe diskriminim si dhe kërcënim; ideologjia mbi superioritetin, respektivisht të inferioritetit në bazë të racës, gjuhës, ngjyrës së lëkurës, religjionit, nacionalitetit apo prejardhjes etnike; ideologjitë të bazuara në mohimin publik, nënçmimin, duke arsyetuar gjenocidin, krimet kundër njerëzimit dhe krimet e luftës apo qëllimi i të cilëve është distribuimi publik i të gjitha llojeve të materialeve raciste dhe krijimi i grupeve raciste *nuk paraqesin postulatet e shoqërisë demokratike* kështu që në këtë kuptim çdo shtet duhet të krijoj kornizën juridike efikase në mënyrë që ideologjitë e tilla *të ndalohen*.

Ngjashëm mund të konkludohet edhe për *qëndrimin politik*. Sa do qoftë që kampanjat, qëndrimet apo mendimet mund të jenë të ndyta dhe të bazuara në fjalë fyese, ato më së shpeshti, në shoqëritë demokratike bëjnë pjesë në kuadër të debateve legjitime përveç në rastet kur me to *nuk rrezikohen të arriturat themelore të shoqërisë demokratike*, si p.sh., ndalimi i diskriminimit, racizmit apo ksenofobisë; glorifikimi i gjenocidit dhe krimit; superioriteti apo inferioriteti për shkak të përkatësisë së ndonjë race, religjioni, nacionaliteti apo etnie etj.

Kur është fjala për *qëndrimin kritik ndaj pushtetit si dhe partive politike dhe personaliteteve publike*, edhe ai është i lejuar nëse në të nuk ka *motiv të dukshëm* për gjuhë të urrejtjes.

Problemi themelor i zbulimit të gjuhës së urrejtjes në Serbi si fenomen i rrezikshëm në nxitjen dh përhapjen e diskriminimit dhe të

dhunës është rreziku nga ndërhyrja në lirinë e shprehjes si e drejtë elementare e të drejtave të njeriut.. Për këtë, *të përsërisim* para çdo lëshimit në këtë problematikë është e nevojshme që të theksojmë se në gjuhë të urrejtjes nuk mund të fusim:

- 1) *Qëndrimin tjetër ideologjik dhe politik* (me kusht që ai qëndrim të mos nënkuptojë diskriminimin dhe thirrjen për dhunë për shkak të vetive të caktuara të personalitetit apo të përkatësisë ndaj grupit);
- 2) *Shpijfen dhe fyerjen*, e cila nuk ka si motiv diskriminimin apo thirrjen në dhunë kundër ndonjë grupi të mbrojtur, respektivisht individëve pjesëtarë të këtyre grupeve;
- 3) *Qëndrimi kritik ndaj pushtetit*, partive politike, personaliteteve publike dhe të ngjashme i cili gjithashtu nuk ka motiv të dukshëm me të cilën karakterizohet gjuha e urrejtjes (qëllimi që të nxitet dhuna dhe diskriminimi).

Problemi themelor të cilin kritikët e theksojnë kundër gjuhës së urrejtjes është *se gjuha e urrejtjes në themel kufizon lirinë e shprehjes dhe në këtë kuptim është shumë e rrezikshme të shfrytëzohet, sepse edhe gjuha e urrejtjes e shkallës më të lartë nuk mund të shkaktojë aso dëmi çfarë mund të shkaktojë censura dhe kufizimi i lirisë së shprehjes*. Në këtë pikëpamje ekzistojnë dy qasje në zgjidhjen e gjuhës së urrejtjes:

- 1) *represive, që do të thotë futjen e dispozitave ligjore* të cilat ndalojnë gjuhën e urrejtjes dhe dënimin e kryesve (qoftë me masa administrative, qoftë me ato penale, qoftë me sanksion kundërvajtës, respektivisht me kompensimin e dëmit në kontestet civile);
- 2) *ndërrimin e sistemit të vlerave* me ndihmën e një aktiviteti të gjerë edukativ para sa gjithash të elitës politike me qëllim të eliminimit të gjitha paragjytimeve dhe të stereotipeve të cilat shpijnë te gjuha e urrejtjes ashtu që ato dukuri të bëhen shoqërisht të papranueshme dhe të marginalizuara, respektivisht eksese e jo formë e komunikimit të përditshëm.

Shkurt, edhe sipas Paktit mbi të drejtat civile dhe politike dhe sipas

Konventës evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe *lirive themelore shprehja pëson kufizime* si dhe dënime nëse ato janë të parapara me ligj dhe të domosdoshme në shoqërinë demokratike, në *interes të sigurisë nacionale, tërësisë territoriale apo sigurisë publike, për të ndaluar trazira apo kriminalitetin, për të mbrojtur shëndetin apo moralin, për të mbrojtur nderin apo të drejtat e tjerëve.*

Në komentet e përgjithshme të Komitetit të KB për të drejtat e njeriut të cilat kanë të bëjnë me *Paktin ndërkombëtar mbi të drejtat civile dhe politike*, në mënyrë plotësuese sqarohet se “*e drejta në lirinë e të shprehurit bartë në vete detyrimet dhe përgjegjësit e veçanta, dhe për këtë arsye janë të lejuara restriksione të caktuara të kësaj drejte të cilat kanë të bëjnë me interesat e personave tjerë apo të shoqërisë në tërësi*(*General comment 10., 29/06/83.*). Në komentin i cili fletë për lirinë e shprehjes dhe të religjionit, theksohet se...“në pajtim me nenin 20., *asnjë manifestim i religjionit apo besimit nuk mund të bëhet propagandë për luftë apo propagim i urrejtjes nacionale, racore apo fetare* e cila paraqet nxitje të diskriminimit, armiqësi dhe dhunë...“...kështu që...“shtetet anëtare janë të detyrueshme të nxjerrin ligje me të cilat ndalohen ato vepra“.⁹⁴

Edhe pse është e qartë se „gjuha e urrejtjes duhet të rregullohet me ligj sepse promovon diskriminimin, rrezikon dinjitetin para së gjithash të grupeve të rrezikuara, rrezikon të drejtat e njeriut, haptazi apo në mënyrë të maskuar nxitë dhunën, rrezikon sigurinë dhe demokracinë, dilema e përhershme se si me masa represive të eliminohet gjuha e urrejtjes e mos të rrezikohen të drejtat fundamentale të njeriut për të shprehur i lirë ende mbetet. Ajo më së miri *mund të zgjidhet me definimin e deklarimeve publike shoqërisht të papranuara siç janë ndalimi i glorifikimit të krimit, mohimi i gjenocidit, numrimin taksativ të grupeve të cilat janë viktime të propagandës dhe paargjykimëve e të ngjashme në mënyrë që në masën më të madhe të mundshme t'i iket gjykimit pashuall dhe arbitrar si dhe imponimit të*

⁹⁴ Uporedi: Odbor Ujedinjenih nacija za ljudska prava, *General comment 10., 29/06/83 i General comment 22., 30/07/93.*

**6.3.2. Rekomandimi R (97) 20 i Komitetit ministror të
Këshillit të Evropës
mbi gjuhën e urrejtjes**

*Rekomandimi R (97) R shteteve anëtare mbi gjuhën e urrejtjes së pari definon nocionin e gjuhës së urrejtjes. **Gjuha e urrejtjes është çdo formë e shprehjes e cila përhapë, nxitë apo arsyeton urrejtjen racore, ksenofobinë, antisemitizmin dhe format tjera të urrejtjes të bazuara në jotolerancë, duke përfshi aty edhe jotolerancën të shprehur në formën e nacionalizmit agresiv dhe etnocentrizim, diskriminimit dhe armiqësisë kundër pakicave, migrantëve dhe personave me prejardhje imigrante.***

Rekomandimi sidomos urdhëron që qeveritë e shteteve anëtare duhet të krijojnë dhe mbajnë *kornizën e plotë juridike e cila përbëhet nga dispozitat civilo, penalo dhe administrativo-juridike mbi gjuhën e urrejtjes*, të cilat mundësojnë pushtetin gjyqësor dhe shtetëror që në të gjitha rastet të harmonizojnë respektimin e lirive me respektimin e dinjitetit njerëzor dhe mbrojtjen e nderit të drejtave të personave tjerë. Në këtë drejtim, qeveritë e shteteve anëtare duhet të shqyrtojnë mënyrat dhe mjetet si ...në listën *e sanksioneve të mundshme penale për gjuhën e urrejtjes të shtohet edhe urdhëri për të kryer punë të dobishme shoqërore; të rritet mundësia për luftën kundër gjuhës së urrejtjes përmes të drejtës civile duke i lejuar organizatave joqeveritare të interesuara të ushtrojnë padi, duke i mundësuar kompensim viktimave të gjuhës së urrejtjes* dhe duke i mundësuar vendime gjyqësore të cilat viktimave i japin të drejtën në përgjigje apo i urdhërojnë korrigjime.

Rekomandimi gjithashtu urdhëron që qeveritë e shteteve anëtare si dhe organet e administratës në nivelin nacional, regjional dhe lokal, por edhe shërbyesit civil shtetëror , të kenë përgjegjësinë e posaçme që

sidomos *nëpër media të përmbahen nga deklaratat të cilat mund të kuptohen si gjuhë e urrejtjes apo si si fjalim i cili do të mund të prodhojë efekte të arsyetimit, përhapjes apo nxitjes së urrejtjes racore, ksenofobisë dhe formave tjera të diskriminimit të bazuara në jotolerancë.*

Legjislacioni kombëtar dhe praktika e shteteve anëtare duhet të mundësojë gjyqeve të kenë në mendje se rastet konkrete të gjuhës së urrejtjes *aq shumë janë fyes* për personat dhe grupet *sa që nuk gëzojnë shkallën e mbrojtjes* të cilën mbrojtje e gëzojnë format tjera të shprehjes në bazë të nenit 10 të Konventës Evropiane. Ky është rasti kur gjuha e urrejtjes ka për qëllim *shkeljen e të drejtave dhe lirive* të paraqitura në Konventë apo kufizimin e tyre në vëllim më të madh nga ajo që ajo parasheh.

Legjislacioni nacional dhe praktika duhet që t'ia mundësojë organeve përkatëse të ndjekjes që të kenë kujdes të posaçëm, aq sa lejojnë të drejtat e tyre diskrecionale, në rastet e gjuhës së urrejtjes. Në këtë pikëpamje, ato trupa duhet që posaçërisht ta shqyrtojnë lirinë e shprehjes të dyshuarit, duke marrë parasysh që futja e sanksioneve penale paraqet kufizim serioz të asaj drejte. Me rastin e imponimit të sanksioneve penale për shkak të gjuhës së urrejtjes, gjykatat përkatëse do të duhej të sigurojnë respektimin strikt të *parimit të proporcionalitetit.*

6.3.3. Rekomandimi R (97) 21 mbi mediat dhe promovimin e kulturës së tolerancës së Komitetit ministror të Këshillit të Evropës

Rekomandimi i Komitetit ministror të Këshillit të Evropës R (97) 21 mbi mediat dhe promovimi i tolerancës parasheh që problemi i jotolerancës kërkon shqyrtimin si në opinion, ashtu edhe në kuadër të vetë shtëpisë mediatike. Përvoja e qarqeve profesionale mediatike tregon se do të ishte e dobishme që shtëpitë mediatike të mendojnë për: *raportimin të bazuar në faktet dhe të dhënat e vërteta mbi racizmin dhe jotolerancën; raportimin e kujdesshëm kur është fjala për*

situatën tendosëse në mes bashkësive; ikjen nga etiketimi fytes stereotip të pjesëtarëve të bashkësive kulturore, etnike apo fetare në publikimet dhe programet e tyre, t'ia tërheqë vërejtjen opinionit publik në të keqen e jotolerancës, kontestimin e tezave të cilat janë të përmbajtura në vërejtjet jotoleruese të bashkëbiseduesit me rastin e intervistës, raporteve, programet debatuese etj.

Në pajtim me rekomandimet, shkollat e gazetarisë dhe institutet për aftësimin për punë në media do të kishin mundur që, nëse veç nuk i kanë bërë, të *fusin kurset specialistike* në programet e tyre arsimore me qëllim të zhvillimit të ndjenjës së profesionalizimit, duke pasur me atë rast në mendje angazhimin e medias në shoqëritë multietnike dhe multikulturale dhe kontributin e tyre në kuptimin më të mirë në mes të bashkësive të ndryshme etnike, kulturore dhe fetare. Këshillat e medias dhe trupat tjera të ngjashme do të duhej të miratojnë programet e aksionit apo të ndërmarrin iniciativa praktike për promovimin e kulturës së tolerancës. Iniciativa e tilla dhe aksionet mund të shkojnë paralel me kodekset profesionale të sjelljes së tillë të cilat janë miratuar në sektorët e ndryshëm të mediave dhe të cilët merren me problematikën e diskriminimit dhe të jotolerancës duke përkrahur të deleguarit e medias që të japin kontributin pozitiv në zhvillimin e tolerancës në kuptimin reciprok në mes të grupeve të ndryshme fetare, etnike dhe kulturore në shoqëri.

Të udhëhequr me shembullin e serviseve publike, edhe mediave tjera elektronike në përgjithësi, duke marrë parasysh se ato paraqesin mjet të fuqishëm për krijimin e atmosferës për eliminimin e jotolerancës ato do të duhej të investojnë angazhime përkatëse që në terminet më të shikuara, të kenë emisione të cilat kontribuojnë në integrimin e të gjithë individëve, grupeve dhe bashkësive dhe të sigurojnë përfaqësimin proporcional të bashkësive të ndryshme etnike, fetare dhe bashkësive tjera; të zhvillojnë qasjen multikulturale në programet të cilat janë të dedikuara posaçërisht për fëmijë dhe të rinj në mënyrë që të munden të rriten me dijen se dallimi kulturor, fetar dhe etnik është element natyral dhe pozitiv në shoqëri etj.

6.3.4. Rekomandimet dhe direktivat e Komisionit Evropian kundër racizmit dhe jotolerancës (ECRI)

Komisioni evropian për luftën kundër racizmit dhe jotolerancës i Këshillit të Evropës është formuar më 22. mars të vitit 1994, me qëllim të eliminimit të racizmit, ksenofobisë, antisemitizmit dhe jotolerancës të cilët rrezikojnë të drejtat e njeriut dhe vlerat demokratike në Evropë. Duke analizuar gjendjen në shtetet e Këshillit Evropian, ECRI bie rekomandime qëllimi i të cilave është revizioni i legjislacioneve të shteteve anëtare, si dhe të politikave dhe masave tjera në luftën kundër racizmit. Përveç analizës së gjendjes në shtetet anëtare përmes raporteve periodike të cilat shtetet janë të obliguara t'i japin ECRI-së, kjo organizatë bie rekomandime të përgjithshme të cilat kanë të bëjnë me forma të ndryshme të racizmit dhe shembujve të jotolerancës, siç janë rekomandimet e përgjithshme mbi diskriminimin e Romëve dhe Muslimanëve, përhapjen e përmbajtjeve raciste përmes Internetit, këshillat për trupat ligjdhënëse të shteteve anëtare, rekomandimet mbi “gjuhën e urrejtjes” për të cilat veç është bërë fjalë, etj. Rekomandimet, natyrisht, nuk janë obligative, por në shtetet anëtare seriozisht shqyrtohen dhe kryesisht zbatohen në vepër.

Kështu p.sh. **Rekomandimi i përgjithshëm 2**, këshillon anëtarët të krijojnë trupa të specializuara në luftë kundër racizmit dhe diskriminimit në nivelin shtetëror. Aso trupa tash për tash kanë Belgjika, Danimarka, Finlanda, Hungaria, Holanda, Norvegjia, Suedia, Zvicra dhe Britania e Madhe. Këto trupa janë komisione parlamentare, zyrat qeveritare, ombudsmeni, komisione, koordinatorë parlamentar, të cilat në nivelin shtetëror merren me monitorimin dhe pengimin e diskriminimit, duke i ndihmuar viktimave të diskriminimit, duke mbikëqyrur zbatimin e ligjeve kombëtare, dhe **luftën kundër paragjykimeve përmes masave edukative dhe mediave**⁹⁵

⁹⁵ ECRI, Good Practices: *Specialized bodies to combat racism, xenophobia, antisemitism and intolerance at national level*, Strasbourg, April, 1999.

Gjithashtu, rekomandimi 7 nga dhjetori i vitit 2002 për legjislacionin nacional për luftën kundër racizmit dhe diskriminimit i jep *direktiva* shteteve anëtare të cilat fare nuk kanë apo kanë ligje jo të plota në luftën kundër racizmit. Jepen definicionet e racizmit, të diskriminimit direkt dhe indirekt, si dhe propozimet për ndërrimin e kushtetutës, të drejtës civile dhe administrative dhe të ligjit penal. *Si dispozita më të rëndësishme të ligjit penal rekomandimi përmend; ndalimin e thirrjes publike për urrejtje, dhunë dhe diskriminim, kërcënim, përkrahje publike të ideologjisë së superioritetit, respektivisht të inferioritetit në bazë të racës, gjuhës, ngjyrës së lëkurës, religjionit, nacionalitetit apo prejardhjes etnike; mohimi publik, nënçmimi, arsyetimi i gjenocidit, krimet kundër njerëzimit, si dhe të krimeve të luftës; distribuimi publik i të gjitha llojeve të materialeve raciste; grupet raciste, si dhe diskriminimin racor me rastin e kryerjes së detyrës publike apo në punë.*⁹⁶

6.4. Aktgjykimet e institucioneve ndërkombëtare gjyqësore dhe të institucioneve tjera të cilat kanë të bëjnë me diskriminimin dhe me gjuhën e urrejtjes

Në këtë vend, do të paraqesim disa aktgjykimet dhe direktiva të Tribunalit ndërkombëtar penal për ish Jugosllavinë dhe Ruandën – Tribunalit të Hagës, mandej të Gjykatës evropiane për të drejtat e njeriut dhe të Komitetit për të drejtat e njeriut të Kombeve të bashkuara.

6.4.1. Aktgjykimi i Gjykatës ndërkombëtare penale për ish Jugosllavinë dhe Ruandën – Tribunali i Hagës

Me statutet *ad hoc* të Gjykatave ndërkombëtare penale për ish Jugosllavinë (GJNPJ) dhe Ruandën (GJNPR), si dhe me Statutin e Gjykatës ndërkombëtare penale të përhershme (GJNP) gjithashtu

⁹⁶ ECRI, *General Policy Recommendation No. 7 on national legislation to combat racism and racial discrimination*, Strasbourg, February 2003.

parashihet dënimi ligjor i nxitjes – duke përfshirë edhe atë verbal, në një rën prej krimeve për të cilët gjykatat kanë kompetencë. Kështu në nenin 4. të Statutit të GJNPJ-së vepër penale konsiderohet **“nxitja direkte dhe publike e veprës së gjenocidit”**, ndërsa Statuti i GJNP-së si përgjegjësi individuale ndëshkuese konsideron çfarëdo “urdhër, lehtësim, bindje apo nxitje për krim (të tillë) i cili ka ndodhur apo i cili ka qenë i planifikuar” (neni 25.). Me nenin 2. të Statutit të gjykatës për Ruandën vepër penale konsiderohet edhe çdo **“thirrje direkte dhe publike për të kryer gjenocid”**. E udhëhequr nga kjo dispozitë kjo gjykatë për herë të parë pas gjykimit për krime të nazizmit në Nyrberg dënoi “gjuhën e urrejtjes” si krim i luftës, kur dënuan dy redaktorë të radios dhe një redaktor të gazetës me burg të përjetshëm sepse përmes mediave të tyre çdo ditë nxitshin për gjenocid.

Gazetari i radiostacionit ruandez RTML- Ruzhiju, është akuzuar dhe dënuar para GJNPR sepse gati se për çdo ditë përmes valëve të radios përsëritke thirrjen: “Në punë” – çka ishte sinjal për “Vrisni Tutsët, si dhe redaktoret së medias më të fuqishme ruandeze RTML dhe revistës “Kangura”, Ngeze, Nahiman dhe Barajagviza, të cilët jo që vetëm kanë thirrur për kryerje të gjenocidit, por edhe kanë raportuar për lëvizjen e refugjatëve në mënyrë që xhelatët e tyre të mund më lehtë të i gjetshin dhe t’i masakronin. Për të njëjtin krim është dënuar edhe ish kryeministri i Ruandës Kambanda, i cili pranoi fajin se me fjalimet e tij si p.sh. me fjalinë: “Po refuzuat të jepni gjakun për vendin tuaj, do ta pinë qenët”.

Aktgjykimi më i ri i marrë është në rastin Bikindi, këngëtarit tekstet e të cilit i përngjajnë shumë këngëtarit kroat Tompson, i cili (në të vërtetë ende në mënyrë jo të plotfuqishme) i cili është dënuar me 12 vite burg.

6.4.2. Aktgjykimet e Gjykatës evropiane për të drejtat e njeriut

në kontekst të ndalesës së gjuhës së urrejtjes

Gjykata evropiane për të drejtat e njeriut në Strazbur gjithashtu mundet, në bazë të ndalimit të diskriminimit të përmbajtur në Konventën evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të procedoj për “gjuhën e urrejtjes” si formë e diskriminimit racor. Gjykata evropiane për të drejtat e njeriut në disa raste ka konstatuar se me rritjen e diskriminimit racor dhe të gjuhës së urrejtjes përmes medias por edhe të mjeteve tjera të komunikimit kishte ardhur deri te shkelja dhe keqpërdorimi i lirisë së të shprehurit. Të tilla p.sh. ishin aktgjykimet në rastet e *Kuhnen & Germany 1998* dhe *Rasti D.I & Germany 1996*. Edhe një rast i rëndësishëm që ka përfunduar para Gjykatës evropiane është rasti *Sener & Turqia* nga viti 2000. Ky rast ka të bëj me shprehjen e mendimit në gazetën publike i cili i referohej pozitës së regjionit turk Kurdistan (të banuar me shumicë prej Kurdëve), në të cilin edhe sot ka lëvizje të fuqishme separatiste. Së pari do të fillojmë pikërisht nga ky rast, dhe konkluzioneve të cilat i ka pru Gjykata evropiane lidhur me këtë rast në aktgjykimin e saj.

Sener & Turqia

Zonja Sener, pronare dhe redaktore përgjegjëse. Në revistën turke Lajmet dhe komentet, në vitin 1993, është botuar artikulli, të cilin e ka shkruar intelektuali turk me titullin “Rrëfimi i një intelektuali”. Në artikull është përdorur shprehja “Kurdistan”. Prokuroria turke për këtë, kundër zonjës Sener, pronare dhe redaktore përgjegjëse e kësaj reviste, ka iniciuar procedurë penale për shkak të gjoja zgjerimit të propagandës separatiste kundër mos ndarjes së shtetit, e cila është e dënueshme sipas Ligjit turk mbi preventivën nga terrorizmi nga viti 1991. Për këtë gjykata, më 1994, e dënoi me 6 muaj burg (me kusht me 3 vjet) dhe dënim në të holla. Zonja Sener iu drejtua Gjykatës evropiane, duke konsideruar se në këtë mënyrë iu ka mohuar e drejta për gjykim të drejt (neni 6) dhe liri të shprehjes (neni 10).

Në aktgjykim, Gjykata evropiane përsëriti se kufijtë e kritikës së

lejuar janë më të gjera kur është në pyetje Qeveria, sesa kur janë në pyetje personat privat. Ajo, duke pasur parasysh pozicionin e saj dominues, duhet t'i ekspozohet shqyrtimit kritik të opinionit, kështu që duhet të tregoj përmbajtje kur janë në pyetje ndjekjet penale, sidomos kur ekzistojnë edhe mjetet tjera që t'i përgjigjen kritikave jo të arsyeshme.

Mirëpo, gjykata ***lejon mundësinë që pushteti publik*** të aplikoj masat, bile edhe atë të karakterit penal – juridik, me qëllim të reagimit të arsyeshëm në aso deklarata kur ato nxisin dhunë kundër individit, funksionarit apo ndonjë pjese të popullsisë, kështu që shteti ka të drejtën e gjerë të lirisë së vlerësimit mbi nevojën e përzierjes në lirinë e dikujt të shprehjes. Gjykata thekson se “detyrimet dhe përgjegjësitë” nga alineja 2 e nenit 10 të Konventës evropiane ***e fitojnë rëndësinë e veçantë në situatat e konflikteve dhe të tendosjes. Kujdes*** i veçantë kërkohet kur bëhet fjalë për publikimin ***e mendimeve të përfaqësuesve të organizatave të cilat përdorin dhunën kundër shtetit***, në mënyrë që ***media*** mos të bëhet mjet për ***zgjerimin e gjuhës së urrejtjes dhe të promovimit të dhunës***. Mirëpo, njëkohësisht, nëse ato mendime ***nuk mund ashtu të kategorizohen***, shtetet nuk mundën, duke u thirrur në mbrojtjen e sigurisë kombëtare apo në pengimin e trazirave, të kufizojnë të drejtën e opinionit që për ato të njoftohet, duke iu kërcënuar mediat me ligj penal.

Në rastin konkret, Gjykata ka vlerësuar se artikulli e kontestuar, e ka shkruar intelektual i cili ka shprehur mendimin e tij për çështjen kurde, duke u angazhuar që zgjidhja e këtij problemi të zgjidhet me mjete paqësore dhe njëherë duke shprehur keqardhje për gjakun e derdhur. Gjithashtu, ai në tekst iu ***kundërvë të gjitha llojeve të shovinizmit*** duke përfshirë edhe të atij turk si dhe atij kurd. Gjykata vërejtë se pronarja e gazetës nuk është dënuar për nxitje të njerëzve për urrejtje apo për rezistencë të armatosur, por për shkak të përhapjes së propagandës separatiste, duke i referuar Kurdistanit. Pushteti i vendit ***nuk i ka dhënë*** rëndësi të mjaftueshme të drejtës së opinionit që të

informohet mbi *mendimet e ndryshme* për situatën në Turqinë juglindore, sa do qoftë ajo për ta e gabueshme dhe e pa saktë. Edhe pse bëhej fjalë për dënimin me kusht, pronarja ka qenë e ballafaquar me kërcënimin për dënim të rënd, sepse dënimi me kusht ka pasur për pasojë kufizimin e punës së saj si redaktore dhe i ka reduktuar mundësinë që të njoftoj opinionin me mendimet të cilat kanë vendin e tyre në debatin publik, ekzistimi i të cilit nuk mund të mohohet.

Në fund, Gjykata evropiane konkludon se, deklaratat kontestuese *nuk kanë nxitur në dhunë, kryengritje të armatosur apo kryengritje*, dhe konkludoi se ndërhyrja e shtetit në të drejtën e zonjës Sener në lirinë e të shprehurit *nuk ka qenë as e nevojshme as e kuptueshme në shoqërinë demokratike*, kështu që ka ardhur deri te shkelja e nenit 10. të Konventës evropiane – liria e të shprehurit.

Kuhnen & Germany (1998)

Paraqitësi i parashtrësës në Komisionin e dikurshëm për të drejtat e njeriut, ka qenë viteve nëntëdhjeta në krye të organizatës e cila ka pasur për qëllim që në skenën politike të kthej Partinë Nacional socialiste e cila ishte e ndaluar në Gjermani. Zoti Kuhnen distribuo i publikime përmes të cilëve nxitke luftën për Gjermaninë e madhe socialiste dhe të pavarur. Shkroi se organizata e tij për “unitetin gjerman, drejtësinë sociale, krenarinë racore, bashkësinë e njerëzve dhe shoqërinë”, e kundër “kapitalizmit, komunizmit, sionizmit, tjetërsimit të Gjermanëve për shkak të numrit të madh të punëtorëve të huaj, shkatërrimit të mjedisit jetësor. Gjithashtu shkroi:”Gjithkush që i shërben këtij qëllimi mundet të veprojnë kundër çdokujt që i bën opstruksion. Do të luftojmë dhe në fund do t’i eliminojmë”.

Gjykatat gjermane e dënuan Kuhnenin me dënim me burg. Ligji penal i Gjermanisë ndalon zgjerimin e propagandës organizatave jo kushtetuese kur një propagandë e tillë është drejtuar kundër rendit

themelor të demokracisë, lirisë dhe të mirëkuptimit të gjithë njerëzve.

Komisioni për të drejtat e njeriut konstatoi se paraqitësi i parashtresës është angazhuar për nacional socializëm me qëllim të rrezikimit të rendit themelor të lirisë dhe demokracisë, kështu që fjalimi i tij në kundërshtim me njëri prej vlerave themelore të paraqitura në preambulën e Konventës: liritë themelore të theksuara në Konventë “më së miri ruan...demokracia politike efikase”. Përveç kësaj Komisioni konstatoi që fjalimi i paraqitësit të parashtresës përmban elemente të diskriminimit fetar dhe racor. Prandaj, Komisioni ka konstatuar që paraqitësi i parashtresës tenton të shfrytëzoj lirinë e të shprehurit për afirmimin e sjelljes e cila është e kundërt me tekstin dhe frymën e Konventës dhe të nenit 17 i cili ndalon keqpërdorimin. Në fund Komisioni konkludoi që kufizimi në realizimin e lirisë së të shprehurit të paraqitësit të parashtresës ishte e “nevojshme në shoqërinë demokratike” dhe e hedhë parashtresën.

Rasti D.I & Germany 1996

Paraqitësi i parashtresës **D.I** me profesion historian, mohoi ekzistimin e komoreve të gazit në Aushvic, duke deklaruar se ato ishin falsifikime të sajuara në ditët e pasluftës, dhe se për këtë çështje tatimpaguesit gjerman kanë paguar 16 miliardë marka gjermane. Paraqitësin e parashtresës gjykatat vendore për këtë deklaratë e kishin dënuar me dënimin në të holla. Para Komisionit, shteti si arsyetim për këtë dënim theksoi interesin e mbrojtjes së sigurisë kombëtare dhe integritetit territorial, reputacionin dhe të drejtat e të tjerëve si dhe pengimin e demonstratave dhe të kriminalitetit.

Duke aplikuar principin e proporcionalitetit (nevojës në shoqërinë demokratike) Komisioni parashtresën e hodhi dhe njëherë paraqiti qëndrimin: “Interesat publike që të pengohet kriminalitetit dhe trazirat në popullatën gjermane për shkak të sjelljes fyese ndaj Evrejëve dhe kundërvajtjeve të ngjashme dhe kërkesës që të mbrohet reputacioni

dhe të drejtat *heqin balansin në shoqërinë demokratike* ndaj lirisë së të shprehurit të paraqitësit të parashtrësës që të distribuj publikimet me të cilat mohohet ekzistimi i metodave të vrasjes së Evrejëve duke lëshuar gazin nën regjimin nazist.

Deri te konkludimi i ngjashëm Komisioni për të drejtat e njeriut ka ardhur edhe në lëndën *Honskin & Austria (1995)* në të cilën paraqitësi i parashtrësës, gjithashtu, mohoi ekzistimin e holokaustit dhe nxiste urrejtjen racore.

Konstatimet e Komitetit në rastin e Robert Forison & Franca

Një nga rastet kyçe i cili ka të bëjë me *ndalesën e diskriminimit dhe gjuhën e urrejtjes* e të cilën e kishte diskutuar Komiteti për të drejtat e njeriut i KB është ***Robert Forison & Franca***. Paraqitësi i parashtrësës, ish profesori i letërsisë, është dënuar për shkak të mohimit të së vërtetës historike për krimet kundër njerëzimit të cilët i kishin kryer nazistët. Forisoni, i vetëdijshëm për rëndësinë e holokaustit, ka hulumtuar provat mbi metodat e vrasjeve, sidomos të helmimeve me gaz në Gjermaninë naziste, dhe përfaqësonte dyshimin se kanë ekzistuar komorat e gazit me qëllim të shfarosjes në Aushvic dhe në kampet tjera naziste. Bindjet e tija janë kundërshtuar në shumë revista akademike dhe përqeshura në shtypin ditor, sidomos në Francë.

Kuvendi i Francës me 13.07.1990 aprovoi të ashtuquajturin Ligj “Gejso” me të cilin ka ardhur deri te ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit mbi informimin publik duke shtuar nenin 24. Bis. Me atë nen është futur vepra penale e kontestimit të ekzistimit të kategorisë së krimit kundër njerëzimit të definuar me Marrëveshjen e Londrës të datës 8 gusht 1945, në bazë të cilës Gjykata e Nyrbergut në vitin 1945/1946, i ka shqiptuar aktgjykime udhëheqësve nazist.

Pas miratimit të ***Ligjit Gejso***, Forisonin e intervistoi revista mujore Shok i muajit, ndërsa artikulli u shpall në shtator të vitit 1990.

Forisoni e përsëriti bindjen e tij personale se në kampet gjermane të përqendrimit nuk kanë ekzistuar dhomat e gazit për vrasjen e Ebrejëve. Shoqatat e ish pjesëtarëve të Lëvizjes së rezistencës, ushtruan padi kundër Forsin dhe Patris Boazoas, redaktorit të kësaj reviste, të cilët më vonë u shpallën fajtorë për veprën penale “mohimi i krimit kundër njerëzimit” dhe u dënuan me dënim në të holla dhe pagimin e shpenzimeve gjyqësore në lartësi mbi 300.000 franga franceze. Gjykata e apelit më vonë e vërtetoi këtë dënim, Forisoni më vonë iu drejtua me parashtrësë Komitetit për të drejtat e njeriut të KB, duke theksuar se me vendimin gjyqësor iu është kufizuar e drejta e tij e lirisë së shprehjes dhe lirisë akademike në përgjithësi, duke konsideruar se ligji është drejtuar personalisht kundër tij.

Për Gjykatën franceze ishin relevante dy deklarata në intervistë: “kam arsye të shkëlqyeshme që të mos besoj në politikën e shfarosjes së Ebrejëve apo në dhomat magjike të gazit...Kisha dashur që 100% e qytetarëve francez të kuptojë se miti mbi dhomat e gazit paraqet një sajim të pandershëm”. Aktgjykimi i gjykatës franceze nuk ka hyrë në të drejtën që ai ka të drejtë të paraqes ndonjë mendim në përgjithësi, por gjykata e ka dënuar për shkak të shkeljes së të drejtës dhe reputacionit të personave tjerë. Mirëpo, Forisoni konsideroi se gjykata nuk ka pasur prova që tekstet dhe tezat e tija paraqesin “formë suptile të antisemitizmit bashkëkohorë”, siç kishte konstatuar Gjykata franceze.

Komiteti për të drejtat e njeriut në konstatimin e tij lidhur me këtë rast, konstatoi se kufizimi i lirisë së të shprehurit në këtë rast ishte i domosdoshëm, kështu që Gjykata franceze kishte të drejtë. Komiteti mori në dijeni argumentin e shtetit nënshkrues të kontratës së futja e Ligjit Gejso ka pasur për qëllim t’i kontribuoj luftës kundër racizmit dhe antisemitizmit, si dhe deklaratën e Ministrit të atëhershëm francez të drejtësisë. Në mungesë të materialit i cili do të përmbante së paku një argument me të cilin do të vihej në dyshim baza e qëndrimit të shtetit

nënshkrues të kontratës mbi nevojën e këtij kufizimi, Komiteti *konstatoi* se *kufizimi i lirisë së të shprehurit të z. Forison ka qenë i domosdoshëm* dhe në pajtim me nenin 19. al.3. të Paktit mbi të drejtat civile dhe politike, me të cilën vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës franceze.

6.5. Legjislacioni krahasimtare dhe praktika gjyqësore në disa vende evropiane

6.5.1. Legjislacioni në disa vende evropiane

Në vendet e zhvilluara të Evropës masat të cilat janë miratuar në Këshillin e Evropës zbatohen në nivelin nacional ndërsa kanë të bëjnë me ndalimin e diskriminimit dhe drejtpërdrejt apo tërthorazi edhe me gjuhën e urrejtjes. Këtë do ta paraqesim në shembujt e Gjermanisë, Britanisë së Madhe, Italisë, Francës, ndërsa në fund do t'i paraqesim edhe dispozitat e legjislacionit kroat.

Gjermania

Ligji penal gjerman përmban dispozita shumë precize kundër gjuhës së urrejtjes kështu që është e dënueshme çdo shpërndarje e materialit propagandistik të organizatave “jo kushtetuese” siç janë partitë neo naziste, përdorimi i simboleve të organizatave të këtilla, thirrja në urrejtje dhe dhunë kundër grupeve të caktuara, si dhe *lejimi, mohimi apo zvogëlimi i gjenocidit, përdhosja e kujtimit për të vdekurit*. E rëndësishme është që në Gjermani ekziston edhe **linja direkte telefonike** në të cilën qytetarët mund të paraqesin sulmet e grupeve neo naziste, si dhe mbikëqyrja përhershme e faqeve të Internetit me përmbajtje raciste.⁹⁷

Britania e Madhe

⁹⁷ Krahaso: European Commission against Racism and Intolerance, *Second Report on Germany*, Strasbourg, 3 July 2001.

Në Britaninë e Madhe ekzistojnë një varg ligjesh me të cilat rregullohet gjuha e urrejtjes dhe racizmi. *Public order Act* (Ligji mbi rendin publik) ndalon dhunën verbale dhe çfarëdo tjetër, ***shtypja dhe distribuimi i materialit i cili nxitë urrejtjen racore***. Kjo ka të bëjë edhe me muzikën e edhe me filmin. *Race Relations Act* (Ligji mbi marrëdhëniet racore) ndalon edhe “ dhënien e deklaratave raciste me të cilat arsyetohet diskriminimi qoftë me vetëdije apo jo”, deri sa *Football Offences Act* (Ligji mbi kundërvajtjet në futboll) ndalon tifozërinë raciste.⁹⁸

Italia

Në Itali me Kushtetutë është ndaluar partia fashiste, ndërsa në disa ligje të cilët kanë të bëjnë me këtë fushë është e ndaluar përhapja e ideve që bazohen në ***urrejtjen racore dhe në superioritetin si dhe thirrja në përkatësinë racore***. Dhuna etnike dhe dhuna tjetër apo provokimi, grupet apo organizatat me këto qëllime, përdorimi i këtyre simboleve në manifestimet sportive, si dhe arsyetimi i fashizmit dhe gjenocidit. Me që edhe përkundër kësaj ndalese disa parti shfrytëzojnë mesazhe raciste në komunikimin publik ECRI ka propozuar që të futen edhe disa masa *ad hoc* me të cilat do të ndalohej gjuha e urrejtjes.⁹⁹

Franca

Në Francë është i ***dënueshëm diskriminimi, urrejtja dhe dhuna në bazë të prejardhjes, arsyetimi i krimin kundër njerëzimit*** të kryer në luftën e Dytë botërore nga ana e Boshtit, ***mbajtja e uniformës dhe emblemave të cilat përngajnë në personazhet përgjegjës për krime***

⁹⁸ European Commission against Racism and Intolerance: *Legal Measures to Combat Racism and Intolerance in the Member States of the Council of Europe*, Strasbourg, 2002.

⁹⁹ Krahaso: *European Commission against Racism and Intolerance: Legal Measures to Combat Racism and Intolerance in the Member States of the Council of Europe*, Strasbourg, 2002).

kundër njerëzimit. Franca e cila parasheh masat më të rrepta kundër gjuhës së urrejtjes, parasheh edhe ndalesën jo publike për nxitje në diskriminim, urrejtjen apo dhunën racore. *European Commission against Racism and Intolerance: Legal Measures to Combat Racism and Intolerance in the Member States of the Council of Europe*, Strasbourg, 2002). Gjithashtu, në ligjin Francez mbi informimin publik (i njohur si Ligji “Gejso” i vitit 1990) ka ardhur deri te ndryshimi dhe plotësimi duke shtuar nenin 24 bis. Me atë nen është futur vepra penale kontestimi i ekzistimit të kategorisë së krimit kundër njerëzimit të definuar me marrëveshjen e Londrës të datës 8. Gusht të vitit 1945.¹⁰⁰

Kroacia

Përparimi më i madh lidhur me ndalesën e diskriminimit është bërë në vitin 2006, kur me ndryshimin e Ligjit penal të Kroacisë është futur **krimi nga urrejtja** si vepër penale. Krimi nga urrejtja është formë e kualifikuar e veprës penale të kryer nga urrejtja për shkak të përkatësisë së racës së caktuar, për shkak të ngjyrës së lëkurës, orientimit seksual, gjuhës, besimit fetar, bindjes politike apo bindjes tjetër, prejardhjes nacionale apo sociale, statusit pasuror, të lindjes, arsimimit, pozitës shoqërore, moshës, statusit shëndetësor apo të vetive tjera.

6.5.2. Praktika gjyqësore në disa vende të Evropës

Përveç legjislacionit, me kalimin e kohës në sistemet juridike nacionale u zhvillua mjaft edhe praktika gjyqësore lidhur me ndalimin e diskriminimit dhe gjuhën e urrejtjes. Ja edhe disa aktgjykime karakteristike, të cilat në këtë fushë kanë pru gjykatat relevante në **Francë dhe Greqi.**

¹⁰⁰ Krahaso: *European Commission against Racism and Intolerance: Legal Measures to Combat Racism and Intolerance in the Member States of the Council of Europe*, Strasbourg, 2002).

Aktgjykimi i gjykatës franceze kundër Zhan-Mari Le Penit

Gjykata franceze vendim të ngjashëm ka prurë edhe në rastin e ultra djathtistit **Zhan-Mari Le Pen** i cili është dënuar në **shkurt të vitit 2007** me dënim me kusht prej tre muajsh burg për shkak të deklaratës se okupimi nazist i Francës nuk ka qenë edhe aq jo human.

Le Peni është shpallur fajtor për mohimin e krimit kundër humanizmit dhe për bashkëpjesëmarrje në kontestimin e krimeve të luftës në bazë të komenteve të cilat i ka bërë në intervistën për një revistë ultra djathtiste në vitin 2005. Lideri i Frontit nacional u dënua edhe me të holla në lartësi prej 10.000 euro.

Le Peni deklaroi për revistën **“Rivalor”** se...”okupimi gjerman në Francë nuk ka qenë edhe aq jo human, edhe pse kanë ndodhur shumë eksese, çka ishte e paevitueshme për vendin me sipërfaqe prej 550.000 kilometra katror”. Ai theksoi se “nuk do të kishte nevojë për formimin e kampeve të përqendrimit për deportimet politike nëse Gjermanët, në pajtim me besimin e përgjithshëm, të kishin kryer vrasje masive nëpër territorin”.

Gjykata konstatoi se Le Peni...”tentoi të vë në dyshim atë çka kishin bërë nazistët në territorin e Francës, siç është deportimi i Ebrejëve dhe ndjekja e pjesëtarëve të rezistencës, çka ishin krime kundër njerëzimit”. Lideri ultra djathtist Le Pen deklaroi në vitin 2005 se ...“nuk pendohet absolutisht” për shkak të këtyre deklaratave dhe se është bërë viktimitë e “ndjekjes” pasi që njëzëri e kishin dënuar politikanët francez dhe organizatat për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Aktgjykimi i Gjykatës greke kundër Kostas Plevrisit

Historiani grek dhe ekstremisti i djathtë **Kostas Plevris** u dënua në dhjetor të vitit 2007 me 14 muaj burg për shkak të shkaktimit të

urrejtjes raciste dhe të pohimit në librin e tij se *holokausti nuk kishte ndodhë*.

Plevrisi kishte ushtruar ankesën në aktgjykimin dhe nuk ishte dërguar në paraburgim. Dy anëtarë prej trupit tre anëtarësh gjykues të gjykatës e dënuan Plevrisin fajtorë për shkak të thirrjes në dhunë dhe shkaktimit të urrejtjes nacionale. Gjykata i liroi nga akuza botuesin, si dhe redaktorin dhe gazetarin e revistës djathtiste në të cilën ishin publikuar pjesë nga libri i Plevrisit. Bashkësia ebreje në Greqi konsideron se libri i ri i Plevrisit “*Hebrejtë: e vërteta e plotë*” ndikoi në rritjen e numrit të sulmeve ndaj përmendoreve të ebrejëve në vend. Plevrisi në gjyq u ankua se iu është mohuar liria e fjalës. Në luftën e Dytë botërore, siç vlerësohet, nazistët kanë vrarë rreth 60.000 Ebrej grek.

6.6. Ndalimi i gjuhës së urrejtjes në legjislacionin e Serbisë

6.6.1. Ligjet mbi ndalimin e diskriminim

Ligji mbi ndalimin e diskriminimit përcakton gjuhën e urrejtjes si formë të posaçme të diskriminimit. (neni 11). Te përcaktimi i kësaj forme të diskriminimit ligji është nisur nga përjashtimi nga njëra prej të drejtave fundamentale të njeriut – lirisë së të shprehurit. Ndalohet shprehja e ideve, informatave dhe mendimeve me të cilat nxitet diskriminimi, urrejtja apo dhuna kundër personave apo grupeve të personave për shkak të vetive të tyre personale, në mediat publike dhe publikimet tjera, në mitingjet dhe vendet ku ka qasje opinioni, me shkrimin dhe shfaqjen e porosive apo të simboleve dhe në forma të tjera. Te kjo formë konkrete, shkelja e lirisë së të shprehurit, respektivisht kur qëllimi i lirisë së të shprehurit shkelja e vlerave të shoqërisë demokratike, siç është ndalesa e nxitjes së diskriminimit, urrejtjes dhe dhunës kundër personave për shkak të veçorive të tyre personale në publik (çka nënkupton jo vetëm mjetet e informimit

publik, por edhe tubimet dhe vendet tjera ku ka qasje opinioni, duke shkruar parolla apo porosi apo në ndonjë mënyrë tjetër).

6.6.2. Ligji mbi informimin publik

Në nenin 38. të Ligjit mbi informimin publik ndalon gjuhën e urrejtjes e cila definohet si:

Ndalohet paraqitja e ideve, informatave dhe mendimeve me të cilat nxitet diskriminimi, urrejtja apo dhuna ndaj personave apo grupit të njerëzve për shkak përkatësisë së tyre apo të mos përkatësisë racës së caktuar, besimit fetar, kombësisë, grupit etnik, gjinisë apo për shkak të orientimit seksual, pa marrë parasysh se me paraqitjen (publikimin) a është kryer vepra penale.

Ligji parasheh se mund të ngritët padi për shkak të shkeljes së gjuhës së urrejtjes (neni 39) ashtu që personi si pjesë e grupit për të cilin informacioni ka të bëjë nga neni 38 i këtij ligji ka të drejtë të ushtrojë padi në gjykatë kundër autorit të informatës dhe kundër redaktorit përgjegjës të medias publike në të cilën është publikuar informata, me të cilën ka të drejtë të kërkojë ndalimin e ri publikimit dhe të publikimit të aktgjykimit me shpenzime të paditësve. Këtë padi mund ta bëjë edhe çdo person juridik qëllimi i të cilëve është mbrojtja e të drejtave dhe lirisë së njeriut dhe qytetarit, si dhe organizata qëllimi i të cilit është mbrojtja e grupeve nga neni 38 i këtij ligji. Mirëpo, nëse informacioni ka të bëjë me ndonjë person të caktuar personi juridik ka të drejtën e ushtrimit të padisë vetëm me pëlqimin e atij personi për të cilën informacioni ka të bëjë. Në pikëpamje të liritimit nga përgjegjësia në nenin 40 theksohen përjashtimet, kështu që nuk konsiderohet shkelje ndalimi i gjuhës së urrejtjes tekste gazetaresk apo shkencor nëse është publikuar: 1) pa qëllim që të nxitet diskriminimi, urrejtja apo dhuna kundër personave dhe grupit të personave të cilat janë theksuar në nenin 38; 2) me qëllim që të thuhet në mënyrë kritike në diskriminimin, urrejtjen apo dhunën kundër personave apo grupit të personave nga neni 38 apo në dukuritë të cilat paraqesin apo mund të paraqesin nxitje për

aso sjellje.

6.6.3. Ligji mbi radiodifuzionin

Në nenin 21 të Ligjit mbi radiodifuzionin përcaktohet se Agjensioni radiodifuziv kujdeset që programet e emiterëve të mos përmbajnë informata me të cilat nxitet diskriminimi, urrejtja apo dhuna kundër personave apo grupit të personave për shkak të përkatësisë të ndryshme politike apo për shkak të përkatësisë së ndonjë race, besimi, kombi, grupe etnike, gjinie apo orientimi seksual.

Sjellja e kundërt e emiterit nga kjo ndalesë është bazë për shqiptimin e masave të caktuara nga ana e Agjencionit, pavarësisht nga mjetet tjera juridike të cilat i ka në disponim i dëmtuari. Në pajtim me nenin 17 të Ligjit, Agjensioni mund që emiterit t'i ***shqiptojë vërejtje, e mundet edhe, në pajtim me dispozitat e këtij ligji, përkohësisht apo përgjithmonë t'ia marr lejen për emetimin e programit.***

Agjensioni mundet që para gjykatës kompetente apo organit tjetër shtetëror të iniciojë procedurë kundër emiterit apo personit përgjegjës të emiterit, nëse veprimi apo mos veprimi i tij ka elemente të veprës e cila është e ndëshkueshme sipas ligjit.

Gjithashtu, në pajtim me nenin 79 të këtij ligji, bartësit e servilit publik radio difuziv janë të detyruar që gjatë prodhimit dhe emetimit të programeve informative të respektojnë parimet e objektivitetit dhe paanshmërisë bë trajtimin e interesave të ndryshme politike dhe të subjekteve të ndryshme, që të angazhohen për lirinë dhe pluralizmin e shprehjes së mendimit publik, ***si dhe të pengojnë çfarëdo forme të mos durimit racor, fetar, nacional, etnik apo tjetër forme të urrejtjes, apo të mos durimit në pikëpamje të orientimit seksual.***

6.6.4. Ligji mbi shpalljet

Parimi i ndalesës së diskriminimit është definuar në nenin 7 të Ligjit mbi shpalljet: Shpallja nuk mundet, drejtpërdrejt apo tërthorazi, të nxisë diskriminimin në çfarëdo baze, e sidomos në bazë të racës, ngjyrës së lëkurës, gjinisë, përkatësisë kombëtare, prejardhjes shoqërore, lindjes, besimit fetar, bindjes politike apo bindjes tjetër, gjendjes pasurore, kulturës, gjuhës, moshës, invaliditetit fizik apo psikik.

Nuk mund të refuzohet publikimi, respektivisht emetimi i porosisë për shkak të përkatësisë racore, kombëtare apo etnike, gjinisë apo cilësisë tjetër të personit i cili kërkon shpalljen, respektivisht emetimin e porosisë që duhet shpallur.

6.6.5. Kodi penal

Të gjitha veprat penale në vijim (shkelja e barazisë 128, shkelja e të drejtës së përdorimit të gjuhës dhe shkrimit 129-130, shkelja e lirisë së predikimit fetar dhe ushtrimit të lutjeve fetare 131, shkelja e nderit të popujve, grupeve nacionale dhe etnike të SMZ 174, shkaktimi i urrejtjes nacionale, racore dhe fetare dhe të mosdurimit 317, organizimi dhe nxitja në kryerjen e gjenocidit dhe krimeve të luftës 375 dhe diskriminimi racor dhe formave tjera 387) përmbajnë në vete elemente të diskriminimit, jo tolerancës, nxitjes për dhunë, gjuhën e urrejtjes dhe krimin nga urrejtja, por që as një nga veprat e përmendura nuk paraqet vepër penale nga urrejtja dhe gjuhë të urrejtjes, dhe me këtë, e duke marrë parasysh se bëhet fjalë për të drejtën penale nuk ekziston mundësia që me interpretimin e dispozitave të caktuara të veprave të caktuar penale dikush të dënohet për krim nga urrejtja apo për shkak të gjuhës së urrejtjes. Këtu duhet theksuar se edhe vepra penale sjellja e dhunshme në praktikën gjyqësore interpretohet ashtu që askush nuk mund të dënohet për këtë vepër penale nëse më parë nuk

është dënuar për ndonjë vepër penale e cila në vete përmbanë elemente të dhunës. Në këtë vend po e japim definicionin e vetëm tri veprave penale të cilat në veti i përmbajnë këto elemente: shkelja e barazisë (neni 128); shkaktimi i urrejtjes nacionale, racore dhe fetare dhe të mosdurimit (317) dhe diskriminimi fetar dhe i formave tjera (neni 387).

1) Shkelja e barazisë

(1) Kush për shkak të përkatësisë nacionale apo etnike, racës apo besimit fetar apo për shkak të mungesës së kësaj përkatësie apo për shkak të dallimeve në pikëpamje të bindjes politike apo bindjeje tjetër, gjinisë, gjuhës, arsimimit, pozitës shoqërore, prejardhjes sociale, gjendjes pasurore apo të ndonjë vetie tjetër, tjetërkujt i mohon apo i kufizon të drejtat e njeriut dhe të qytetarit të parapara me Kushtetutë, me ligje apo me rregulla tjera apo me akte të përgjithshme apo me kontrata ndërkombëtare të ratifikuara apo në bazë të këtij dallimi i jep privilegje, **do të dënohet me burg deri në tre vjet.**

(2) Nëse vepra nga alineja 1. e këtij neni kryhet nga ana e personit zyrtar në kryerjen e detyrës, **do të dënohet me burg prej tre muaj deri në pesë vjetë.**

2) Shkaktimi i urrejtjes nacionale, racore, fetare dhe të mosdurimit

(1) Kush shkakton apo nxitë urrejtje nacionale, racore apo fetare, apo mosdurimin mes popujve apo bashkësitë etnike të cilat jetojnë në Serbi, do të dënohet me burg prej gjashtë deri në pesë vjet.

(2) Nëse vepra nga alineja 1 të këtij neni është kryer me dhunë, me shtypje, duke rrezikuar sigurinë, duke përqeshur simbolet nacionale, etnike apo fetare, duke shkatërruar sendet e huaja, duke dëmtuar përmendoret apo varret, **kryesi do të dënohet nga një deri në tetë vjet.**

(3) Kush e kryen veprën nga alineja 1 dhe 2 të këtij neni duke keqpërdorë pozitën apo autorizimet apo për shkak të këtyre veprave vjen deri te trazirat, dhuna apo deri te pasojat tjera të rënda për jetën e përbashkët të popujve, pakicave kombëtare apo grupeve etnike të cilat jetojnë në Serbi, do të dënohet për ***veprën nda alineja 1. me burg prej një deri në tetë vjet, ndërsa për veprën nga alineja 2. me dënim prej dy deri dhjetë vjet burg.***

3) Diskriminimi racor dhe diskriminimi në forma tjera

Edhe një vepër penale e rëndësishme nga ky korpus është vepra penale ***diskriminimi racor dhe diskriminimi në forma tjera (neni 384)***. Kjo vepër me ndryshimet dhe plotësimet e Kodit penal nga vitin 2009 ***ndjeshëm është zgjeruar***, dhe me figurën e saj është përfshirë edhe ***gjuha e urrejtjes***.

Kush në bazë të dallimit racor, ngjyrës së lëkurës, përkatësisë fetare, nacionalitetit, prejardhjes etnike apo në bazë të ndonjë vetie tjetër individuale shkel të drejtat themelore dhe liritë e njeriut të garantuara me normat e pranuar ndërkombëtare dhe të ratifikuara me kontratat ndërkombëtare nga ana Serbisë, do të dënohet me burg prej gjashtë deri në pesë vite. Me të njëjtin dënim do të dënohet çdo person i cili kryen propagimin e organizatave apo të individëve të cilët angazhohen për barazinë e njerëzve.

Edhe një formë e kësaj vepre penale për të cilën është paraparë dënimi prej tre muajve deri në tre vite burg ka të bëjë me përhapjen e idesë mbi superioritetin e një rase ndaj tjetrës apo propagandimi i urrejtjes racore apo nxitjes për diskriminim racor.

Gjithashtu, kush përhapë apo në formë tjetër i bënë publike tekstet, fotot apo çfarëdo shfaqje të ideve apo teorive të cilat propagojnë apo nxisin urrejtje, diskriminim apo dhunë, kundër çdo personi apo grupit të personave, të bazuar në racë, ngjyrë të lëkurës, përkatësi

nacionale, prejardhje etnike apo për shkak të ndonjë vetie tjetër, do të dënohet me burg prej tre muaj deri në tre vjet.

Këto dy forma të paraqitura më lart të parapara me ndryshimet dhe plotësimet e Kodit penal kanë të bëjnë direkt me gjuhën e urrejtjes.

Kush publikisht kërcënon se, kundër personave apo grupit të personave për shkak të përkatësisë racore të caktuar, ngjyrës së lëkurës, besimit fetar, nacionalitetit, prejardhjes etnike apo për shkak të ndonjë vetie personale, do të kryej vepër penale për të cilën është paraparë dënimi me burg më tepër se katër vite burg, do të dënohet me burg prej tre muaj deri në tre vite. Kjo njëherë është edhe forma e fundit e veprës penale të diskriminimit racor dhe të formave tjera të paraparë me Kodin penal.

6.7. Parimi i ndalimit të gjuhës së urrejtjes si princip etik në kontekst të rolit të medias në situatat e konflikteve dhe të tendosjes

Përgjegjësinë më të madhe për eliminimin e gjuhës së urrejtjes do të duhet ta përfaqësonin aktet e *vetregulacionit siç janë kodekset profesionale dhe etike*. Në këtë rast rolin vendimtar do të duhet ta luanin shoqatat e gazetarëve, dhe *Këshilli për shtyp* që është formuar. Këto do të duhej të jenë promotorë të masave pozitive kundër racizmit dhe jo tolerancës në media dhe të pengimit të përhapjes së mëtutjeshme të gjuhës së urrejtjes.

Njëri prej publikimeve të Komisionit evropian në luftën kundër racizmit dhe jo tolerancës fletë mu për “praktikat e mira” të mediave evropiane në luftën kundër racizmit. Atje janë përshkruar metodat e ndryshme me të cilat gazetatat, radio stacionet, televizionet, sindikatat profesionale dhe shoqatat promovojnë tolerancën, si dhe në mënyrë kritike i qasen problemeve të racizmit dhe jo tolerancës. “Praktikat e mira” ekzistojnë gati në të gjitha vendet e Këshillit të Evropës, ndërsa

janë paraparë edhe dy shpërblime për promovimin e tolerancës në media. Qëllimi është që paragjykimet, jo toleranca, diskriminimi dhe gjuha e urrejtjes të kufizohen në eksese dhe dukuri të izoluara.¹⁰¹

Për rolin e politikanëve, personaliteteve publike të mediave dhe të gazetarëve në situatat e luftës, konflikteve dhe të tendosjeve gjatë viteve 90-ta të shekullit XX në hapësirat e ish Jugosllavisë edhe sot kohë pas kohe diskutohet nëpër qarqe të shoqatave të gazetarëve në Serbi. Sa është rreziku nga gjuha e urrejtjes dhe cila është lidhja shkak – pasojë në mes të gjuhës së urrejtjes dhe të krimit nga urrejtja mund të na ilustrojnë edhe tregimet në vijim të disa personaliteteve publike të cilët i kishin transmetuar mediat si dhe tregimet e vet gazetarëve.¹⁰²

B.P. revista e Novi Sadit Svet 6 shtator 1993.

“Myslmanët janë gjenetikisht material i prishur të cilët kanë kaluar në islam. Dhe tash, nga gjenerata në gjeneratë, thjesht ai gjen kondenzohet. Bëhet gjithënjë më keq, shprehet thjesht, dikton mënyrën e mendimit dhe të sjelljes. Kjo sjellje është në gjen e mbjellur”.

V.SH. 17.04.2004

¹⁰¹ Krahaso: ECRI: *Examples of "Good Practices" to Fight against Racism and Intolerance in the European Media*, Strasbourg, April 2000.

¹⁰² Vidan Hadži Vidanović, *Pozivi na zločin u umivanim izveštajiima*, Nezavisno udruženje novinara Srbije, Dosije o medijima, nr. 30, shtator - dhjetor 2009, fq. 31-35. Autori ka shfrytëzuar raportin e ekspertit të Prokurorisë së tribunalit të Hagës Reon de la Bros me emërtimin Propaganda politike dhe projekti „Të gjithë Serbët në një shtet“ i cili në lëndën kundër S. Millosheviqit është përfshirë në prova. Citatet të cilët pasojnë janë theksuar sipas këtij teksti dhe të raportit të ekspertit të lartpërmendur. Gjithashtu, një numër i madh i deklaratave të ngjashme dhe të konstatimeve të politikanëve, gazetarëve dhe personaliteteve publike si dhe rolin e medias në kushtet e konflikteve, luftës dhe tendosjes, mund të gjenden në librin: *Gjuha e urrejtjes*, Centar za antiratnu akciju, Beograd, 1994.

Konsideroj që të gjithë Kroatët duhet të shpërngulen, përveç atyre që iu kanë përgjigjur mobilizimit. Duhet ndarë Serbët – katolik (Shokët dhe Bunjevçët) të cilët gëzojnë barazi të plotë”.

Reporteri i RTS-it

“Ata (Hungarezët), kurrë nuk kanë pushuar së menduari për atë që të jenë përsëri pjesë e perandorisë së Austro – Hungarisë. Ata bile dëshirojnë që të ndryshojnë emërtimet e rrugëve në këtë qytet dhe që sheshit të vjetër t’i kthejnë emrin të cilin në luftën e Dytë botërore i kishin dhënë Gjermanët – sheshi i Hitlerit”.

V.SH: Politika 14.05.1991.

“Do të hakmerremi për gjakun serb dhe do t’i japim faturën rendit të ri ustash për të gjitha krimet dhe për një milion viktima serbe. I gjithë serbizimi; serbizimi nuk ka çmim! Nga Serbia duhet të shkojnë 100.000 Kroat. Thjesht, pa këtë, Serbia nuk mundet të vendosë Serbët e pafat të cilat u përzunë nga Kroacia. Ky është këmbim i thjesht nën dhunën e terrorit shtetëror kroat”.

Për fat të keq, në Serbi edhe më tutje ekziston një numër i madh i deklaratave publike të cilët me kohë janë bërë të përditshme dhe të zakonshme, e të cilat sipas parametrave paraqesin dhe në vete përmbajnë “gjuhën e urrejtjes”.¹⁰³

Në shoqëri dhe shtet e cila as dhjet vjet nuk është përcakëtu qartë në raport me të kaluarën e saj dhe në të cilën viktimat shpallen si xhelat dhe anasjelltas, ku mekanizmat e shumtë demokratik janë shfrytëzuar për qëllim të promovimit mu të këtyre dukurive të cilat janë shkaktare të një vlere kontaminuese ende është vështirë të pritët që elita

¹⁰³ Krahaso: Ratko Ferić, *Novinari u industriji mržnje*, Nezavisno udruženje novinara Srbije, Dosije o medijima, br. 30, septembar-decembar 2009, str. 13-18.

politike të bëj më shumë në arsimimin në kuptimin e marginalizimit të paragjyqimeve dhe stereotipeve të cilët çojnë deri te gjuha e urrejtjes. Prapë se prapë, zgjidhja ekziston dhe ajo përbëhet nga presioni permanent në organet shtetërore që të pranohen vlerat të cilat janë definuar në dokumentet e shumta ndërkombëtare të cilat ky shtet i ka ratifikuar dhe çështja e eliminimit të gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit duhet të largohet nga terreni i cili këtu ende quhet *e drejta në qëndrim*.

Shembujt nga Gjermania, Britania e Madhe dhe Franca qartë tregojnë si shtetet me një demokraci të lartë zhvillimi nuk kanë frikë që ideologjitë e papranueshme shoqërore të cilat kanë prurë deri te pasojat e dëmshme të mëdha, pa frikë për bartësit e pushtetit se do të shpallen si antidemokrat. Thirrja dhe bartja e transparentëve në ndeshjet dhe shfaqjet publike "*Thika teli Srebrenica*", grafitet me fotografitë e Ratko Mlladiqit në uniformë, postierët, emblemat, përkrahja e kriminelëve të luftës, mbishkrimet në muret "*Vdekje Shqiptarëve*", "*Vdekje pederëve*" dhe të ngjashme janë vetëm pasojë logjike e mos ndërhyrjes së organeve shtetërore më bazë të dokumenteve të ratifikuara ndërkombëtare, mos zbatimit të ligjeve të shtetit dhe të Kushtetutës, apo me mosrespektimin e rekomandimeve dhe rezolutave të organeve kompetente ndërkombëtare, e para së gjithash dhe ende, të mos ekzistimit të vullnetit politik që të ndërtohet sistemi i vlerave i cili do të nënkuptonte tolerancën e vërtetë dhe i cili do të jetë kundër diskriminimit dhe gjuhës së urrejtjes, në rend të parë, kundrejt pakicave kombëtare.¹⁰⁴

Përndryshe, ajo që është në Serbi e zakonshme: *deklarimi i qëndrimeve raciste dhe diskriminatore përmes grafitëve, shkrimeve në mur, në ndeshjet futbolistike, në ekstatën patriotike me rastin e festimit të fitoreve sportive të sportistëve serbë, në manifestime, koncerte, përmes TV-së në vendet evropiane është e dënueshme edhe*

¹⁰⁴ Mbi këtë problem në Serbi më gjerësishtë: *Izveštaj o diskriminaciji u medijima*, Komitet pravnik za ljudska prava, Beograd, 2007.

me ligj por e ndaluar edhe me ndonjë akt tjetër. Përvoja tregon se nga shkrimi në mur përmes agresionit verbal deri te dhuna e hapur rruga është e shkurt. Problem të veçantë paraqet imponimi i gjuhës së urrejtjes si diçka patriotike nga ana e elitës politike si e preferuar dhe si sjellje e vetme e pranuar. Gjithashtu, gjuha e urrejtjes në mesin e qytetarëve të rëndomtë konsiderohet si akti më i lartë patriotik sepse përmes asaj mbrohet kombi nga të tjerët të cilët në parim janë të këqij dhe na mendojnë të keqen. Ky shndërrim i “gjuhës së urrejtjes” në “patriotizëm” më i theksuari është me rastin zgjidhjes së statusit të Kosovës kur të gjitha humbjet serbe paraqiten si konspiracion i armiqve të Serbëve dhe të serbizimit dhe me shumë agresivitet pamundëson çdo bisedë në temën e shkakut dhe pasojës, ndërsa të gjithë të cilët mendojnë ndryshe nga mendimi i imponuar patriotik për situatën shpallen tradhtarë dhe armiq, ndërsa shpesh bëhen edhe cak i hapur i dhunës.

Gjithashtu, edhe një problem i cili është i lidhur me përhapjen e gjuhës së urrejtjes në Serbi gjatë kalimit të kohës është bërë edhe **interneti**. Në Serbi ekzistojnë disa sajte të cilat janë haptazi pronaziste, të cilët pa asnjë pasojë direkt thërrasin në dhunë dhe të cilët në Serbi nuk kuptohen me seriozitetin e duhur. SMS porositë përmes telefonit mobil janë bërë gjithashtu mjet serioz për hapjen e gjuhës së urrejtjes dhe për kanosje.

Edhe pse ekziston ligji në sferën e medias i cili ndalon gjuhën e urrejtjes si dhe nxitjen e dhunës dhe diskriminimit, çdo ditë në mediat elektronike dhe të shkruara shfrytëzohet gjuha e urrejtjes. Disa gazeta ditore dhe radio stacione me frekuenca nacionale, kohë pas kohe edhe sot haptazi thërrasin në dhunë, dhe në emër të patriotizmit në murin e turpit dhe në listën e tradhtarëve serb i vendosin shpesh të njëjtat grupe njerëzish.

Këto janë dukuri që duhet penguar, sepse ato mjaft ndikojnë në shkaktimin e tendosjes dhe të dhunës, para së gjithash në vendet

multietnike në Serbi. Ato nuk janë të lidhura vetëm me ligjin, por edhe kulturën demokratike dhe qartë identifikojnë standardet e shoqërisë demokratike çka edhe ka qenë qëllimi i këtij Doracaku.

Ky Doracak është realizuar me përkrahje financiare të Bashkimit europian në kuadër të programit Instrumenti europian për demokraci dhe të drejta të njeriut (EIDHR). Përmbajtja e këtij doracaku është përgjegjësi ekskluzive e Qendrës madiale & për reformë në Nish dhe nën kurrfar kushtesh nuk mund të konsiderohet si shprehje e qëndrimit të Bashkimit europian.

Botues:

Qendra mediale dhe për reformë Nish

Për botuesin:

Mlladen Velojiq

Bashkupunëtor teknik:

Sanja Gjorgjeviq

Përkthimi në shqip:

Fehmi Maliqi

Tirazhi:

100

Shtyp:

Grafika LAV, Nish